Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (109). MAJ 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

DEBAT / RRUGA E ARBRIT

Peticioni - një postim, një reagim dhe një sqarim

NGA **GEZIM ALPION** - FAQE 7

KUJTIME

Njerëz të thjeshtë e të mëdhenj në ndershmërinë e tyre

NGA **EDMOND HASANI** - FAQE 10

REPORTAZH

Rrugëtim mes psherëtimash dhe mall mërgimtari

NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 12

ARKEOLOGJI

Vrojtime arkeologjike në zonën e Lurës

NGA **ADEM BUNGURI** - FAQE 15

Qershia, e ëmbël në pemë, e idhët në treg

Qershia, fruti i bekuar që nxjerr në pah shëmtinë e tregut. Një vështrim në biznesin e qershisë që nga prodhimi deri në pikat fundore të shitjes. Problemet, vështrësitë e gjetjes së tregut dhe çmimet që ulen me shpejtësi. Dibra hap tregun e qershive nga 15 maji, me *Burlatin* e hershëm dhe e mbyll në fund të qershorit me varietetet e vona *Napolon* dhe *Belica* e Luznisë.

Fitimet në vitet e shkuara ishin modeste për arsye se edhe numri i rrënjëve të mbjella nga fermerët ishte relativisht i vogël. Por edhe me çmimin ishin të kënaqur të gjithë prodhuesit. Por këtë vit, përkundër prodhimit të madh dhe cilësor, tregu ofroi shumë pak përkrahje, duke i lënë kokrrat e qershisë të kalben në pemë, fermerët e mërzitur dhe tregun e uritur.

Një vështrim përmes syve të prodhuesve, konsumatorëve, tregtarëve dhe specialistëve të fushës. Të gjithë ankohen nga pak: tregtarët fitojnë pak, prodhuesit i shesin shumë lirë, konsumatorët nuk kanë lekë t'i blejnë, ndërsa specialistët nuk po gjejnë zgjidhjen që ky zinxhir të funksionojë.

Nga **MIRAN TAFA** - FAQE 2-3



Intervista

Bujar Kapexhiu: Me kënaqësi do vizatoja dibranët, sepse e ndjej se e kuptojnë humorin tim

Nuk duhet të ekzistojnë dasi politike mes dibranë, pasi shoqata e përjashton politikën. Ne duhet të bashkohemi mbi të tjera kritere, të tjera pika, të tjera shtylla. E para fare është vendlindja që na bashkon të gjithëve, që jemi dibranë. E dyta është historia, që është njësoj e të gjithëve. Periudha që kemi kaluar, dëshira, pasionet, kultura, folklori, etnografia etj. Të gjitha këto na bashkojnë.



FAQE 8-9

Intervista / sport

Fitnete Lala - Schmid: Dua të përfaqësoj ngjyrat kuq e zi në veprimtari ndërkombëtare



Nga SASHENKA NDREKA - Faqe 13

ZGJEDHJET LOKALE:

Dibra zgjedh majtas, Mati shkon djathtas

Një vështrim mbi zgjedhjet lokale: Kush janë kandidatët fitues dhe sa vota morën? Situata parazgjedhore, dita e zgjedhjeve dhe pas zgjedhjeve. Problemet, ankesat dhe denoncimet e opozitës. Vota për këshillat bashkiakë dhe kandidatët fituese. Prezantohen rezultatet e anketimit të Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare mbi atë se çfarë mendojnë zgjedhësit mbi pushtetin vendor!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Zgjedhjet lokale të 21 qershorit e ndanë në mënyrë të barabartë elektoratin në qarkun e Dibrës: dy bashkitë, Mat dhe Klos, i fitoi Aleanca Populllore për Punë dhe Dinjitet, ndërsa Bulqizën dhe Dibrën i fituan kandidatët e Aleancës për Shqipërinë Europiane.

Basir Çupa dhe Melaim Damzi i fituan zgjedhjet me diferencë të madhe votash me kundërshtarët, ndërsa Adelina Farrici e ASHE humbi përballë Nezir Rizvanit të APPD me 181 vota diferencë dhe Shukri Xhelili i ASHE fitoi në Dibër kundrejt Ilir Krosit të APPD me 439 vota më shumë, falë edhe ndihmës që i dhanë tre kandidatët, njëri i pavarur dhe dy të tjerët nga Partia Aleanca Populllore dhe Partia e Bashkimit të të Drejtave të Njeriut.

Vijon në faqet 4,5,10

cyan magenta yelloë black 1

Qershia është shumë e përshtatshme për rajonin e Dibrës. Shfrytëzon shumë mirë tokat skeletike, gurishtore dhe e toleron mjaft mirë mungesën e vaditjes. Ajo pothuajse nuk do krasitje, kurse numri i spërkatjeve nuk është më shumë se tre.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (110). 1 - 30 Qershor 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Miran TAFA
Hysen LIKDISHA
Sashenka NDREKA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Bujar KAPEXHIU
Gëzim ALPION
Edmond HASANI
Ben ANDONI
Adem BUNGURI
Xhafer MARTINI
Hajri SHEHU
Moisi MURRA
Dionis XHAFA
Faik XHANI
Gazmend KËRKUTI
Sulejman TOMÇINI
Beqir SHEHU
Islam CANI
Genci LUARASI
Arsim KOLARI
Samet ZAGRADI
Ilmi DERVISHI

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Qershia, e ëmbël në pemë, e idhët në treg

Qershia, fruti i bekuar që nxjerr në pah shëmtinë e tregut. Një vështrim në biznesin e qershisë që nga prodhimi deri në pikat fundore të shitjes. Problemet, vështirësitë e gjetjes së tregut dhe çmimet që ulen me shpejtësi. Dibra hap tregun e qershive nga 15 maji, me Burlatin e hershëm dhe e mbyll në fund të qershorit me varietetet e vona Napolon dhe Belica e Luznisë.

Fitimet në vitet e shkuara ishin modeste për arsye se edhe numri i rrënjëve të mbjella nga fermerët ishte relativisht i vogël. Por edhe me çmimin ishin të kënaqur të gjithë prodhuesit. Por këtë vit, përkundër prodhimit të madh dhe cilësor, tregu ofroi shumë pak përkrahje, duke i lënë kokrrat e qershisë të kalben në pemë, fermerët e mërzitur dhe tregun e uritur.

Një vështrim përmes syve të prodhuesve, konsumatorëve, tregtarëve dhe specialistëve të fushës. Të gjithë ankohen nga pak: tregtarët fitojnë pak, prodhuesit i shesin shumë lirë, konsumatorët nuk kanë lekë t'i blejnë, ndërsa specialistët nuk po gjejnë zgjidhjen që ky zinxhir të funksionojë.



Vlerat e qershisë

Mendohet se origjina e qershisë së ëmbël është Deti i Zi, nga një qytet me emrin Cerasus. Në Europë ajo u soll nga romakët, të cilët e përfshinin qershinë si ushqim kryesor në dietën e legjionarëve. Qershia posedon gjithçka që trupi ynë ka nevojë, për të qenë vital dhe i shëndetshëm. Ky frut është i pasur me vitamina A, C, E dhe acid folik. Gjithashtu, është i pasur me minerale të tilla si kaliumi, magnezi, hekuri dhe fibrat. Konsumi i tij i vazhdueshëm bën që të zvogëlohet rreziku i prekjes nga kanceri apo nga infarkti i zemrës.

Roli antioksidant i qershisë është shumë i dukshëm dhe i vlerësuar. Kjo bën të mundur zvogëlimin e arteriosklerozës, funksion normal të enëve të gjakut, si dhe mbrojtje nga pikat në tru.

Qershitë zvogëlojnë proceset inflamatore në organizëm, lehtësojnë dhimbjen e artritit dhe të kyçeve. Fruti në fjalë ka elementë përbërës antiviral dhe antibakterialë. Mos harrojmë që dhe syri, ky aparat shumë i rëndësishëm i njeriut, ka përfitime të mëdha nga konsumi i qershisë. Lista mund të vazhdojë e gjatë dhe si përfundim nuk do të ngelte ind dhe organ i njeriut që nuk do të ishte përfitues nga konsumi i këtij fruti të shijshëm e me vlera të rralla.

Osman Xhili

Nga **MIRAN TAFA**

Fundi i majit dhe fillimi i qershorit gjithë Dibra i gëzohet frutit të qershisë, pasi jo vetëm është fruti i parë i vitit, por është i ëmbël dhe është shumë ndjellës kur e shikon në fotografi.

Por si është situata me këtë frut kaq të kërkuar, që çmimi lëviz me ditë, nga më e shtrenjta 500-700 lekë kg në Tiranë, deri në ditët e fundit që e gjen në dyqane në kryeqytet edhe me 50-60 lekë?

Në Dibër, vitet e fundit shumë fermerë e kanë mbjellë qershinë, ndërsa disa prej tyre kanë trashëguar qindra rrënjë nga periudha e komunizmit. Dhe jo vetëm për konsum familjar, por edhe për të hedhur në treg e shitur. Dy-tre vitet e fundit prodhuesit e qershive ishin të kënaqur me fitimet e tyre nga shitja e qershive, për aq sa kishin. Fitimet ishin modeste për arsye se edhe numri i rrënjëve të mbjella nga fermerët ishte relativisht i vogël. Por edhe me çmimin ishin të kënaqur të gjithë prodhuesit. Por këtë vit, përkundër prodhimit të madh dhe cilësor, tregu ofroi shumë pak përkrahje, duke i lënë kokrrat e qershisë të kalben në pemë, fermerët e mërzitur dhe tregun e uritur.

PAK HISTORI

Ishin vite të arta ata, kur qershia eksportohej. Një nga specialistët me përvojë të agronomisë, Qerim Kadriu, tregon se ajo shkonte shpesh e konservuar në formën e kompostos dhe te reçelit në Kinë dhe Gjermani. 365 hektarë kultivoheshin në Dibër asaj kohe. Mund të përmendim disa blloqe me qershi si Ravnat me 66 hektarë, Zbineci me 47 hektarë, Kabe me 23 hektarë, Kuplani me 13 hektarë e shumë të tjerë si këto.

"Fatkeqësisht, - thotë Osman Xhili, një ekspert i frutikulturës pranë Drejtorisë së Bujqësisë në Dibër, - disa blloqe me mijëra rrënjë u prenë e u sakatuan, të tjerë mbijetuan e janë shëndoshë e mirë dhe sot e kësaj dite. Ky fakt të le të kuptosh se ky frut jo vetëm lufton plakjen, por dhe vetë druri i qershisë, thuajse nuk e njeh plakjen".

"Në bllokun e Ravnave, - thotë Xhili, - gjetëm një rrënjë qershie me përmasa të rralla. Diametri i trungut ishte 1,2 metër, perimetri afër 4 metra , kurse mosha e saj 55 vjeç. Prodhimi i një peme të tillë mund të shkojë mbi 7 kv, që e llogaritur me një çmim prej 100 lekë për kilogram, përfitimi në total nga një rrënjë e tillë shkon diku te 500 euro".

Qershia është shumë e përshtatshme për rajonin e Dibrës. Shfrytëzon shumë mirë tokat skeletike, gurishtore dhe e toleron mjaft mirë mungesën e vaditjes. Ajo pothuajse nuk do krasitje, kurse numri i spërkatjeve nuk është më shumë se tre. "Ky fakt, - thekson Osman Xhili, - ka dy vlera të mëdha: e para sepse shkurtohen mjaft shpenzimet, dhe dyta e bën qershinë një frut shumë bio".

"Kultivimi i saj mund të realizohet me sukses që nga lartësia 400 metra në Katund të Ri, te fermeri Flamur Nikolli, deri në 1200 metra lartësi në bllokun e Kuplanit te fermerët e Grevës dhe Begjunecit. Kjo bën të mundur realizimin e një konvejeri të natyrshëm, ku lartësia shkon në sinkron me kohën e daljes së saj në treg. Dibra hap tregun e qershive nga 15 maji, me *Burlatin* e hershëm, dhe e mbyll diku nga fundi i qershorit me varietetet e vona *Napolon* dhe *Belica* e Luznisë", - tregon Osman Xhili.

QERSHITË NË RRUGË

Foto më poshtë tregon një histori. Një tregtar, ashtu si të gjithë ditët e tjera, kishte dalë të shiste në tregun e improvizuar përballë Pallatit të Sportit "Bashkim Lala". Dhe në pritje të klientëve, dikush ishte afruar dhe kishte kërkuar që të blinte me 100 lekë tre kilogramë. Dhe tregtari i mërzitur i kishte hedhur demonstrativisht në rrugë, në shenjë proteste. Ato qershi të hedhura ishin aq të mira, saqë, po të mos ishin përtokë dhe mos më shikonte njëri, mund të kisha marrë ca kokrra për të ngrënë.



Për ta kuptuar këtë situatë jemi përpjekur ta shohim gjendjen me sytë e prodhuesve, konsumatorëve, tregtarëve, por edhe specialistëve të fushës. Sepse të gjithë ankohen nga pak: tregtarët fitojnë pak, prodhuesit i shesin shumë lirë, konsumatorët nuk kanë lekë t'i blejnë, ndërsa specialistët nuk po gjejnë zgjidhjen që ky zinxhir të funksionojë.



Gëzuar Muajin e Qershive

A e dinit qe në jemi në muajin e qershive? Epo, në Shqipëri të paktën.

Gjuha Shqipe ka një fjalor me baza mjaft të vjetra, por shume fjale të tjera janë marrë nga gjuhët fqinje. Shumica e emrave të muajve janë të bazuara në latinishte, prandaj lexuesit e huaj mund të hamendësojnë lehtë për disa muaj, si Janar (January në anglisht), Maj (May në anglisht) etj.

Gjithsesi, janë tre muaj në kalendarin shqiptar me emra që janë plotësisht Shqiptarë dhe janë të lidhur direkt me cilësi të muajit ose ndodhi të veçanta qe mund t'i shikosh vetëm në atë kohe të vitit.

Këta muaj janë Shkurti, që në kuptimin e plotë të fjalës do të thotë "Muaji i shkurtër", Korriku – "Muaji i të korrave" dhe Qershori – "Muaji i qershive"

Duke gjykuar nga bollëku i qershive nëpër dyqane dhe pemë në gjithë Shqipërinë ketë muaj, emri duket shumë i përshtatshëm.

Kur ishin nën sundimin Osman, Shqiptarët përdornin atë qe të vjetrit e quajnë "Kalendari Turk" – i cili në fakt ishte kalendari hënor i përdorur nga shumë shtete Aziatike dhe të Lindjes së Mesme. Gjithsesi, përdorim sado pak i vogël i kalendarit perëndimor duhet të ketë qenë prezent.

Një fakt interesant është që Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë , për shembull, i referohet Nëntorit si "vjeshta e tretë", dhe jo Nëntor.

Andi Balla / threefivefive.net



Pemë qershie në Dibër. Foto: Osman Xhili

AQIF ZEBI: SITUATË E VËSHTIRË NË TREGUN E QERSHIVE

Aqif Zebi, tregtar dhe prodhues frutash në Peshkopi, thotë se "këtë vit situata ka qenë shumë e vështirë në tregun e qershive". Ai thotë se qershitë e tij i shet më shumë në Tiranë dhe më pak në rrethe.

"Destinacioni është vetëm për konsum familjar, industria zero. Ndërkohë që prodhimi ka arritur në qindra ton. Veç shpenzimeve të transportit, këtë vit paguajmë edhe një taksë prej një mijë lekësh të vjetra për arkë në tregun e Tiranës". Ai thotë se tregtinë e qershive e konkurron edhe importi, pasi marketingu i tyre është shumë eficient. "Nga tregtia e qershive fitoj vetëm 10 lekë për kg, - thotë Zebi, i cili thekson se zgjidhje mbetet vetëm një fabrikë grumbullimi dhe përpunimi për qershitë në veçanti dhe frutat e tjera në përgjithësi".

"Ka disa vite që fermeri Medin Kryemadhi, - tregon Osman Xhili, - prodhon bashkë me vëllezërit rreth 200 kuintalë qershi, në tentativë për ta shtuar atë. Ai luan rolin e një pike grumbullimi, pasi bashkë me prodhimin e tij ai dërgon në Tiranë dhe Berat qershitë e shumë fermerëve të tjerë. Vitin e kaluar ka evaduar rreth 100 ton, kurse këtë vit akoma më shumë".

"Ai përpiqet që të fusë një kulturë të re pune te fermerët e vegjël në lidhje me procesin e vjeljes, ambalazhimin e transportin e prodhimit, gjëra këto që rrisin mjaft cilësinë e prodhimit dhe vlerën e tij për në treg", - thotë Osmani.

NË FERMËN E QAMIL LATËS QERSHITË JANË PA VJELË

Qamil Lata është një tjetër prodhues qershie. 54 vjeç, me profesion zooveteriner, i është përkushtuar tërësisht fermës së qershive.

"Kam pasur pasion përpunimin e drurit dhe frutikulturën", - tregon ai, - por më shumë jam i lidhur me profesionin, pasi kishte më shumë interes. Nëpërmjet profesionit pata mundësinë që të investoj më shumë për frutikulturë, sepse dhe tokë kishim shumë. Në fakt këto toka nuk janë shumë të përshtatshme për t'u mbjellë me grurë apo misër, por shumë produktive për qershitë, sepse janë terrene të pjerrëta dhe nuk mbajnë shumë ujë, pasi uji i tepërt i dëmton qershitë".

Qamili ka 17 vjet që merret me kulturën e qershive. Në vitin e parë ai ka mbjellë 150 rrënjë, vitin e dytë 120 rrënjë të tjera dhe, pasi pa se kishte interes dhe çmimi i saj ishte i mirë në atë kohë, mbolla para 4 vjetësh edhe 526 rrënjë të tjera. Ai sot ka 770 rrënjë qershi, 270 prej të cilave me vjetërsi 17 vjeçare,

Qamili thotë se këtë vit ai ka prodhuar mbi 200 kv qershi, me të cilat ka pasur shumë problem gjetjen e tregut.

Ai nuk ka mbjellë rrënjë të reja këtë vit, dhe po mendon se në qoftë se tregu do të vazhdojë të jetë si këtë vit, do të mendojë t'i presë disa rrënjë. Në vend të tyre mund të mbjell plepin dhe paulonjën, të cilat për momentin kanë shumë leverdi.

Terreni ku Lata ka mbjellë qershitë është i pjerrët, ujin e tepërt e kullon, shpati është i ekspozuar ndaj rrezeve të diellit, kushtet e vaditjes janë shumë të mira pasi sistemin e vaditjes e ka me tubacione dhe kjo garanton një frut cilësor dhe të pëlqyeshëm në treg.

"Këtë parcelë e kam mbjellë me kultivarë jo vegjetative te egra, janë të vaktit, tregon Osmani një pjesë të fermës së tij. I kam shkulur të egra në mal, i kam mbjellë dhe shartuar vetë, sepse në kohën kur i kam mbjellë unë nuk shiste kush fidane qershie. Vaditja realizohet me tubacione



Qamil Lata në fermën e tij duke treguar qershitë e pavjelura

ku uji merret rreth 2.5 km larg, nga liqeni." Ai ka mbjellë edhe kultura të tjera si mollë dhe dardhë.

Lata thotë se vitet e fundit janë katërfishuar sipërfaqet e mbjella me qershi dhe për 2-3 vite, pasi ato të hyjnë në prodhim, do të kenë shumë ndikim në uljen e çmimit të qershive. Ndërsa këtë vit, faktori kryesor që çoi në uljen e çmimit, ishte superprodhimi i tyre. Ai thekson se në qoftë se do të vazhdojë rënia e çmimit, kjo do të çojë në uljen e interesit të fermerëve për qershinë dhe kjo do të çojë në prerjen e tyre. Ndaj zgjidhja e menjëhershme është mundësitë e gjetjes së një tregu jashtë vendit ose në rritjen e kapaciteteve përpunuese, fabrikave të reçelit dhe kompostove të qershive.

LUHATJET E ÇMIMIT

Qamil Lata thotë se vitet e kaluara qershinë e ka shitur direkt në parcelë me 120 lekë / kg. Ndërsa këtë vit ai ka arritur të shesë një pjesë me 90 lekë / kg, më vonë me 70 lekë dhe në fund e ka ulur çmimin deri në 55 lekë.

Qamili ka një punëtor specialist të përhershëm, i cili merret mirëmbajtjen e fermës, njëkohësisht menaxhon edhe punëtoret e tjerë sezonalë. Në kohën kur është vjelja ai merr rreth 30 punëtorë, të cilët marrin 15 lekë për çdo kilogram qershi të vjelë. Ka raste kur marrin edhe 20-25 lekë për kg, për shkak të vështirësisë në degët e larta të pemës".

Me këtë treg të këtij viti, Qamili nuk është i kënaqur me tregun. "Unë kam sipërfaqe të mëdha dhe nuk kam dalë me humbje, thotë ai, por po të kisha më pak nuk më mbetej gjë si fitim".

Çmimi i pranuar për fermerët sipas tij është 90 lekë / kg. Ndërsa çmimi 55 lekë / kg, për të si prodhues është fare pa fitim.

Në qoftë se koha do të mbajë me shira dhe prodhimi mund të jetë më pak se 150 kv, ai thotë se të ardhurat nuk i mbulojnë shpenzimet si krasitja, punimi, vjelja, vaditja, spërkatja, pagat e punëtorëve etj.

Për shkak të mungesës së tregut Qamili ka lënë më shumë se 20 kv qershi në pemë të pavjela, pasi nuk ka asnjë interes. Ato janë qershi të degëve më të larta për të cilat punëtorët kërkojnë më shumë për hak punë. "Do hanë edhe zogjtë pak" - thotë Qamili.

Osman Xhili thotë se kosto minimale e qershisë është 30 lekë kg, duke marrë parasysh zërat kryesorë si vjelja, punimet, spërkatja, etj.

TREGU I MUNGUAR

"Unë ua kam shitur tregtarëve, të cilët i tregtojnë në Tiranë me destinacion konsumin familjar, pasi qershitë e mia janë shumë cilësore në rendiment dhe shije", - thotë Qamil Lata.

Tregu vendas në Peshkopi ofron shumë pak për qershinë dhe është krejt i papërfillshëm. Lata thotë se "konsumi familjar është i ulët, pasi njerëzit nuk kanë mundësi të blejnë, sidomos këtë vit kur ka pasur një superprodhim".

"Duhet gjetur një mundësi që pjesa e cila nuk shitet për konsum, të grumbullohet në fabrika të përpunimit", - thotë Lata.

Osman Xhili thotë se në zyrat e tyre shkojnë shpesh prodhuesit e qershive dhe kërkojnë ndihmë për të gjetur treg, por institucioni i tyre nuk ka rol direkt për gjetjen e tregut. Megjithatë, thekson Xhili, pati interes nga një tregtar dibran në Tiranë, i cili eksporton fruta drejt Rusisë dhe shprehu gatishmërinë për të ardhur në Dibër dhe për ta blerë me 80 lekë/ kg, por rezultoi se gjatë transportit, për shkak të rrugës së keqe, qershitë dëmtoheshin dhe kështu që nuk u arrit ndonjë rezultat".

Është koha të hidhen sytë dhe nga tregu i jashtëm. Është kjo një kërkesë e dyanshme. Dhe të huajt kanë filluar të interesohen. Biznesmenë italianë, nga Kosova, Serbia apo vende të tjera po hedhin sytë gjithmonë e më tepër nga prodhimet tona. Por që të bëhet kjo lidhje duhet vullnet, duhet vizion, duhen prodhime cilësore, duhet dashuri për kombin dhe njerëzit e punës - thekson Osman Xhili.

Osmani thotë se "kohët e fundit, kemi qenë në kontakt me Dhomën Britanike të Tregtisë, dhe jemi në bisedime për të gjetur treg europian për qershinë e Dibrës. Bisedimet po vazhdojnë dhe shpresojmë shumë që të gjejmë një zgjidhje".

ROLI I SHTETIT

"Pa diskutim shteti ka rolin e vet, - thotë fermeri Qamil Lata. Shteti mund të kreditojë një investitor të mirë, më qëllim që ta çojë lekun tek i zoti i punës, i cili lidhet me vendet e tjera, gjen tregjet etj. Domosdoshmëri është rregullimi i marrëdhënieve tregtare me anë të kontratave, formalizimi sipërmarrjeve. Duhet gjithashtu të futet në lojë siguracioni, i cili siguron prodhimin dhe rrit motivimin e fermerëve për të punuar. Më shumë interes duhet nga pushteti lokal dhe drejtoria e bujqësisë. Kur i mbolla në fillim qershitë, kërkova subvencionimin e sistemit vaditës, por nuk më dhanë, sepse e quajtën jashtë kritereve".

"Ka kohë që nga qeveria shqiptare flitet për qendrat e grumbullimit, - thotë Osman Xhili. Kjo do ta përmirësonte mjaft situatën, duke realizuar zinxhirin prodhues, grumbullues të nivelit të parë, ndoshta dhe një tjetër i nivelit të dytë, për të shkuar te konsumatori apo për eksport të jashtëm. Pika e grumbullimit do të kishte ambalazhin më të përshtatshëm, pse jo dhe ruajtjen e mallit për ca ditë në kushte frigoriferike. Po kështu, sasitë e mëdha të prodhimit janë më të fuqishme e më të sigurta në lidhjen e kontratave me partnerë të tjerë. Kështu fermeri do të çlirohej nga stresi i tregut, duke fituar dhe një kohë të çmuar në funksion të shërbimeve të tjera bujqësore", - thekson ai.

Osmani tregon se shumë ide shpalosen në tavolinën e zgjidhjes së problemit. Në Dibër ka pasur një fabrikë përpunimi të frutave, shumë moderne dhe shumë funksionale. Fermeri Veip Salkurti ka sjellë nga Franca një linjë të prodhimit të lëngut të mollës bio. Medin Kryemadhi mendon se duhet një tjetër për komposto, reçelna, gliko apo të tjera nënprodukte. Një fabrikë e këtij lloji, e hapur para pak vitesh në Peshkopi, që quhej "Selxhaferi" nuk funksionon më, pasi ka pasur vështirësi financiare.

"Është koha të hidhen sytë dhe nga tregu i jashtëm. Është kjo një kërkesë e dyanshme. Dhe të huajt kanë filluar të interesohen. Biznesmenë italianë, nga Kosova, Serbia apo vende të tjera po hedhin sytë gjithmonë e më tepër nga prodhimet tona. Por që të bëhet kjo lidhje duhet vullnet, duhet vizion, duhen prodhime cilësore, duhet dashuri për kombin dhe njerëzit e punës", - thekson Osman Xhili.

Qamil Lata thotë se rruga e Arbrit mund të ndikojë në gjallërimin e jetës ekonomike të rajonit dhe sidomos në gjetjen e tregjeve të shpejta dhe të reja jo vetëm për qershinë, por për të gjitha prodhimet bio të Dibrës.

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 110

Në median qendrore Dibra përmendej shumë rrallë në lajme, analiza dhe debate. Edhe kur përmendej, konsiderohej si fitore e sigurt e të djathtës. Kështu që, rezultati u quajt një surprizë. Ndërsa nga të majtët, për shkak se numërimi në Dibër ishte ndër të fundit, u konsiderua si "qershia mbi tortë".

zgjedhje

KOMENT / MESAZH PËR SHUKRI XHELILIN:

Koha që politika ta luftojë varfërinë!

Nga **DIONIS XHAFA**

Shqipëria më 21 qershor 2015 mbajti zgjedhje lokale. Shqiptarët, përmes votës së ushtruar, folën. Duke qenë gazetar në media, e kam ndjekur me shumë vëmendje këtë fushatë dhe faktin se kush do të jenë 61 kryebashkiakët që do të udhëheqin bashkitë e vendit. Ashtu siç shumë sondazhe parashikuan, por edhe siç pritej, koalicioni PS-LSI, ose Aleanca për Shqipërinë Europiane fituan shumicën e bashkive. Më tepër se ideologjia, se kush arriti të fitojë nga koalicionet, besoj se ka rëndësi njeriu i zgjedhur për drejtim. Shqiptarët, aq sa folën me votë, dëshmuan se nuk zgjodhën aq për ideologji, por mbi të gjitha njeriun që do ti përfaqësonte më denjësisht. Në mendimin tim, kjo duket sidomos në Përmet dhe në Dibër, pasi bashkia e jugut, edhe pse ka një elektorat të thekur të majtë, u fitua nga kandidati i PD-së, ndërsa bashkia e Dibrës, edhe pse ka një elektorat që anon nga e djathta, zgjodhi kandidatin e PS-së.

REALITETI NË DIBËR

Kam jetuar për mëse 15 vite në Maqellarë të Dibrës, një zonë e thekur e djathtë, e rrëmbyer pas Partisë Demokratike dhe ku për 24 vite rresht ka bërë ligjin PD-ja dhe ku kryekomunari ishte bërë si një bejler i një zone të tërë, duke u rizgjedhur për tre apo katër herë më rradhë, rresht. Maqellara, duke patur njerëz më shumë se ç'duhet të djathtë, ose më mirë të thuhet me PD-në, e vuante në kurriz këtë, pasi kryekomunari i zgjedhur, duke e patur votën e sigurt, nuk bënte sa duhej për zonën. Maqellara, gjatë tranzicionit, u shndërrua kështu në në një zonë që kontrollohej nga një kastë njerëzish të lidhur politikisht dhe ekonomikisht, një pakicë sunduese, thuajse si bejlerët e dikurshëm. Kryekomunari i larguar i zonës kishte lënë të ndërtohej sa të mundej, vend e pavend, duke e shitur këtë si arritje, kur në fakt minohej gjelbërimi dhe hapësira publike. Ish-kryekomunari i Maqellarës e kishte lënë zonën të katandisej në varfëri dhe në skamje për shumicën e popullsisë, pa ujë të pijshëm, edhe pse Maqellara është ndër zonat, për mua, e bekuar nga Zoti, për nga bukuritë. Së fundmi, madje kryekomunari as që jetonte në Maqellarë, por në Tiranë, duke mos ndjerë në zemër dhe në shpirt dhimbjen, problemet dhe hallet që kanë në përditshmëri ata banorë të zonës. Veç disa politikave deri diku të drejta, Maqellara, zonë e bekuar nga Zoti në bukuri, rrëzë vargmaleve të Korabit dhe brigjeve të Drinit të Zi, është lënë ashtu....e paprekur ku duhet nga pushteti vendor, por vetëm nga dora e njeriut, që e ka betonizuar dhe po e çon drejt rrënimit. Në Maqellarë kam jetuar dhe e njoh skamjen, varfërinë, dhimbjen e atyre njerëzve që jetojnë me pak para, që mezi e shtynë ditën, me barkun herë të mbushur dhe herë bosh. Në këtë komunë, kam parë atë varfëri që e përshkruan edhe Migjeni, në shkollën time, ku vinin edhe djem, që kishin arrnuar rrobat, me çorape të grisura, me çanta të qepura, të palarë, të vrarë shpirtërisht, të lënë mënjanë, që ngazëlleheshin teksa blinin ndonjë copë bukë në dyqan, që jetonin në shtëpi barrake thuajse të rrënuara. Kur flas për realitetin e Maqellarës, kam parasysh këtu edhe ata ish-komuna që kanë ngritur në model të shëmtuar dhe në sistem këtë lloj varfërie që gëlon dhimbshëm në rrugicat e harruara të provincës.

Por, se me kryerjen e reformës territoriale, ku komunat u rrënuan si njësi administrative, pushteti është tashmë vetëm në dorë të bashkisë, në rastin konkret të Peshkopisë. Në mendimin tim, reforma e re territoriale ka mënjanuar ndjeshëm burrokracitë në qeverisje, duke lënë shkas që të mënjanohet edhe mënyra si është qeverisur deri më tashmë, me bejlerë dhe agallarë të zonave. Tashmë, nëse qeveriset siç duhet, Dibra, por edhe e mbarë Shqipëria, e kanë mundësinë e ndryshimit të madh.

E MAJTA FITON DIBRËN

Beteja politike këtë herë në Dibër ishte përqëndruar në atë se kush do ta marrë Peshkopinë, Ilir Krosi i PD-së, ish-kryebashkiak apo Shukri Xhelili i PS-së, i cili garonte për herë të parë. Gara ishte e fortë deri në fund dhe vetëm në kutinë e parafundit u mësua fituesi dhe ai ishte Shukri Xhelili i ASHE (Aleancës për Shqipërinë Europiane). Fitoren e Xhelilit do ta konsideroja një fitore të madhe, për atë se një zonë ideologjikisht e djathtë si Dibra, zgjodhi kandidatin e së majtës. Mesazhi që dhanë njerëzit ishte se para se të shohin partinë, ata shohin njeriun dhe duan ndryshim të realitetit. Po ashtu, fitore është edhe se, sot pas 25 vitesh pluralizëm, sa duket në Dibër ka rënë miti i identifikimit të së majtës me periudhën e komunizmit. Gjergj Fishta, kur ka folur për dibranët, ka thënë se "mendja ka lindur në Dibër". Në këto zgjedhje, dibranët u treguan të mençur në votën e dhënë. Duke mos e gjykuar Ilir Krosin, i cili ka patur të mira dhe të këqija në drejtimin e Bashkisë, ndoshta është koha që edhe ai vetë ta kuptojë se në Dibër duhej rotacioni, kjo në shërbim të një demokracie më të mirë. Nga ana tjetër, Shukri Xhelili nuk duhet ta shohë fitoren si triumf përballë Ilir Krosit, por si një përgjegjësi të asaj me ç'ka përballen sot shumica e dibranëve. Kjo pasi Dibra, për fat të keq dhe për hir të realitetit, është ndër zonat më të varfëra të Republikës. Kryetari i ri i Dibrës duhet ta dijë mirë këtë, ta ndjej atë dhimbje që ndjejnë njerëzit në përditshmëri, të jetojë së bashku me këtë dhimbje. Xhelili e ka në dorë ta ndryshojë realitetin e ashpër që ekziston në mbarë zonën e Dibrës, duke e vënë politikën në shërbim të njerëzve të harruar për kaq kohë pikërisht nga politika. Xhelili e ka në dorë edhe që ta ndryshojë imazhin që ekziston për zonën e Dibrës dhe për Peshkopinë. Nëse kryetari i ri bëhet vërtetë shërbëtor i njerëzve të harruar dhe të mjerë të zonës, do të mund të sillte ndryshime. Por, sa kjo do të vihet në punë në realitet, mbetet për tu parë!..

Tiranë, 26.06.2015.

Basir Çupa dhe Melaim Damzi i fituan zgjedhjet me diferencë të madhe votash me kundërshtarët, ndërsa Adelina Farrici e ASHE humbi përballë Nezir Rizvanit të APPD me 181 vota diferencë dhe Shukri Xhelili i ASHE fitoi në Dibër kundrejt Ilir Krosit të APPD me 439 vota më shumë

Zgjedhjet lokale:

Nga **BUJAR KAROSHI**

Zgjedhjet lokale të 21 qershorit e ndanë në mënyrë të barabartë elektoratin në qarkun e Dibrës: dy bashkitë, Mat dhe Klos, i fitoi Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, ndërsa Bulqizën dhe Dibrën i fituan kandidatët e Aleancës për Shqipërinë Europiane.

Basir Çupa dhe Melaim Damzi i fituan zgjedhjet me diferencë të madhe votash me kundërshtarët, ndërsa Adelina Farrici e ASHE humbi përballë Nezir Rizvanit të APPD me 181 vota diferencë dhe Shukri Xhelili i ASHE fitoi në Dibër kundrejt Ilir Krosit të APPD me 439 vota më shumë, falë edhe ndihmës që i dhanë tre kandidatët, njëri i pavarur dhe dy të tjerët nga Partia Aleanca Popullore dhe Partia e Bashkimit të të Drejtave të Njeriut.

ZGJEDHJET NË SHIFRA

DIBËR: Në Bashkinë e Dibrës gara ishte më e fortë, jo vetëm se garonin pesë kandidatë për kryetarë, por edhe sepse Dibra konsiderohej një nga bashkitë e sigurta për Partinë Demokratike dhe aleatët e saj.

Në median qendrore Dibra përmendej shumë rrallë në lajme, analiza dhe debate. Edhe kur përmendej, konsiderohej si fitore e sigurt e të djathtës. Kështu që, rezultati u quajt një surprizë. Ndërsa nga të majtët, për shkak se numërimi në Dibër ishte ndër të fundit, u konsiderua si "qershia mbi tortë".

Shukri Xhelili i Aleancës për Shqipërinë Europiane mori 48.10% të votave, saktësisht 15027 vota, kundrejt 14588 vota që mori Ilir Krosi i Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet, ose 46.70%. Shukri Xhelili arriti ta fitonte mbështetjen kryesisht në Komunat Lurë, Arras dhe Muhurr, ku diferenca me Krosin ishte shumë e ndjeshme. Në komunat e tjera diferenca ishte shumë e vogël me njëri -tjetrin, ndërsa në Kastriot ata morën nga 1350 vota secili.

Dik Spata, një militant i Partisë Demokratike, i shfaqi ambiciet e tij për kryetar bashkie nën siglën e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Partia konsiderohet pa asnjë ndikim në Dibër - edhe për shkak të emrit të kryetarit të saj, - por Spata arriti të marrë 550 vota ose 1,76%. 290 prej tyre ai i mori në Blliçe, fshat në ish komunën e Fushë Çidhnës, ndërsa 92 vota mori në Kastriot dhe 62 në Sllovë. Në komunat e tjera Spata dhe partia e tij numëronin vota më pak se gishtat e njërës dorë.

Kandidati tjetër i Partisë Aleanca Popullore, Zaim Korsi, arriti të merrte në Dibër 373 vota. Korsi vinte nga strukturat dhe forumet kombëtare të Partisë Demokratike, njihet si një biznesmen ndërtimi dhe që ka financuar shtatoren e Skënderbeut në Peshkopi. Korsi konsiderohet se e dëmtoi ndjeshëm të djathtën në Maqellarë me 172 vota dhe në Peshkopi me 97 vota.

Por, kandidati që konsiderohet që i dha "shkelmin" fitores së PD në Peshkopi është Ilir Bulku, anëtar i PD-së, një biznesmen, dikur shumë me ndikim në radhët e Partisë Demokratike. Bulku kandidoi si i pavarur dhe mori në këto zgjedhje 702 vota, nga të cilat 264 në Peshkopi dhe nga 71 vota në Maqellarë dhe Melan. Gjithashtu, Bulku konsiderohet se ka marrë "mirënjohjen" e socialistëve dhe "urrejtjen" e demokratëve, pasi konsiderohet se i ka dhënë një goditje të fortë Partisë Demokratike në këto zgjedhje në Dibër *(Për më shumë rreth rezultateve në Dibër, shih tabelën).*

BULQIZË: Bulqiza konsiderohej si një zonë që e djathta mund të kishte ndikim. Por kandidati i Aleancës për Shqipërinë Europiane, Melaim Damzi, i vendosur si kandidaturë nga Lëvizja Socialiste për Integrim, arriti të fitonte thellë ndaj kandidatit të Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet, Durim Balla. Balla mori 7207 vota ose 43,75%, ndërsa Melaim Damzi i mori 9267 vota ose 56,25%.

Durim Balla fitoi në Fushë Bulqizë me 972 vota, 226 më shume se Damzi që mori 746 vota dhe në Zerqan me 1313 vota kundrejt 863 të Damzit.

Në të gjitha komunat e tjera Melaim Damzi mori më shumë vota se kandidati i APPE. Në Shupenzë ai mori 1014 vota më shumë, në Bulqizë 650 vota, në Martanesh 316 vota, në Ostren 219, Trebisht 143 dhe Gjoricë 394 vota.

MAT: Nezir Rizvani i Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet i fitoi zgjedhjet me 8270 vota ose 50,55%, ndërsa Adelina Farici e Aleancës për Shqipërinë Europiane mori 8089 vota ose 49,45%.

Farrici fitoi në Burrel, aty ku ka qeverisur katër vitet e shkuara me 396 vota plus, si dhe në Ulëz me 184 vota.

Ndërsa Rizvani fitoi në ish komunat Baz me 257 vota avantazh, Komsi me 40 vota, Lis 46, Rukaj 172, Derjan 58 dhe Macukull 188 vota më shumë se kundërshtarja.

KLOS: Basir Çupa i Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet mori 5127 vota ose 55,58%, ndërsa Valbona Kola e Aleancës për Shqipërinë Europiane mori 4097 vota ose 44,42%.

Në të gjitha ish komunat Gurrë, Suç, Xibër dhe ish-bashkinë Klos, Basir Çupa ishte fitues me diferencë të madhe votash. Në Gurrë ai mori 355 vota më shumë se Valbona Kola, në Suç 185, në Xibër 98 dhe brenda në Klos 392.

SITUATA PARAZGJEDHORE DHE DITËN E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve dhe votimi shkoi qetë në Dibër në të katër bashkitë. Në votime shkuan 75071 votues ose 57,74 për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e votimeve.

Por situata parazgjedhore nuk ishte dhe aq e qetë. Stafet e kandidatëve herë pas here bënin publike në rrjetet sociale "shkeljet ligjore" të kundërshtarëve, sidomos për sa i përket çështjeve etike.

Një faqe në Facebook, "Peshkopia Today" denoncoi në disa portale atë që ajo e konsideronte si presion që po u bëhej mësuesve dhe zyrtarëve të shtetit nga Partia Socialiste. "Një sondazh fals i dirigjuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër duke u prezantuar si një kompani prestigjoze sondazhesh dhe përfituar nga situata zgjedhore ka telefonuar të gjithë mësuesit e shkollave të qytetit e fshatrave, duke provokuar dhe drejtuar pyetjen, se kush fiton zgjedhjet?", shkruante në murin e saj faqja. Sipas Peshkopia Today, mësuesve u është bërë presion psikologjik dhe shantazhi me kërcënime për largim nga puna, mosrinovim kontratash. Ajo shkruante se presione të kësaj natyre u është bërë edhe maturantëve që votojnë për herë të parë.

Ndërsa kandidati i PD në Peshkopi, në faqen e tij publikoi një përgjim telefonik mes një pacienti dhe mjekut të tij, i cili ofronte dy vota për Partinë Socialiste në këmbim të firmosjes së dokumenteve për të dalë në kemp.

Një burim pranë Partisë Socialiste tha për gazetën se të gjitha këto janë trillime. "Partia Demokratike i ka bërë dikur këto marifete dhe tani ngaqë nuk i ka këto institucione nën kontroll, kujtojnë se të njëjtën gjë bëjmë edhe ne".

Por një anëtar i stafit të Ilir Krosit tha se janë rreth 40 mësues që janë pezulluar nga puna. "Gjithashtu, tha ai, ne kemi fakte për kontrata të nënshkruara nga kandidati i ASHE në kundërshtim me ligjin, që tregojnë blerjen e votave si dhe shkeljen e ligjit zgjedhor". Sipas tij, këto dëshmi u janë dhënë vëzhguesve të zgjedhjeve vendore.

"Është Partia Socialiste në Dibër që ka publikuar në faqen e saj në orën 7:13 minuta të mëngjesit një fotografi të fletës së votimit, tha një zyrtar i PD, i cili kërkoi të mos identifikohej, për shkak se ai nuk kishte leje nga stafi për të folur me shtypin. Sipas tij, shumë zyrtarëve u është kërkuar fotografimi i votës.

Ndërsa në Bulqizë, thuhet se krahas përpjekjeve për të fituar kandidatët, një luftë e heshtur ishte mes socialistëve dhe anëtarëve të LSI. "Partia Socialiste në Bulqizë ka punuar kundër kandidatit të ASHE, kështu që fitorja e Melaim Damzit në Bulqizë mund të konsiderohet një fitore e pastër e partisë së Ilir Metës".

Drejtues të fushatës së Damzit nuk pranuan të komentojnë këto dyshime. "Fitorja e Damzit ishte e pastër dhe kjo u arrit falë punës së përbashkët të anëtarëve të PS dhe LSI", - tha një anëtar i stafit të Damzit.

Por, pak ditë pas zgjedhjeve, një anëtar i Partisë Socialiste u pushua nga puna në Bashkinë e Bulqizës, që deri më tani drejtohet nga socialistët. Në komentet në Facebook, ish punonjësi i bashkisë F. Jella, shkruante se "sot jam pushuar nga puna nga Myfiti, sepse unë mbështeta hapur dr. Melaimin dhe nuk i shkova pas Myfitit, që luftonte për votat e PS dhe për Durimin si kandidat".

Një kuti votimi e fshatit Gjuras në Bulqizë u bë lajm kryesor mbrëmjen e zgjedhjeve. Partia Demokratike, me zërin e deputetit Edi Paloka, akuzonte se "një grup prej disa militantësh të LSI-së kanë grabitur një kuti votimi, atë të Gjurasit, e cila ka qenë duke u transportuar me furgonin e KZAZ-së, siç parashikon Kodi zgjedhor, por militantët e LSI-së i kanë dalë para furgonit, kanë rrëmbyer kutinë e votimit dhe e kanë transferuar në një fuoristradë të tyre".

Ylli Manjani nga LSI iu përgjigj Palokës duke e interpretuar ndryshe situatën. Ai tha se "në Fushë-Bulqizë mbështetës të PD, të mbështetur nga deputeti i PD Keta dhe kandidati Balla kanë zënë rrugën makinës që transportonte dy kutitë e fundit të fshatit Gjurras". Ai tha se kjo ishte tentuar edhe më parë të ndodhte në Shupenzë, por nuk ia kishin arritur qëllimit.

Kjo situatë u zgjidh nga prania e policisë në vendngjarje dhe kanë qenë anëtarët e KZAZ që morën në dorëzim materialet.

Qendra e votimit në Gjuras mbante numrin 1067 dhe kishte 314 votues të regjistruar. Pas numërimit në këtë

"Dibra ka vlera dhe vlerat do të triumfojnë mbi antivlerat. Ne nuk kemi pasur dhe nuk kemi arsye të ulim kokën apo të bëhemi pesimistë. Ne jemi dhe do të jemi këtu në Dibër, në mbrojtje të idealeve të lirisë dhe demokracisë, në mbështetje të të drejtave të qytetarëve, në mbrojtje të vlerave të Dibrës dhe kontribues në vazhdim për zhvillimin e qytetit dhe të mbarë Dibrës", shkruante Krosi.

Dibra zgjedh **majtas, Mati** shkon **djathtas**







Në foto: Melaim Damzi (majtas) duke votuar në Bulqizë. Shukri Xhelili (foto në mes) duke përshëndetur në mitingun e fitores. Foto djathtas: Nezir Rizvani (në mes) gjatë një takimi në Bazë, aty ku votat që i solli fitoren në Mat.

qendër votimi, rezultoi se në zgjedhje kishin marrë pjesë 187 qytetarë, nga të cilët për Melaim Damzin kishin votuar 157, ndërsa vetëm 30 për Durim Ballën.

Situata më e rëndë parazgjedhore mund të konsiderohet incidenti në Klos, kur anëtarë të stafit të kandidates Kola kërcënuan shoferin e kandidatit të PD dhe një të afërm të tij. Denoncimin e bëri në Facebook vetë kandidati Çupa dhe deputeti Bedri Hoxha.

Situata ishte e acaruar edhe në Selishtë ditën e zgjedhjeve, si dhe gjatë procesit të numërimit të votave, ku palët për shkak të rezultatit të ngushtë, shpesh herë ishin të acaruar.

FALËNDERIMET E FITUESVE

Menjëherë pas shpalljes së rezultatit, kandidati Shukri Xhelili shkroi në faqen e tij në FB falënderimet për zgjedhësit e tij. "Faleminderit që besuat te unë! Faleminderit që i dhatë mundësinë e ndryshimit Dibrës! Faleminderit që bëtë zgjedhjen e duhur! Ju më zgjodhët mua, dhe unë ju premtoj që do punoj fort për zhvillimin e Dibrës dhe për mirëqenien tuaj", shkroi ai. Xhelili theksonte se "kontributi dhe mbështetja juaj në këtë fitore historike është e paçmueshme!".

"Votëbesimi juaj është njëkohësisht kënaqësi dhe përgjegjësi për ta çuar Bulqizën në drejtimin që meriton për më shumë shërbim dhe punësim, shkroi pas fitores Melaim Damzi. Duke falënderuar të gjithë banorët e rrethit Bulqizë, pa dallim, për mbështetjen e vazhdueshme, e cila u kurorëzua me një fitore të thellë të Aleancës për Shqipërinë Europiane, ai theksoi se nuk na mbetet gjë tjetër veçse t'i përvishemi punës për të përmbushur premtimet tona dhe për t'i shërbyer çdo banori të rrethit Bulqizë".

Nezir Rizvani, kandidati fitues në Mat shkroi pas fitores se "do përpiqem me të gjitha mundësitë e mia që këtë mbështetje që më keni dhënë ju ta rikthej te ju, duke ju shërbyer me punë, përkushtim e ndershmëri".

Ndërsa kandidati fitues i bashkisë Klosi e festoi fitoren me një koncert në qendër të qytetit, ku morën pjesë këngëtarët Bujar Qamili,Valbona Mema, Esat Ruka etj.

REAGIMET E HUMBËSVE

Ilir Krosi iu drejtua me një mesazh të gjatë qytetarëve, ku pas falënderimeve për mbështetjen që i dhanë strukturat e Partisë Demokratike, aleatët dhe votuesit e tij, solli edhe argumentet e para se pse ai humbi zgjedhjet.

"Ne u ballafaquam me kundërshtarë të shumtë, me marifete, intriga dhe prapaskena të shumta", - shkroi ai në FB.

"Presioni dhe terrori i segmenteve të shtetit të sotëm, në administratë, arsim, shëndetësi, dosje të invalidëve, OSSHE, ndaj pensioneve etj., presioni i paparë i disa segmenteve të policisë mbi anëtarë dhe simpatizantë të PD, i detyruan shumë persona (deri tek intelektualët) t'i nënshtrohen dhe votojnë nën presion dhe terror psikologjik", shkruante Krosi.

Më pas, ai akuzonte tre kandidatët e tjerë në garë si të "rekrutuar" nga PS, pasi sipas tij, kjo ishte e vetmja mundësi që të përçahej e djathta.

"Rezultati ynë me - 439 vota, përkundër 1626 votave të marra nga kandidatët e "pavarur / rekrutuar", na bën humbës me aritmetikë, por e ndjejmë veten moralisht fitues. Moralisht e kemi fituar betejën, moralisht kemi mundur kundërshtarët dhe intrigat e tyre, por marifetet dhe intrigat fituan aritmetikisht".

Krosi kujton në mesazh lëvizjen studentore të dhjetorit '91 dhe shpreh shqetësimin se "demokracia është në rrezik nga "marifetet", presioni, arbitrariteti dhe terrori shtetëror e policor".

"Dibra ka vlera dhe vlerat do të triumfojnë mbi antivlerat. Ne nuk kemi pasur dhe nuk kemi arsye të ulim kokën apo të bëhemi pesimistë. Ne jemi dhe do të jemi këtu në Dibër, në mbrojtje të idealeve të lirisë dhe demokracisë, në mbështetje të të drejtave të qytetarëve, në mbrojtje të vlerave të Dibrës dhe kontribues në vazhdim për zhvillimin e qytetit dhe të mbarë Dibrës", shkruante Krosi.

Po me një mesazh të gjatë iu drejtua mbështetësve të tij edhe Durim Balla. "Për gjatë dy muajve pata nderin dhe kënaqësinë të isha më pranë secilit prej jush, në çdo fshat dhe lagje të tërë komunave të rrethit të Bulqizës. Kjo fushatë më dha mundësinë të bisedonim dhe të ndanim së bashku hallet, nevojat dhe realitetin në të cilin jeton sot çdo qytetar i Bulqizës. Në çdo çast dhe moment ne ofruam për ju vizionin tonë për secilin fshat dhe për qytetin, ofruam integritetin dhe përkushtimin, moralin dhe dinjitetin tonë, dhe gjeta tek ju dëshirën dhe shpresën për ta ndryshuar këtë realitet".

Ashtu si dhe Krosi, ai akuzon se "dhuna shtetërore ndaj të gjithë votuesve të punësuar në sektorin publik shtetëror, dhuna shtetërore ndaj votuesve të punësuar në sektorin privat, deri në largimin e punëtorëve dhe vagonistëve nga puna, shantazhimet me telefona, dhuna shtetërore ndaj përfituesve të ndihmës ekonomike, dhuna shtetërore ndaj përfituesve të pagesave dhe shpërblimeve të shtresave në nevojë, dhuna shtetërore ndaj përfituesve të shtresave me raporte të kempit, trafikimi i votave të shtresave të shoqërisë që sot nuk kanë bukën e gojës, bënë të mundur tundimin e votuesit, duke vënë në rrezik shumë të madh votën e lirë dhe demokracinë".

Duke falënderuar strukturat e PD, demokratët dhe simpatizantët, të cilët morën pjesë në punën e përditshme pranë shtabeve të fushatës, ai gjeti fjalë falënderimi edhe për "çdo socialist, me apo pa parti, për qetësinë, maturinë dhe qytetarinë e treguar gjatë fushatës dhe ditën e votimit. Njëkohësisht respektoj dhe çmoj vullnetin e çdo qytetari të shprehur nëpërmjet votës".

Ndërsa Adelina Farrici dha një mesazh të shkurtër në faqen e saj zgjedhore. "Sepse Mati ka peshë", ishte slogani i saj gjatë kësaj fushate, por Mati nuk pati vota për ta bërë edhe njëherë kryetare të bashkisë së madhe.

ANKETIMI I AIIS: *Ja çfarë mendojnë zgjedhësit mbi pushtetin vendor!*

Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare realizoi para zgjedhjeve një anketim në Dibër, për të vlerësuar mendimet mbi zgjedhjet dhe qeverisjen vendore. Rezultatet e testimit u prezantuan një javë para zgjedhjeve në Peshkopi, në praninë e anëtarëve të shoqërisë civile.

71 për qind e të anketuarve thanë se kishin marrë pjesë në zgjedhjet lokale dhe 77% e tyre deklaruan se do të merrnin pjesë në këto zgjedhje. 63% e atyre që nuk do merrnin pjesë në zgjedhje besonin se zgjedhjet nuk sjellin ndryshim, ndërsa 37% e tyre thanë se nuk besojnë te zgjedhjet e lira dhe të drejta.

Pyetjes se a jeni të informuar mjaftueshëm mbi reformën administrative që është miratuar kohët e fundit? 25% iu përgjigjen se janë të informuar. 38% thanë se janë informuar pak, ndërsa 23% thanë se nuk janë të informuar. Pjesa tjetër disi ose nuk e dinin.

Pyetjes nëse mendonin se reforma administrative ishte e nevojshme, 28 % thanë se ishte disi e nevojshme, 17% thanë se ishte e nevojshme, ndërsa 17 % thanë se nuk ishte e nevojshme. 35% nuk kishin opinion për këtë pyetje.

Pyetjes nëse ishin apo jo të kënaqur me reformën, vetëm 14% thanë se ishin të kënaqur, ndërsa 19% nuk ishin të kënaqur dhe 28% thanë se ishin pjesërisht të kënaqur.

Pyetësori trajtonte edhe disa çështje të tjera që kishin të bëjnë me marrëdhëniet pushtet lokal-pushtet qendror, komunikimet e qytetarëve me institucionet e bashkisë, sa të kënaqur ishin me gjendjen e shkollave, sa të kënaqur ishin me veprimtaritë kulturore, turistike, etj.

17% e të anketuarve ishin drejtuar të paktën një herë në bashki dhe 57% e tyre nuk ishin të kënaqur nga shërbimet që kishin marrë.

56% nuk e dinin se kush e zgjedh kryetarin e bashkisë dhe 25% besonin se atë e zgjedh kryetari i partisë. Në përqindje të afërt kishin edhe në lidhje me pyetjen se kush i zgjedh këshillat bashkiakë.

Ndërsa pyetjes se a mendonin se është bërë mjaftueshëm për zhvillimin ekonomik në bashkinë tuaj? 67% iu përgjigjën negativisht, ndërsa 30% nuk e dinin. Pyetjes se a mendonin se është bërë mjaftueshëm për mbrojtjen e mjedisit, 86% thanë Jo, ndërsa 10% nuk e dinin. Vetëm 4% iu përgjigjën pozitivisht pyetjes.

Anketimi u zhvillua disa muaj para zgjedhjeve, dhe për këtë u pyetën mbi 220 të anketuar, përzgjedhur sipas disa kritereve të moshës, gjinisë dhe qendrave të banimit qytetfshat. Ky anketim u realizua me mbështetjen financiare të fondacionit Friedrich Ebert Stiftung Tiranë.

NDARJA E VOTAVE NË BASHKINË DIBËR SIPAS KOMUNAVE

LURË

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	410
2. ILIR BULKU (I pavarur)	6
3. ILIR KROSI (APPD)	199
4.DIK SPATA (PBDNJ)	2
5.ZAIM KORSI (AP)	3

ZALL REC

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	217
2. ILIR BULKU (I pavarur)	9
3. ILIR KROSI (APPD)	211
4.DIK SPATA (PBDNJ)	2
5.ZAIM KORSI (AP)	2

ZALL DARDHË

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	224
2. ILIR BULKU (I pavarur)	7
3. ILIR KROSI (APPD)	238
4.DIK SPATA (PBDNJ)	4
5.ZAIM KORSI (AP)	0

ARRAS

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	752
2. ILIR BULKU (I pavarur)	18
3. ILIR KROSI (APPD)	621
4.DIK SPATA (PBDNJ)	9
5.ZAIM KORSI (AP)	5

MUHURR

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	762
2. ILIR BULKU (I pavarur)	40
3. ILIR KROSI (APPD)	596
4.DIK SPATA (PBDNJ)	6
5.ZAIM KORSI (AP)	7

SELISHTE

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	298
2. ILIR BULKU (I pavarur)	11
3. ILIR KROSI (APPD)	456
4.DIK SPATA (PBDNJ)	1
5.ZAIM KORSI (AP)	6

LUZNI

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	600
2. ILIR BULKU (I pavarur)	21
3. ILIR KROSI (APPD)	585
4.DIK SPATA (PBDNJ)	3
5.ZAIM KORSI (AP)	4

MAQELLARE

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	2354
2. ILIR BULKU (I pavarur)	71
3. ILIR KROSI (APPD)	2320
4.DIK SPATA (PBDNJ)	16
5.ZAIM KORSI (AP)	174

MELAN

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	793
2. ILIR BULKU (I pavarur)	71
3. ILIR KROSI (APPD)	879
4.DIK SPATA (PBDNJ)	7
5.ZAIM KORSI (AP)	15

TOMIN

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	1642
2. ILIR BULKU (I pavarur)	74
3. ILIR KROSI (APPD)	1941
4.DIK SPATA (PBDNJ)	11
5.ZAIM KORSI (AP)	25

PESHKOPI

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	4113
2. ILIR BULKU (I pavarur)	264
3. ILIR KROSI (APPD)	3766
4.DIK SPATA (PBDNJ)	34
5.ZAIM KORSI (AP)	97

KASTRIOT

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	1350
2. ILIR BULKU (I pavarur)	55
3. ILIR KROSI (APPD)	1350
4.DIK SPATA (PBDNJ)	92
5.ZAIM KORSI (AP)	25

FUSHE CIDHEN

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	390
2. ILIR BULKU (I pavarur)	25
3. ILIR KROSI (APPD)	498
4.DIK SPATA (PBDNJ)	290
5.ZAIM KORSI (AP)	10

SLLOVE

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	697
2. ILIR BULKU (I pavarur)	13
3. ILIR KROSI (APPD)	509
4.DIK SPATA (PBDNJ)	62
5.ZAIM KORSI (AP)	0

KALA E DODES

1. SHUKRI XHELILI (ASE)	425
2. ILIR BULKU (I pavarur)	17
3. ILIR KROSI (APPD)	419
4.DIK SPATA (PBDNJ)	11
5.ZAIM KORSI (AP)	0

Listën e këshilltarëve në bashkitë Dibër, Bulqizë, Klos dhe Mat mund ta lexoni në faqen 10.

Rruga e Arbërit nr. 110

Bashkia Klos ka një pozicion strategjik dhe shumë të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit, qoftë atij fushor për rreth 15 km që përshkon Lumi Mat, si dhe atij malor. Veçanërisht interes paraqet zona Ura e Vashës- Petralbë-Kalaja e Xibrit.

portret fituesi

Basir Çupa, kandidati i duhur për Klosin

Nga **FAIK XHANI**

Në Shqipëri akoma nuk jemi çliruar nga tabutë e komplekset agresive e të baltosjes së vlerave të individëve të veçantë për hirë të ngjyrave politike.

Harrohet kryesorja, se secili kandidat i çfardo spektri politik të jetë, ai në radhë të parë është një qenie njerëzore me një tërësi vlerash, profesionale, menaxhuese, humanitare e njerëzore dhe vetëm pas kësaj përqasje , që përbën dhe bazamentin e kandidatit vjen imazhi politik, që natyrisht ka shumë rëndësi, por kurrë nuk zëvendëson të parin: Identitetin dhe formimin si individ , si qenie njerëzore, si pjesë aktive e shoqërisë të një komuniteti e të një vendi.

Si unë edhe shumë intelektualë të fushave të ndryshme, veçanërisht për zgjedhjet vendore i japin prioritet konkurrentit që kandidon, formimit të tij, aftësive organizuese e drejtuese të tij, qëndrimit dhe sjelljes së tij, pavarësisht përkatësisë partiake. E rëndësishme është që kandidati që konkurron të jetë i përkushtuar, i komunikueshëm, i pakompromet ueshëm dhe i vendosur për të bërë më të mirën për komunitetin.

Një i tillë për mua qe dhe është edhe Basir Çupa. Këtë bindje ma përforcon akoma më shumë edhe fakti, që unë Basirin e kam njohur për më shumë se 3 dekada, si student, si veprimtar i spikatur rinie dhe si një kuadër i aftë, zot i detyrave që ka kryer, i thjeshtë, pa shtirje e mburrje, gjithmonë i qetë, i mgrohtë në komunikim, i sinqertë në atë që thotë dhe i prirur për të zgjidhur punë. Theksoj që PD-ja ka qenë e vonuar në përzgjedhjen e kandidimit të Basir Çupës, por më mirë vonë se kurrrë. Këtë radhë ajo mori vendimin e duhur, i ra pikes, siç i thonë fjalës. Me kandidatin Çupa për Kryetar të Bashkisë Klos PD-ja u paraqit e vlerësuar dhe dinjitoze sepse:

Basir Çupa rrjedh nga një familje me vlera bujarie e atdhetarie, një familje e thjeshtë nga dukja, por me shumë vlera njerëzore, zakonore, me tradita të mira, me emër të mirë dhe reputacion që jo vetëm ka ditur të nderojë e të menaxhojë veten, por u ka shërbyer dhe të tjerëve, komshinjëve, miqëve, komunitetit dhe njerëzve në nevojë.

Basiri është biri i Klosit, një nga djemtë e asaj zone me arsim të lartë, qysh student nga më të mirët e rrethit të Matit, aktivist i spikatur i punës me rininë në ato vite, një nga intelektualët e plejadës së parë të Matit, vëçanërisht në profesionin e tij.

Kandidati i PD, Basir Çupa ka një karrierë të pasur, që rrezaton si një brerore e qenësishme personaliteti. Është shquar në vazhdimësi për një moral të pastër si qelibari, me ndershmëri e përkushtim. Në të gjitha detyrat që ka kryer e ka shoqëruar thjeshtësia, vlerësimi dhe nderimi për kolegët e vartësit, korrektësia në zbatimin e rregullave e afateve, papajtueshmëria me padrejtësitë, zelli dhe dashuria për të bërë më të mirën e më të duhurën.

Basir Çupa është i vitëlindjes 22 nëntor 1966, i martuar, me fëmijë, me arsim të lartë, fakultetin ekonomik, ka qenë përgjegjës i NTSH Klos 1990-mars 1991, nga marsi i vitit 1991- gusht 1993 Drejtor NTSH Klos, nga gushti i vitit 1993- 2003 biznes privat, Dhjetor 2003 -2005 Nënkryetar i Bashkisë Klos. Janar 2006-Maj 2007 Drejtor i Rrugëve Nacionale Mat.

Maj 2007- Nëntor 2009 përgjegjës Sektori Mat i Drejtorisë Rajonale Rrugore Dibër, Nëntor 2009-Tetor 2013 Drejtor i Filialit të Postës Sh.a Mat. Siç shihet edhe nga kjo sivi e shkurtër e tij, Basiri në pjesën më të madhe të kohës ka punuar si drejtues, në ato ndërmarrje dhe institucione me shumë probleme, që jo vetëm kanë kërkuar aftësi drejtuese e organizuese, por kanë kërkuar edhe një kujdes të veçantë për menazhim duke përdorur sa më me efikasitet çdo qindarkë të hedhur nga shteti ynë.

E veçanta e Basirit ka qenë, se kudo që ka punuar ka veçuar për thjeshtësi, ka pritur e dëgjuar me shumë kujdes qindra individë, qofshin këta shtetas të thjeshtë apo kolegë e titullarë të ndryshëm, është përpjekur t'ju japë atyre gjithçka të tijën dhe të marrë prej tyre mendimet, sugjerimet, propozimet dhe përvojën e vyer.

Në mimikën e tij të çiltër vazhdimisht i ka ndrit buzëqeshja, nga një herë ka kafshuar dhe buzën për atë që nuk ka honepsur, për padrejtësitë që i janë bërë dikujtë, mandej është përpjekur të



Basir Çupa gjatë një takimi elektoral në Klos. (Foto arkiv: facebook.com/pages/Basir-Cupa-Per-Klosin)

ndikojë për mirë e të dhurojë mirësi dhe shpresë.

Pa mos folur për të tjerat, Basir Çupa nga viti 2007 e në vazhdim ka kryer detyrën e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Klos. Pra, ai është plotësisht i njohur me problematikat që shqetësojnë këtë komunitet, është dëshimtarë i të gjithë atyre arritjeve dhe mangësive që janë vënë re, por edhe më i informuari, më i prituri për të bërë ata gjëra që ka nevojë çdo pjesë e këtij komunmiteti. Ai është i azhornuar më së miri qoftë me studimet ashtu edhe me projektet që i nevoiten kësaj treve. Në se konkurrentja tjetër sapo e fillonte detyrën e kryebashkiakut, z. Basir i duhet vetëm për të hapur dosjet, për të freskuar ndonjë gjë dhe gjithçka është gati për t'ia paraqitur qeverisë.

Basir Çupa ka një vizion të qartë për atë që i duhet Bashkisë dhe komunmitetit të Klosit. Pa u mburrur, por me krenari për atë që është bërë thekson gjatë 3 mandatëve të PD-së në klos, janë kryer investime e shërbime në çdo fshat dhe në qytetin e Klosit. Ka pasur mjaft zhvillim e risi për komunitetin. Arritjet janë të prekshme në lidhjen e fshtrave me rrugë automobiolistike me qendrën e bashkinë, ujësjellësin, shkollat e reja e qendrat shëndetësore në çdo fshat, kanalet vaditëse etj. Ai është i ndërgjegjshëm se si kancer i madh është varfëria, papunësia për të punuar e pasur një jetë më të mirë.

Basiri i njeh me emër shumicën e komunitetit të Klosit, i dinë shumë mirë hallet e tyre, prandaj qytetarin dhe çdo pjesëtarë të komunitetit të Klosit do ta ketë në qendër të vëmendjes.

Vëmëndja e këtij kandidati do të fokusohet më mirë në menaxhmin e pasurive minerare dhe atyre natyrore. Bashkisë Klos i takon renta minerare, e cila do të kishte një ndikim të madh në forcimin e financave të kësaj bashkie, gjë për të cilën ai me stafin e tij nuk do të reshti së kërkuari. Janë 15 subjekte minerare që operojnë në territorin e Bashkisë Klos. Vendosja e një partneriteti të vërtetë dhe të shëndoshë midis shtetit dhe bashkisë Klos do të ndikojë më së miri qoftë në menaxhimin e mirëorganizinmin e punës në këto miniera, por edhe në rritjen e punësimit e të cilësisë së jetës të këtyrë banorëve. Ky partneritet i drejtë dhe real do ti japë mundësi edhe zhvillimit të industrisë së ndërtimit, prodhimit të gëlqeres, çimentos dhe mermerit.

Kujdesi i Bashkisë Klos do të jetë më i përqëndruar edhe në mbrojtjen e shfrytëzimin e pyjeve ku zonës së Klosit nuk i mungojnë. Kalimi i tyre në administrim të qeverisjes vendore, do të jetë zgjidhja më e mirë për mirëmenaxhimin e kësaj pasurie kombëtare dhe me vlera të mëdha për mjedisin, që sot është problem i gjithësishëm dhe bashkëkohor. Kjo trevë është e pasur në ujra, prandaj menaxhimi i tyre do të jetë në prioritetet e kësaj bashkie.

Prioritet i Bashkisë Klos do të jetë menaxhimi i tokës bujqësore, i resuseve në bujqësi, blegtori e vreshtari. Do t'ju jepen përparësi politikave për nxitjen e sipërmarrjes në bujqësi e blegtori duke stimuluar ngritjen e minifermave, kompleksëve blektorale, rritjen e sipërfaqes së mbjellë me vreshta e pemë frytore si dhe ngritjen e punishteve agropërpunuese të perimeve e frytave.

Traditat e mira prodhuese e përpunuese të prodhimeve bujqësore e blegtorale, artizane si dhe të prodhimit të pijeve alkolike sidomos të rakisë së verdhë e verës së Klosit do të ruhen dhe do të zhvillohen më tej. Këtyre do t'ju përgjigjen më mirë politikat zhvilluese, organizimi e menaxhimi serioz dhe me efektivitet i tregut. Tradita shekullore dhe e bukur e Pazarit të Urës do të zhvillohet e pasurohet më tej në saje të investimeve të bashkisë për ta shndërruar Tregun e Klosit në parametrat bashkëkohor, kjo bëhet akoma më e domosdoshme me funksionimin e Rrugës së Arbërit, e cila shkurton distancën dhe ndikon në frekuentimin më të madh të këtij tregu.

Prodhimet bio të trevës tërheqin vëmendjen dhe pëlqehen së shumti edhe nga banorët e kryeqytetit e të viseve të tjera, ja sepse kujdesi i zhvillimit të produkteve bujqësore e blektorale, industrisë përpunuese të tyre jo vetëm do t'ia rrisi emrin Bashkisë Klos, por do të fuqizojë punësimin, gjendjen e konomike të komunitetit, kjo e shoqëruar me një treg sa më atraktiv bashkohor.

Prioritet i veçantë mbetet investimi në infrastrukturë. Bashkia Klos i ngjan një disku diellor nga qendra e së cilës nisin rrugët lidhëse me njësitë përbërëse të saj. E rëndësishme është që të shkurtohen distancat nga qendra në njësitë përbërëse të saj, sidomos me atë të Gurit Bardhë e Xibrit. Dhe për këtë janë bërë studime, tani mjafton të rishikohen e korrektohen. Projekti i ri nga Pazari i Urës, ku dikur ishte ura e madhe me 8 harqe, kalimi në lagjen Ballosh të fshatit Fshat, me një kthesë që s'ka shumë pjerrësi mbi livadhet e Nezirit drejt Qafë –Shkallës do të shkurtojë shumë distancën e do ta përafrojë atë me të njësive të tjera të kësaj bashkie. Gjithashtu eleminimi i shumë kthesave nga Teqja e Gurit të Bardhë deri në vendin e quajtur Qafë-Ujk jo vetëm shkurton distancën, por e bënë këtë segment rrugorë shumë të shtruar. Gjithashtu investime kërkohen për rikonstruksionin e rrugëve Suç-Kurdari, Ura e Shulbatrrës-Gurrë dhe lidhjet me akset kryesore të gjithë fshatrave që përfshihen në këtë bashki.

Sipas vizionit të ri do të paraqitet plani urbanistik i Bashkisë ku një vend të rëndësishëm do të zë plani urbanistik i qytetit Klos me shtrirje në të dy anët e lumit Mat, Unaza, sistemimi i qendrës të këtij qyteti si dhe projekti i ri i Tregut.

Në memorien e kandidatit Basir Çupa kanë marrë formën e plotë edhe projektet për zhvillimin e arsimit në këtë njësi bashkiake. Problemeve që ka shkaktuar livizja demografike do t'ju përgjigjen me përqëndrim dhe rajonizim të sistemit arsimor. Kështu shkollë të arsimit të mesëm të ulët (klasa VI-IX) të ketë vetëm në Klos, Suç e Xibër. Në fshtra të ketë vetëm cikël fillor dhe edukim parashkollor në parametrat e duhura bashkëohorë. Arsimi i mesëm i lartë në Bashkinë Klos do të mund të grupohet lehtësisht në dy qendra, një në Klos dhe në Suç. Këta projekte do të mundësojnë dhënien e çdo lënde nga mësues të profilit përkatës, çdo klasë do të sigurojë ngarkesën e duhur të numrit të nxënësve. Në këtë mënyrë do të fuqizohet puna e shkollës duke rritur efikasitetin e rendimentin e orës së mësimit, do të ulen shumë shpenzimet si dhe do ti jepet fund dhënies së mësimit nga kuadro pa arsimin përkatës. Ky përqëndrim dhe rajonizim do të lehtësojë shumë edhe paisjen me laboratorët përkatës e gjithë bazën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Më mirë se deritani do të punohet për zhvillimin e kulturës dhe turizmi. Në strategjinë e zhvillimt të Bashkisë do të zë vend më të gjërë ngritja e institucioneve të Kulturës e Sportit si dhe e veprimtarive fizkulturoro-sportive e kulturoro-artistike. Do të ngrihet Qendra Kulturore për qytetin Klos si dhe Muzeo Etnografik.

Bashkia Klos ka një pozicion strategjik dhe shumë të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit, qoftë atij fushor për rreth 15 km që përshkon Lumi Mat, si dhe atij malor. Veçanërisht interes paraqet zona Ura e Vashës- Petralbë-Kalaja e Xibrit. Në njërin krah mbi këtë urë, në drejtim të Dibrës është Qafa e Dervenit, ndërsa në krahun tjetër drejt Tiranës është kalaja e Petralbës dhe më tutje e Xibrit. Kjo pjesë përveç bukurive mahnistëse natyrore paraqet edhe shumë interes nga ana historike për vizitorët jo vetëm matjanë, por edhe të vendeve të tjera brenda vendit dhe të huaj. Ngritja e një muzeu të Petralbës e Xibrit si dhe pavioni i veçantë me dingat e barotit do ta bëjë këtë zonë mjaft atraktive për turizmin.

Një zonë me shumë interes për turizmin malor do të jetë hapsira që shtrihet me brezin e malit të Allamanit e ndjekur me vargamlet e Balgjajit me pyjet e pishës, livadhet e blerta dhe me liqenet e mrekullueshëm. Në sintezë së shpejti do të ketë një projekt të veçantë për strategjinë e zhvillimit të turizmit në këtë njësi bashkiake që do t'i japi Klosit një emër të ri edhe si vend me vlera të shumta turistike që do të ndikojë në zhvillimin tërësor dhe ekonomik të kësaj treve.

Basir Çupa është një nga ata individë që e priti me shumë kënaqësi ndryshimin e sitemit dhe ardhjen e demokracisë. Ai e mbështeti që në fillim Partinë Demokratike, u anëtarësua në këtë forcë politike, punoi dhe kontriboi për forcimin dhe konsolidimin e saj. Në marsin e vitit 2001 u zgjodh kryetar i Seksionit të PD-së Klos nr. 2, në 2002 e në vazhdim anëtar i kryesisë i degës PD-së Mat dhe aktualisht nënkryetar i degës së PD-së Mat. Ka qenë vazhdimisht i devotshëm dhe i matur, pa ekstremitete për funksionimin e një demokracie të vërtetë ku rregulli dhe ligji të jenë sa më funksional. Qoftë si militant politik, si i zgjedhur në forumet drejtuese të PD-së ashtu edhe si njohës i mirë i problemeve të komunitetit Klos, i artit të drejtimit dhe përvojës së pasur menaxhuese, Basir Çupa plotësoi të gjitha kushtet dhe fitoi me meritë drejtimin e Bashkisë Klos. Urime dhe suksese!

SHTËPIA E LIBRIT FLETA XXI PESHKOPI BOOK HOUSE

LIBRI PRANË JUSH

LIBRARIA FLETA XXI,
PRANË MUZEUT, PESHKOPI

OFROJMË

redaktime - korrigjime
- ftesa - fletëpalosje
- fotokopje - kartvizita
- printime - lidhje libri duke
filluar nga 1 kopje e vetme!

Çmime të favorshme dhe
shpejtësi!
Telefono: 068 65 08 441

aktualitet

Një postim, një reagim dhe një sqarim për peticionin për rrugën e Arbrit



Kur e nisëm peticionin për Rrugën e Arbërit me 18 Mars 2013, kishim një synim: të ndikonim sa të mundnim te qeveria e pas-zgjedhjeve të 23 qershorit 2013, në mënyrë që ajo të merrte hapat final për realizimin e kësaj vepre, dhe fushata e 2013-ës të ishte fushata e fundit ku politikanët shqiptarë të mblidhnin vota me këtë çështje në Dibër.

Gjithashtu, ne kemi premtuar se peticioni do të vazhdojë deri kur të shtrohet metri i fundit i rrugës, dhe se çdo vendim zyrtar për këtë çështje do të jetë nën vëzhgimin tonë. Çdo vendim në këtë proces që ne na duket i padrejtë, do ta bëjmë publik, me qëllim që autoritetet vendimmarrëse të kenë mundësinë ta gjykojnë drejt çështjen dhe t'i japin zgjidhje në kohë.

Fushata jonë nuk është politike, nuk është as kundër dhe as pro ndonjë force politike. Ajo është krejt qytetare dhe ne besojmë se ajo është një mbështetje e madhe për qeverinë, në qoftë se ajo do ta bëjë Rrugën e Arbërit. Por, në qoftë se qeveria nuk merr hapa serioz në këtë proces, sigurisht që ne nuk do të ngurrojmë të bëjmë publike çështjet ku po çalon procesi.

Postimi ynë i fundit me titull "Në sajë të Edi Ramës, dibranët janë 464 metra më afër Tiranës" kishte pak ironi brenda, duke pasur parasysh faktin se kjo qeveri, kur ka qenë në opozitë, e ka denoncuar ndërtimin e këtij tuneli, si jashtë standardit. Ndaj, gati 2 vjet pas formimit të qeverisë, kur ne presim që punimet të fillojnë në segmentin që qeveria shqiptare ka deklaruar se po negocion me një koncensionar kinez, Kryeministri i Shqipërisë quan sukses një tunel që më parë e ka kritikuar. Ne mund ta lavdërojmë qeverinë që ka çelur fondet për këto segmente, por nuk mund të pranojmë se ky është një standard i arritur.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se postimi ynë mund të mos u ketë pëlqyer militantëve apo zyrtarëve pranë qeverisë, por deri më tani shumë pak komente kundër postimit tonë ironik kemi marrë nga rrjetet sociale. Një mesazh që kemi marrë nga projektuesi i rrugës Faruk Kaba në lidhje me këtë postim do ta lexoni më poshtë. Gjithashtu, po ju sjellim edhe një citim nga Kryeministri Rama gjatë fjalës së tij në Peshkopi në maj të këtij viti.

Ne nuk dëshirojmë të hyjmë në debat për këtë temë. Për arsyen e vetme se ne nuk na ka interesuar dhe nuk na intereson se kush e projekton dhe kush e ndërton Rrugën e Arbërit. Në të dy rastet janë paratë e taksapaguesve që e kryejnë financimin, dhe ne nuk kemi asnjë paragjykim se kush ka përfituar, kush po i merr apo do t'i marr fondet.

Ne kemi qenë shumë bashkëpunues që në fillim me çdo shoqatë apo organizatë në Tiranë dhe Dibër në lidhje me këtë çështje. Peticioni nuk ka synuar t'u marrë meritat atyre që kanë 20 vjet që kanë lobuar për këtë çështje, por synojmë ta çojmë përpara këtë proces lobimi. Sidoqoftë, ne dëshirojmë që ju të gjykoni vetë mbi veprimtarinë tonë si shoqëri civile, punën që kanë bërë zyrtarët apo ata që kanë projektuar e ndërtuar rrugën. Gjithashtu, duhet të theksojmë se postimet tona për rrugën i marrin vetëm ata që kanë nënshkruar peticionin, pra që në një situatë të caktuar e kanë përkrahur iniciativën tonë.

Ne kemi marrë mesazhe nga militantë dhe zyrtarë pranë qeverisë, ku na kërkohet të kemi më shumë besim te qeveria e Edi Ramës, pasi ai e ka premtuar Rrugën e Arbërit, me cilësi dhe me standarde. Ne dëshirojmë shumë që kjo të jetë e vërtetë, por detyra jonë si shoqëri civile nuk është të besojmë te premtimet, por të shohim faktet. Dhe ditën që faktet do të tregojnë se si po punohet në rrugë, do t'i gjejmë edhe fjalët e mira për qeverinë.

Me këtë rast, ritheksojmë edhe njëherë se angazhimi ynë në këtë proces është krejt qytetar dhe nuk ka asnjë prapavijë politike apo synim politik.

Gjithashtu, ne kemi gjithë informacionin se çfarë ka ndodhur me këtë rrugë për gati 20 vjet. Dhe faktet që kemi do t'i bëjmë publike një ditë. Por sot nuk është koha. Sot është koha të tregojmë se Dibra, Shqipëria dhe shqiptarët në Ballkan kanë nevojë për Rrugën e Arbërit. Ne duam që procesi të ecë përpara, por në qoftë se kjo nuk ndodh, përgjegjësi kanë ata që paguhen për ta bërë realitet këtë projekt. Dhe për këtë nuk do të ngurrojmë asnjëherë të shkruajmë dhe të publikojmë të vërtetën.

Gëzim Alpion

REAGIME

Rruga e Arbrit nga fantazëm elektorale në realitet

Dje në Tunelin e mbaruar të Qafë Buallit, pjesë e domosdoshme për rrugën e Arbrit dhe vepër domethënëse e cila u financua dhe u realizua në kohë rekord këto 18 muaj, duke dëshmuar se ne themi atë që bëjmë dhe bëjmë atë që themi. Por edhe duke treguar sa shumë më tepër do të ishte bërë në këtë kohë, nëse nuk do ta kishte dalë përpara një mal me borxhe dhe nëse nuk do të kishim shlyer deri tani, 550 milionë dollarë borxhe të prapambetura të qeverisë tjetër. Sot rruga e Arbrit nuk është më një fantazmë elektorale që shfaqet vetëm nëpër fushata, por është një realitet mbi të cilin ne po punojmë fort dhe kemi siguruar tashmë edhe financimin për pjesën më të vështirë të këtij aksi strategjik për vendin, me një nga kompanitë më të mëdha të Kinës.

Edi Rama, 8 qershor 2015

Për Rrugën e Arbrit ata kishin lënë një projekt paçavure

Ku e kanë rrugën e Arbrit? U desh 23 qershori që ne t'i japim drejtim rrugës së Arbrit. Pas votimit në parlament janë duke u zhvilluar negociatat përfundimtare me kompaninë, sipas ligjit, do firmoset kontrata dhe këtu do të shikoni që do të hapet përfundimisht kantieri i madh i Rrugës së Arbrit, brenda pak muajve.

Ku e kanë ata [PD-ja], rrugën e Arbrit? Me një projekt paçavure që kishin lënë atje, që nuk ishte as projekt dhe që u desh ta rishikonim nga e para dhe me ato inaugurimet pa lidhje, prit shirit këtu e prit shirit atje. Turp i madh! Një rrugë kombëtare, me një rëndësi kaq të madhe jo vetëm për gjithë këtë zonë këtu, por shumë më tepër se kaq dhe ju e dini mirë, pse është më e rëndësishme se sa thjesht lidhja midis kësaj zone dhe Tiranës. Rruga e Arbrit është themelore për të lidhur shqiptarët të gjithë bashkë, në gjithë këtë pjesë të kufirit lindor të Shqipërisë. E pra, si është e mundur që një projekt i tillë të trajtohet vetëm për fushata dhe sikur të ishte një rrugë fshat?

Edi Rames në Peshkopi, 18 maj 2015

Në sajë të Edi Ramës, dibranët janë 464 metra më afër Tiranës

Dy vjet që kur erdhi në pushtet, Qeveria Rama ka përfunduar vetëm 464 metra të Rrugës së Arbërit. Është fjala për tunelin në Qafën e Buallit që Rama e trumbetoi në zgjedhjet lokale sikur të ishte mrekullia e tetë e botës.

Me këtë rast i kujtojmë Edi Ramës se, deri tani, asnjë segment i Rrugës së Arbërit që konsiderohet i "pëfunduar", përfshirë edhe tunelin e tij të "famshëm", nuk përmbush standardet ndërkombëtare. Ndoshta Rama do të gjej një shkop magjik që ta përfundoj këtë vepër pas dy vjetësh, siç premtoi në vitin 2013. Kjo është puna e tij. Ndërkohë, peticioni do t'i qëndroj kësaj qeverie në kokë si shpata e Demokleut deri në ditën e fundit të mandatit të saj.

Dr. Gëzim Alpion / change.org

Duhet të thoni të vërtetat e 8 viteve, kur pushteti i PD-së gënjeu sistematikisht dibranët

Pershendetje Z. Gezim Alpion,

Do t'ju lutesha shume te mos me dergoni me e-mail me permbajtje te tilla lidhur me Rrugen e Arberit per disa arsye:

Se pari, sepse emili juaj duket me shume nje sulm ndaj kryeministrit (i cili ne mendimin tim me ne fund i ka dhene nje zgjidhje konkrete edhe financimit te Rruges se Arberit) se sa nje peticion per ta nxitur ate te realizoje kete veper. Ju, me sa kam informacionin, nuk jetoni ne Shqiperi dhe sigurisht nuk i dini gjerat. Nuk kuptoj edhe motivin tuaj per te sulmuar kryeministrin pasi nuk me duket se keni ndonje argument. Mos eshte qellimi juaj te beheni "faktor"? ...apo thjeshte kerkoni te dukeni interesant? Rruga e Arberit ka marre nje drejtim, i cili eshte pikerisht ai i duhuri. Kete jua them me kompetence, pasi une e njoh shume mire kete veper, shume here me mire se kushdo tjeter, qe desheron te behet "i rendesishem" "pas pilafit", me kete element shume sensibel per dibranet. Por, miku im, jeni ne rruge te gabuar. Jua them une, qe kam dhene qe ne vitin 1988 idene e kesaj rruge, qe kam bere studimin fillestar, qe kam realizuar studimin e plote te fizibilitetit dhe qe kam bere edhe projektzbatimin e shumices se rruge. Jam pra autori i saj dhe jam krenar per kete, por nuk e kam per natyre qe te mburrem, apo te pretendoj, sic beni ju, qe me sa duket do te donit t'ju quanin "i madhi" apo "promotori i rruges se Arberit" etj. etj. Me kete qe beni ju, vecse na turperoni ne dibraneve! Nese deshironi te beni sulme politike dhe pretendoni te jeni "shpata e Demokleut" atehere duhet t'ia nisni te thoni te vertetat e ketyre 8 viteve te fundit, kur pushteti i PD-se genjeu sistematikisht dibranet, e jo te akuzoni Qeverisjen aktuale, qe fundja ne nje kohe te shkurter e megjithe financat e shkaterruara, po shkon drejt realizimit te kesaj vepre shume te veshtire infrastrukture.

Se dyti, si me i moshuar dhe me me shume eksperience, ju sugjeroj qe me mire te merreni me pune te cilave mund t'i dilni per zot, se jo vetem une, por te gjithe dibranet dine t'ia peshojne lekuren kujtdo aq mire sa ju nuk e merrni dot me mend. Nese deshironi te beni emer me genjeshtra apo me shtremberime, mund ta beni me ndonje anglez naiv; ndryshoni dhe emrin, pasi mbiemrin e keni ndryshuar, duke e bere te tingelloje "interesant", por keto nuk ju pijne uje ketu.

Se treti, nese deshironi te beni presion mbi qeverine per ndertimin e kesaj vepre dhe nuk keni asnje qellim politik/personal, duhet ta nisni me venien ne dukje te gjithe "prapesive" te lakejve te qeverise qe shkoi. Keshtu do te mund t'i kerkoni qeverise aktuale qe te mos perserise gabimet. Per dijenine tuaj, pushtetaret e 8 viteve te PD-se, me metodat e tyre korruptive galopante, jo vetem nuk e ndertuan, por e trasformuan ne menyren me negative te mundeshme tunelin qe ju permendni (fillimisht tentaun ta eleminonin, ne kundershtim me llogjiken inxhinerike), e sterzgjaten ne terma kohore, duke bere fakt te kryer pikerisht nje variant qe eshte e kunderta e asaj qe duhej te ishte. Dhe ky nuk eshte i vetmi veprim skandaloz ne dem te kesaj rruge i qeverisjes se meparshme. Por ju nuk i dini dhe nuk ka si t'i dini keto pune. Aq me teper qe halli juaj mesa duket eshte tjeter kund.

Mirupafshim,
Dr. Eng. Faruk KABA
President Albanian Association of Consulting Engineers
Tiranë, 26 qershor 2015

Përgjigja jonë për z. Faruk Kaba:

Pershendetje z. Faruk Kaba, Faleminderit per mesazhin.

Une nuk ju kam derguar ndonje email ju personalisht. Mesazhit te cilit i referoheni ju e kane marre te gjithe nenshkruesit online.

Po qe se nuk deshironi te merrni perditesime ne lidhje me kete peticion, ju mund te zgjidhni opsionin per tu crregjistruar. Po qe se nuk dini si ta beni kete gje, ju lutem na njoftoni qe tju instruktojme pa vonese. Emaili juaj eshte i pari mesazh i kesaj natyre qe ne marrim si grup lobues qe nga fillimi i peticionit online me 18 Mars 2013. Per hir te transparences, mendojme se eshte ne interes te Rruges se Arberit qe shqetesimin tuaj ta bejme publik.

Me respekt, Gëzim Alpion
Birmingham, 26 Qershor 2015

Rruga e Arbërit nr. 110

intervistë



Me kënaqësi do të punoja për të unifikuar mendimet si dhe shoqatat e vogla të mblidheshin në një shoqatë të madhe. Ashtu siç e thashë edhe në fillim, bashkimi do të na bëjë më të gëzueshëm, më të besueshëm dhe më të fortë.

Bisedë me Prof. **Bujar Kapexhiu** - Mjeshtër i madh, për Dibrën dhe karikaturën

Me kënaqësi do vizatoja dibranët, sepse e ndjej se e kuptojnë humorin tim

Nuk duhet të ekzistojnë dasi politike mes dibranë, pasi shoqata e përjashton politikën. Ne duhet të bashkohemi mbi të tjera kritere, të tjera pika, të tjera shtylla. E para fare është vendlindja që na bashkon të gjithëve, që jemi dibranë. E dyta është historia, që është njësoj e të gjithëve. Periudha që kemi kaluar, dëshira, pasionet, kultura, folklori, etnografia etj. Të gjitha këto na bashkojnë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Bujar Kapexhiun e gjen në studion e tij pranë stacionit të trenit, gjithmonë duke punuar karikaturat me humor dhe me thumba. Më 17 qershor ai prezantoi tre librat e tij me karikatura, të cilat disa prej tyre mund ti keni parë çdo ditë në faqen e parë të gazetës Mapo.

Ditët e fundit ai ka marrë edhe një detyrë të re, atë të kryetarit të shoqatës Bashkësia Dibrane. Në fakt, ishte një zgjedhje unanime e kryesisë së kësaj shoqate, pasi Bujar Kapexhiu, me penën e tij, karikaturën dhe humorin, më shumë bashkon se sa thumbon.

Mjeshtri i madh, prof. Bujar Kapexhiu, është një ndër ata dibranët e shumtë të Tiranës, të cilët herë prezantohen si tiranas e herë si dibranë. Por Kapexhiu nuk e fsheh faktin që është dibran, megjithëse i lindur në Tiranë në më 22 mars 1944. Babai i tij ka migruar nga Dibra e Madhe në vitin e mbrapsht të 1913-ës, fare i vogël. "Babai u rrit në mjedis tiranas dhe fliste më shumë dialektin tiranas se atë dibran. Por mua më pëlqente kur ai fliste dibrançe dhe i thoja vazhdimisht: "Babi të lutem fol njëherë dibrançe", dhe ai fillonte të fliste dibrançe dhe për mua ishte kënaqësia më të madhe të dëgjoja dibrançe nga goja e babait tim".

Por një lidhje tjetër e Kapexhiut me Dibrën është edhe një partizan. "Kur babain tim po i bënin gjyqin komunistët, tregon Bujari, në sallën e gjyqit u ngrit partizanit Reshat Hajdaraga dhe e shpëtoi nga pushkatimi".

Vite me parë, në një tubim për Rrugën e Arbrit, ai tha se "në 60 vite kishte qenë vetëm një herë në Dibër, por kur të bëhet Rruga e Arbrit, do të shkoj 60 herë brenda një viti".

Për Dibrën, shoqatat, librat, karikaturën dhe politikën, biseduam një ditë në zyrën e tij.

- Profesor, si është të jesh kryetar i Bashkësisë Dibrane?

B.Kapexhiu: Padyshim që është një kënaqësi, sepse vendosesh në një pozicion ku ke përzgjedhjen e të gjithëve, të paktën e atyre njerëzve që kanë qenë në atë tubim. Ke dëshirën e tyre për të qenë në krye të shoqatës, por njëkohësisht vijnë edhe detyrime të tjera më pas. Të jesh në drejtim të një shoqate, përveç kënaqësisë, ke edhe detyrimin që duhet të kryesh shumë detyra, të cilat ndoshta edhe në heshtje këta njerëz ti vendosin. Pra, ti duhet të realizosh shumë gjera që të përligjësh simpatinë e tyre, dëshirën dhe kërkesën e tyre. Kështu, unë mendoj, që përveç kënaqësisë dhe falënderimit që kam për këta njerëz që më besuan këtë vend, unë mendoj se kam edhe shumë detyra për të kryer që të justifikoj besimin e tyre.

Kjo shoqatë është një tubim me dëshirën dhe vullnetin e mirë të njerëzve, të cilët kanë një prejardhje nga një vend i caktuar, që i lidh tradita, folklori, ekonomia, zakonet. Shumica e tyre banojnë në Tiranë dhe natyrisht që kanë nostalgji për atë vend dhe të mbledhur të gjithë së bashku, duke mos e harruar atë Dibrën, kujtojnë historinë, traditat, këngët, vallet, jetën e tyre, zakonet, njerëzit të cilët ndoshta nuk jetojnë më, por që kanë bërë një histori dhe me punën e tyre kanë lënë vepra që kujtohen. Dhe kjo na bashkon të gjithëve së bashku, që edhe këtu ku jemi, në Tiranë, të jemi sërish bashkë, për të biseduar me njëri -tjetrin, për të ndihmuar njëri-tjetrin, për të kujtuar me njëri-tjetrin vendin dhe kohën e kaluar.

Natyrisht, gjithmonë, njerëzit kur janë bashkë janë më mirë, janë më të kënaqur, janë më të fortë, janë më të qetë. Kam përshtypjen se punojnë dhe jetojnë më mirë kur janë të gjithë së bashku. Kjo na ka mbledhur rreth kësaj shoqate, me të cilët kam dëshirën që të shtojmë akoma më tepër njerëz, që ta bëjmë sa më masive.

Në fillim duhet që të punojmë që të shtojmë radhët. Duhet të pranojmë që ka njerëz, të cilët që ndoshta edhe nuk e dinë ekzistencën e kësaj shoqate, e rëndësishme është t'i informojmë dhe me dëshirën e tyre të lirë të bashkohen në aktivitetet tona të ndryshme që mund të bëjmë. Qofshin këto veprimtari politike, shoqërore, ekonomike, artistike. Të gjithë këto do të bëjnë që me tema të ndryshme, kryesisht për Dibrën, njerëzit të afrohen dhe të mos e ndjejnë asnjëherë veten të braktisur, apo të largohen nga ai vend ku kanë lindur. Kjo do të na bëjë që të jemi gjithmonë bashkë. Dhe duke qenë se do të jemi bashkë do të jemi më të qetë, më të gëzuar, më festiv, edhe pa dyshim, edhe më të fortë.

- Një nga problemet e dibranëve nuk e ndjejnë veten mirë të bashkuar rreth një shoqatë. Pasi kanë krijuar shumë shoqata dhe pavarësisht fjalëve të mirë të tyre se do bashkëpunojnë me shoqatat e tjera, do të bëjnë veprimtari të përbashkëta, nuk e kanë gjetur dot rrugën e bashkëpunimit. Çfarë mendoni ju për këtë?

B.Kapexhiu: Të them të drejtën, edhe unë, që në fillimet që jam aktivizuar në këtë shoqatë në disa mbledhje, në disa aktivitete e kam shprehur këtë gjë me keqardhje, jo vetëm për ekzistencën e dy apo më shumë shoqatave dibrane në Tiranë, por edhe në rrethe të tjera përreth Tiranës. Përse duhet të kemi dy apo më shumë shoqata? Unë mendoj që ne duhet të bashkohemi në një, dhe këtë e kam ngritur herë pas here. Madje, duke bërë edhe shaka, kam thënë se ajo është shoqata e intelektualëve, ndërsa ne na takon që të jemi shoqata e injorantëve. As unë nuk e di se pse ndodhin këto gjëra, ndoshta ka qenë një dasi pak politike, d.m.th, duke e ngjyrosur pak shoqatën me ngjyrë politike, ka sjellë që të djathtët të grupohen veç dhe të majtët në një grupim tjetër. Nuk duhet të ekzistojë kjo dasi politike, pasi shoqata e përjashton politikën. Ne të mblidhemi, mbi të tjera kritere, të tjera pika, të tjera shtylla.

E para fare, është vendlindja që na bashkon të gjithëve, që jemi dibranë. E dyta është historia, që është njësoj e të gjithëve. Periudha që kemi kaluar, dëshira, pasionet, kultura, folklori, etnografia etj. Të gjitha këto na bashkojnë.

Nuk e di pse jemi kaq të ndarë, ndoshta kjo ka qenë edhe një tendencë e atyre kryetarëve që kanë qenë në fillimet e tyre. Duke qenë të ndarë, ata e kanë pranuar si pronë të tyre shoqatën dhe nuk kanë pranuar të bashkohen me shoqatën tjetër, duke menduar se mund ta humbasin këtë pronë. Në qoftë se dy kryetarët, dy kryesitë, do të bashkohen, të bisedojnë me njëri-tjetrin, mund të bëjnë një mbledhje të madhe dhe të vendosin se kush do ta udhëheqë shoqatën. Dhe kur të gjithë zgjedhin një grup ta caktuar dhe një njeri, ne do ta pranojmë të gjithë si një udhëheqje për këtë shoqatë.

- Hiqmet Gonxhe, një nga kryetarët e parë të shoqatës suaj, ka bërë një projekt për bashkimin e shoqatave dibrane. A e njihni projektin e tij?

B.Kapexhiu: Herë pas here kemi biseduar me Hiqmetin, dhe meqë ai është nga të parët kryetarë të bashkësisë dibrane, e ka bërë këtë projekt. Nuk e njoh projektin me detaje, por me kënaqësi do ta shikoja dhe me kënaqësi do të punoja për të unifikuar mendimet si dhe shoqatat e vogla të mblidheshin në një shoqatë të madhe. Ashtu siç e thashë edhe në fillim, bashkimi do të na bëjë më të gëzueshëm, më të besueshëm dhe më të fortë.

- Kohët e fundit vihet re përdorimi i shpeshtë i termave *Dibra e Madhe* ***- dhe në këtë rast i referohen qytetit të Dibrës me rrethinat e saj, dhe*** *Dibra e Vogël* ***- duke kuptuar me këtë pjesën brenda kufirit Shqiptar të Dibrës. Unë nuk jam dakord me përdorimin në këtë konotacion të*** *Dibër e*

Bujar Kapexhiu, kronikani me laps i politikës

Kur politika ka nxehur sheshet dhe studiot televizive karikaturistë preh lapsin për të bërë humor me të. Bujar Kapexhiu, një artistist unik, që i ka përjetësuar 25 vite tranzicion në karikaturat e tij, prezantoi në mes të fushatës elektorale tre librat e tij me karikatura "Për një karrige", "Ngërç" dhe "Kthesë".

"Kthesë" është libri më i fundit që botohet nga UET-Press, por të tre librat e tij nuk mund të kuptohen pa njëjra-tjetrën, janë një rrugëtim i përbashkët në rubrikën e tij të përditshme në gazetën Mapo. Kapexhiu është kthyer tashmë një 'kronikan' i politikës së ditës nëpërmjet metaforës, humorit e satirës që përcjellin karikaturat e tij me personazhe të politikës.

Promovimi u zhvillua në mjediset e Muzeut Kombëtar, ku nuk mungonin as politikanët që ai aq fort ka dëshirë ti satirizojë.

Kapexhiu nuk mund të kuptohet pa humor ndaj dhe prezantimin e librave të tij e nisi me humor duke thumbuar Drejtorin e gazetës Mapo, gazetarin Artur Zheji, "jemi këtu që të bëjmë një bashkëbisedim dhe nuk ka presidiume, sepse Drejtori tha boll me presidiume, i kemi pas tërë jetën dhe ne e dëgjojmë fjalën drejtorit se nuk bën ta kesh keq me drejtorin". Po me aq humor dhe Zheji u përgjigj se "Bujari kishte nevojë për një figurant dhe më ftoi që të luaja rolin e drejtorit, sepse Bujari nuk ka drejtor, atë e drejton muza dhe idetë e veta".

"Drejtorët herët a vonë i merr lumi ndërsa artistët mbeten mbi urë. Që ta luaj rolin deri në fund jam shumë i lumtur për faktin që kam qenë që në filimet e bashkëpunimit të Kapexhiut me grupin Mapo dhe që në fillim kam qenë një nga vlerësuesit që karikatura të jetë pjesë e medias së përditshme. Kapexhiu nga metafora e karikaturës së shtypit të shkruar ka shkuar tek karikatura që jep metaforën ilustrative dhe në mediat elektronike, sigurisht dhe në mediat online që më pas e vjedhin gjithandej, por të vjedhësh karikaturat e Kapexhiut nuk është krim që e parashikon Kodi Penal, madje mund ta stimulojë atë", tha ndër të tjera Zheji.

Kapexhiu është nga ata artistë që thumbon edhe pa karikaturë, pasi edhe ky promovim librash ishte për të i qëllimshëm për të tërhequr vëmendjen nga politika.

"Është rasti më i bukur kur të gjithë janë të turrur drejt politikës, edhe meqë karikatura ime është politike, atëherë mendova që të tregoj të

> Kritikët e veprës së tij në fakt nuk patën asnjë kritikë për të duke e cilësuar punën e tij spontane, origjinale, të pasforcuar dhe goditëse të realitetit. Karikatura e tij shihet si një ballafaqim i drejtpërdrejtë me politikën, duke e vënë në lojë atë, duke bërë humor e satirë me të.

gjithë krijimtarinë time me krijimtarinë e politikanëve shqiptarë. Në përgjithësi politikanët shqiptarë tashmë mund t'i quajmë të emancipuar dhe ata e ndiejnë se janë figura të cilët e meritojnë karikaturën dhe e meritojnë veprën e artit, kështu që nuk inatosen dhe nuk kanë hatërmbetje, por është e kundërta ka hatërmbetje kur ndonjëri nuk ka karikatura. Unë kam ftuar nga kryeministri, Presidenti, ish kryeministrat.

Kritikët e veprës së tij në fakt nuk patën asnjë kritikë për të duke e cilësuar punën e tij spontane, origjinale, të pasforcuar dhe goditëse të realitetit. Karikatura e tij shihet si një ballafaqim i drejtpërdrejtë me politikën, duke e vënë në lojë atë, duke bërë humor e satirë me të. Ndërsa për Kapexhiun politika është një ushqim i mjaftueshëm për humor e satirë ndërsa karikatura në këtë rast shërben si një kritikë ndaj saj.

VEPRAT NË LAPS

"Për një karrige" është një vepër që përmban 350 karrikatura të Kapexhiut, botim i UET Press. Ai thotë se të gjithë mund të argëtohen në shoqërinë thumbuese të artit humoristik të karrikaturës. "Ngërç" përmban gjithashtu 350 karikatuara të botuara në gazetën "Mapo" ku karikatura e tij është kthyer në një lloj "editoriali" vizual përmes të cilit shihet me anë të satirës jeta politike e vendit.

"Kthesë" vjen në të njëjtin format me dy veprat e tjera duke sjellë kështu në një format të përmbledhur të gjitha karikaturat e tij të preferuara për publikun. Gjithkush që është i apasionuar pas rubrikës së Bujar Kapexhiut, Mjeshtrit të Madh, mund ti ketë ato në bibliotekën e tij si një mundësi e përhershme për të vënë buzën në gaz e për të kuptuar se ndoshta politikën e marrim më shumë seriozisht se sa duhet.

(Marrë me shkurtime nga mapo.al)

veprimtari

Me karikaturën time, me sens - dhe me sensin pozitiv, për të korrigjuar, për të shpotitur, për të bërë humor, në e kam për të gjithë. Madje me kënaqësi të madhe do vizatoja dibranët, që të qeshim me ta, sepse e ndjej se e kuptojnë humorin tim më mirë se sa të tjerët.

Karikatura e Bujar Kapexhiut, një kronikë e vërtetë alla-shqiptare

Nga **BEN ANDONI**

Në prag të anëtarësimit në strukturat e BE-së, Vendeve Balltike iu kërkua të sillnin diçka specifike prej vendeve të tyre. Në dilemën e madhe që shoqëron vendet e vogla për mungesën e gjërave të mëdha apo shpikjes së sforcuar të miteve, Balltikasit arritën dhe e gjetën zgjidhjen. 'Të dorëzuar' para këtij fati të paracaktuar, ata vendosën të japin historinë e tyre përmes karikaturës. Impakti ishte i jashtëzakonshëm. Jo thjesht prej gjinisë së artit të përfaqësuar, por mënyrës konceptuale të shprehjes së historisë së tyre. Ata qesëndisnin veten e tyre, por megjithëkëtë edhe fatin që kish përcjellë historinë e vendit përmes artit të karikaturës.

Jo gati njësoj, por në një linjë, qindra-mijëra kilometra larg, një punëtor i palodhur i vijës, e ka bërë ndryshe udhëzën e tij në xhunglën social-kulturore shqiptare. Për çdo ditë, shqisat e artistit Bujar Kapexhiu mundohen të kapin trendin e lajmeve ditore dhe ai përmes figurave artistike, që afrohen me tipologjinë e karikaturës, na i sjell të freskëta me abstragime tejet të kuptueshme. Metaforat e kompozicionit që ndërton janë të këndshme por mbi të gjitha komunikuese me të gjithë. Bujar Kapexhiu, që në jetë, veç piktorit ka bërë dhe bën pedagogun, aktorin, edhe që mbart gati një duzinë të tërë atributesh, prej vitesh tenton të jetë kronikani shqiptar me anë të lapsit. Dhe e ka arritur, pasi sot nuk ke nevojë të lexosh grafomanë dhe patetikë pa fund, kur përballë ke karikaturën e tij ditore.

Ndaj, jo më kot, një mori e tërë njerëzish, që për çdo ditë presin lajmin më të freskët të jetës shqiptare, e presin me padurim dhe atë: Këndin e Bujarit. Është ditari i tij, një copëz kronikë, që e themi pa asnjë lloj brerje ndërgjegje se mund të ndihë edhe studiuesin më të shkujdesur vite më vonë, për të hedhur ide mbi vijimësinë e jetës shqiptare.


Bujari nuk është se ka qenë ndonjë trim "i rrallë", si disa kolegë të tij karikaturistë, që anatemojnë pa emër, por në vazhdën e punës shumëvjeçare, madje edhe duke e treguar hapur miqësinë me politikanë, artistë, njerëz të ndryshëm, shpon me heshtën e vet prej karboni, që nuk të dhëmb, por që të bën të mendosh gjatë.

Nëse një kritik arti, nga këta që tek ne të ngrenë në qiell apo të anatemojnë deri në zgrip të nëmjes, do të merrej kryesisht me të, përnjëherë do të thoshte se tipologjia e personazheve të tij është uniforme. Është e vërtetë. Personazhet e karikaturës së tij janë kaq uniforme, saqë i ngjajnë ushtrisë së terakotave kineze, do ta qesëndiste me cinizëm dikush tjetër. Por, mu në dinamikën e këtyre personazheve, që ai i abstragon në mënyrë shumë të thjeshtë, pa hiperbolizuar veçantitë, shpaloset mendimi dhe qëndrimi i tij. Rama është i gjatë dhe mbetet i gjatë dhe në punët e tij. Berisha me hundën tipike dhe modelin e flokëve klasik është po ai, bashkë me shaminë, që nuk e heq nga thileja e xhaketës. Lulëzim Basha i hekurosur dhe patetik është i njëjtë. Braçe lufton në shkurtësinë e tij. Nishani buzëqesh si Xhokonda dhe nuk thotë asgjë. Etj, etj. Por, mënyra sesi këta personazhe lëvizin dhe përpiqen të bashkëndërveprojnë, aty do të shikosh mendimin që përcjell artisti Bujar. A do mundte ta tejkalonte cakun? Ka të ngjarë që jo. Tipi i karikaturës së tij, i afrohet më shumë ilustrimit klasik të shkollës klasike të medias latine. Personazhi është ai që është. Veçimi i matur i një ceni përbën atë që Bujari e dallon pakëz me të tjerët. Sfida është në grimasat, që jep lapsi i tij, për veprimin apo një akt të personazhit, që ai pasqyron dhe që për hir të së vërtetës, i kanë shkaktuar aq andralla këtij vendi. Kaq, mjafton.

Shumëkush do të donte që Bujari të bënte anatemën, që bën dikur kolegët e tij danezë, por kjo nuk i shkon artistit të tipit Kapexhi. Nuk i shkon prej temperamentit, por më shumë stilizimit, që ai ruan në kokë për këdo. Ai na rrëfen. Kjo është detyra e tij morale, para vetes. Ai nuk mban qëndrim. E tek e fundit, shqiptarët, janë aq teatralë, sa e kanë të vështirë të bëjnë teatër, thoshte dikur Lamberci. Që Kapexhiu na përkthen aktet përmes karikaturës më shumë sesa hiperbolizon cenet fizike të personazheve të tij, kjo është fare e kuptueshme. Mjafton. Historia shqiptare ka treguar se realiteti është shpesh më i hardallosur se gjërat që mendojmë prej impaktit të punës së personazheve të ndryshëm.

Pikërisht, këtë medium e ruan me shumë finesë Bujari. Pasi, arti i karikaturës, që lehtësisht mund të përcaktohet si një satirë vizuale apo si një zhvillim modern bashkëkohor me lirinë e shprehjes, sipas specialistëve- që shijohet sot në shoqëritë liberale, për të është i bukur në të gjithë këtë drejtim. Duke na dhënë një kronikë të vërtetë alla-shqiptare. Dhe, mjafton të shfletosh ditë pas dite këtë dinamikë pune të tijën dhe do kuptosh paradoksin e jetës politiko-ekonomike-shoqërore të zhvillimit shqiptar.

A do mundej, që kontributi i tij, të shtrihet në universalizimin e gjinisë së vet? Për këtë s'ka ndonjë mendim të veçantë. Më mirë të bëjë kronikanin duke dhënë edhe mendimin e tij përmes vijës, sesa duke u fshehur si shumë syresh që e kanë harruar sot rolin e keq të kapitalizmit apo superfuqitë, që bëjnë karikatura pa karikaturë. Kjo po. Mjafton, që ditarit të jetës shqiptare të mos i mungojë subjekti i tij. Kjo është çështja? Dhe, nuk është e vogël për artistin e angazhuar kaq shumë në jetën shqiptare, që të gjithë e njohim prej punës tek *Këndi i Bujarit*.



Marrë nga parathënia e librit "Kthesë". Titulli është i redaksisë. Titulli në origjinal "Kronikani me laps".

Madhe ***dhe*** *Dibër e Vogël****, pasi jo vetëm që nuk ka bazë toponomistike, por shpreh edhe nuanca nënvlerësuese ndaj një pjesë të komunitetit në Dibër. Mos vallë edhe kjo ka çuar në krijimin e shumë shoqatave me bazë më të vogël gjeografike në Dibër dhe jashtë saj?***

B.Kapexhiu: Edhe kjo mundët të kenë ndikuar, por unë po them që në shoqatën tonë nuk e kemi vënë re diferencën në përdorimin e termave "Dibra e Madhe", "Dibra e Vogël". Është krijuar kjo Bashkësia Dibrane si vazhduese e shoqatës së parë dibrane të krijuar në vitet '20. Sot në shoqatën tonë ka anëtarë që janë këtu në Tiranë, por që kanë lindur dhe kanë jetuar një pjesë të madhe të jetës tyre në Peshkopi. Kështu që, ne edhe Peshkopinë nuk po e përmendim më, por themi Dibër. Dhe përderisa themi Dibër, të gjithë jemi dibranë. Pra, ka vetëm një emër dhe ajo është Dibra.

- Më datë 17 qershor ju prezantuan tre vëllimet tuaja me karikatura, "Ngërç", "Për një karrige" dhe "Kthesë". Në këtë prezantim, duke ju referuar emrit Dibër, ju thatë se ajo rimon bukur me fjalën libër, por edhe fibër? Çfarë do të thotë kjo për Bujar Kapexhiun?

B.Kapexhiu: Po, fjala "Dibër" jo vetëm që rimon me fjalën "Libër", por edhe me fjalën "Fibër", në kuptimin elastik. Por rimon bukur edhe me fjalën "qibër", njeri fisnik dhe me sens, por edhe me fjalën "sibër"... Dibranët janë një vlerë, në përgjithësi, dhe kjo njihet nga të gjithë.

- Gjatë prezantimit të librave tuaj me karikatura, ju thatë se "nuk ua bën dora të karikaturosh dibranët". Në fakt, dibranët njihen për të folurën alegorik. Pra, me fjalë ata e bëjnë karikaturën e tyre. Pse juve nuk ua bën dora t'i karikaturoni dibranët?

B.Kapexhiu: Alegoria dibrane, humori dibran është i fshehtë, nuk është i menjëhershëm. Duhet të mendohesh mirë, dhe kur mendohesh mirë për ta gjetur, dhe kur e gjen, ke një kënaqësi akoma më të madhe sesa kur e kupton direkt, menjëherë. Kjo nuk është gjë tjetër, veçse mençuri. Dhe thuhet se "Humori është privilegj i të mençurve", dhe dibranët kanë një humor të veçantë që nuk i ngjan asnjë vendi tjetër.

Me karikaturën time, me sens - dhe me sensin pozitiv, për të korrigjuar, për të shpotitur, për të bërë humor, në e kam për të gjithë. Madje me kënaqësi të madhe do vizatoja dibranët, që të qeshim me ta, sepse e ndjej se e kuptojnë humorin tim më mirë se sa të tjerët.

- Por tani pas zgjedhjeve vendore është e vështirë të karikaturosh Lulzim Bashën. Sidomos me njërën nga karikaturat e fundit, kur ai i dorëzon çelësin e Tiranës Erion Velisë?

B.Kapexhiu: Në jetën time kam patur një moto, një devizë: Jam me të gjithë dhe kundër të gjithëve.

Jam me të gjithë kur unë mendoj që të gjithë kanë të shumë të drejtë këtë linjë. Por jam kundër kur mendoj që nuk është në linjën time, nuk është në drejtimin, nuk është ashtu siç mendoj unë. Dhe në përgjithësi në karikaturë kam ndjekur këtë linjë, që ajo që mua më ka pëlqyer dhe e quaj të drejtë kam mbajtur drejtimin përkatës, duke e mbështetur. Kur një veprim a vendim nuk më duket i drejtë, që nuk përfaqëson mendimet e mia, pasionet e mia, shpirtin tim, atëherë unë e kam nënvizuar dhe kam bërë një goditje, shpoti me humor por natyrisht pa fyer, pa denigruar, pa u tallur, pa sharë, por me atë gjë që i tregoj tjetrit që ai mendim,ajo dukuri ai fenomen që ai ka, ai personazh në rastin e veçantë është i papranueshëm për mua dhe i them atij që duhet të korrigjohet. Kështu që, në këtë drejtim, unë kam mbajtur karikaturat e mia, dhe në të gjitha rastet kam menduar që kanë qenë objektive, të drejta. Gjithmonë sipas mendimit tim, por dhe mendimi im nuk është i shkëputur nga mendimi i masës, nuk është i shkëputur nga të gjithë të tjerët, sepse unë lexoj, unë bisedoj me njerëz, marr mendime dhe kështu që arrij dhe unë në një konkluzion se si duhet vepruar në këtë rast dhe e fiksoj këtë gjë të drejtë ose të padrejtë. Kur është e padrejtë unë i bëj karikaturën, por edhe kur është e drejtë unë prapë i bëj një karikaturë miqësore, pasi me anë të karikaturës, me anë të humorit, me anë të qeshurës, unë evidentoj gjënë pozitive në këtë rast. Kështu që, edhe për sa i takon Lul Bashës, unë kam bërë karikatura të cilat nuk kam qenë dakord me drejtimin e Lul Bashës, ashtu siç nuk kam qenë dakord dhe me drejtimet e qeverisë. Por, duhet të kuptojmë një gjë, në përgjithësi, artisti, aq më tepër humori dhe satira dhe karikatura, janë në opozitë. Sepse vetë karakteri i karikaturës, i humorit, i satirës ka një karakter pak sa goditës, pak gërryes, që zhbirilon, që evidenton por dhe që godet atë anë negative ose të papranueshme për njerëzit.

- Meqë jemi në Dibër, karikatura juaj me fshatarin që mban në dorë kërkesën për rrugën e Arbrit para dyerve të mbyllura të kryeministrisë dhe ministrit të financave, shpërndahet akoma në rrjetet sociale...

B.Kapexhiu: Duke qenë dibran, unë kam thënë në një tubim për Rrugën e Arbrit, se "sot jam 60 vjeç dhe kam qenë njëherë në Dibër, por kur të bëhet kjo rruga, në një vit do të shkoj 60 herë në Dibër". Kështu që, në këtë kuptim, duke parë interesimin e dibranëve për Rrugën e Arbrit, kisha ndjesinë sikur kjo punë ra në heshtje, d.m.th. aty nuk punohej, por gërryhej pak nga pak, si dhe ishte jo e saktë ajo punë që po bëhej në Rrugën e Arbrit. Atëherë, edhe unë, me karikaturën time, përpiqem të ndikoj në këtë drejtim, për t'i thënë Kryeministrit dhe ministrit të financave - aq më tepër që e kemi dibran, - që juve nuk po e vini në vijë këtë rrugë që të ndërtohet sa më shpejt, pra jeni neglizhentë, po heshtni. Ndaj e vura atë fshatarin dibran mes dy dyerve, nga të cilat del një dorë që tregon gënjeshtrën. Sot po flitet se Partia Socialiste do ta bëjë Rrugën e Arbrit dhe nuk di se deri ku ka arritur dhe çfarë po bëhet. Por prapë po them që ka një zvarritje.

- Po sikur ju ta keni mërzitur kryeministrin me karikaturën tuaj? Ta zëmë, që rruga nuk mbaron në afat, dhe militantët e Partisë Socialiste t'ju akuzojnë juve se me karikaturën tuaj ju keni mërzitur kryeministrin dhe ministrin e financave, ndaj edhe ata për inatin e karikaturës suaj e lanë këtë punë pas dorë. Pra, militantët do t'ju akuzojnë juve që u tallët me Rrugën e Arbrit, jo qeverinë që nuk e mbajti premtimin....

B.Kapexhiu: Kryeministri dhe ministri janë kaq të emancipuar, janë kaq europianë sa e kuptojnë efektin e karikaturës, që ajo është bërë me dashamirësi. Karikatura është një kujtesë në zhanrin e humorit, d.m.th. që mos e harroni Rrugën e Arbrit, dhe jam i sigurt se ato kur e kanë parë karikaturën, atyre u është kujtuar edhe njëherë premtimi: Oh, Rrugën e Arbrit po na e kujtojnë përsëri, duhet ta bëjmë! Atëherë, përse mos të marrim këtë anë, që kjo karikaturë ndihmon, cyt, shtyn kryeministrin dhe ministrin që sa më shpejt ta kryejnë këtë rrugë.

- Vëllimi juaj i fundit i botuar tani quhet "Kthesë". Pse "Kthesë"?

B.Kapexhiu: Por sepse vetë fakti quhet kthesë. Pushtetin e kishte djathta, kurse tani e ka marrë e majtë. Të gjitha karikaturat që janë në këtë vëllim, janë karikaturat e vitit 2014, në të cilën ndodhi e gjitha kjo kthesë. Pra Shqipëria tashmë është majtas, drejtohet nga një qeveri e majtë dhe që pretendon që është në drejtimin e duhur. Unë them ta shohim.

- Ben Andoni e quan "kronikë në laps". Pse kronikë në laps?

B.Kapexhiu: Dihet tashmë që kronikani është ai që çdo ditë shkruan ndodhitë e tij, ngjarjet e ditës, dukuritë e ditës. Edhe unë po këtë gjë kam bërë, por jo me shkrim, por me vizatim. Aty çdo ditë është një karikaturë që përfaqëson dukurinë e ditës, ngjarjen e ditës, personazhin e ditës. Unë çdo ditë shkruaj me vizatim çfarë ndodh në Shqipëri, përgjithësisht në politikën shqiptare, prandaj dhe Beni e quan "kronika në laps".

- Media sot ka një problem shumë të madh që është liria e gazetarëve për të shkruar dhe informuar. Sa të lira janë karikaturat tuaja te gazeta Mapo?

B.Kapexhiu:Në mënyrën absolute jo. Te ai kuadrat që më është caktuar mua, ajo tokë që më kanë dhënë në përdorim - jo me 7051 - atë e punoj unë, e plugoj unë, mbjell farën që dua unë dhe spektatori do të korrë atë që kam mbjellur unë. Pra, në mënyrën absolute, as edhe njëherë, nuk është ndërhyrë nga stafi i gazetës për atë që unë botoj.

Ditën e shtunë, në gazetën *Mapo* botohet në faqen e parë gjysmë faqe një karikaturë. Te kjo karikaturë ne kemi një bashkëpunim si redaksi. Cili është editoriali që do të trajtohet, na intereson që ne të shkruajmë për këtë dukuri, atëherë dhe unë bëj këtë gjë, brenda kësaj teme, unë zgjedh këndin tim të vështrimit. Jo se ata më diktojnë mënyrën, formën, subjektin. Ata si gazetë kanë caktuar temën, dhe brenda kësaj teme unë realizoj karikaturën. Pra, ky është i vetmi bashkëpunim me gazetën, kurse të gjithë të tjerat janë krejtësisht origjinale dhe të paprekura nga editorët. ■

ANËTARËT E KËSHILLAVE BASHKIAKË

BASHKIA BULQIZË

APPD – 8 këshilltarë

Ardit Tollja	MDL
Abaz Mera	PBKD
Bardhyl Rama	PLL
Ardian Hida	PR
Mentor Lala	PD
Fllanxa Kurti	PD
Halil Jakimi	KONS
Edmond Isaku	PBD

ASE – 13 këshilltarë

Myfit Duriçi	PS
Luiza Tola	PS
Vehbi Xheka	PS
Munir Sinani	PASH
Fatos Muha	PRRL
Arjan Hoxha	ADS
Petrit Cara	PGJ
Gëzim Sala	PDS
Veap Halili	LSI
Marsida Murja	LSI
Behar Cani	PKSH
Lulzim Viçishta	G99
Rrahim Dedja	PDM

BASHKIA DIBËR

APPD – 13 këshilltarë

Tahir Damzi	PBKD
Ramazan Kaza	PR
Myslim Zemzadja	POSH
Rahim Kaleci	PD
Irini Shehu	PD
Shkëlzen Qoka	PD
Jonida Hajrullaj	PD
Naim Gazidede	PD
Anila Daci	PD
Sabri Laçi	PD
Manushaqe Rina	PD
Enida Zenelhasani	PBK
Isuf Hysa	BLD

ASE – 17 këshilltarë

Muharem Rama	PS
Lulzime Dani	PS
Afrim Mikli	PS
Jurida Zebi	PS
Sali Tershalla	PS
Rigerta Vraniçi	PS
Fatmir Selishta	PS
Suzana Çorja	PS
Eraldi Merdini	FRD
Qamil Lata	PDIU
Lindita Shehu	PDIU
Luan Zira	PDIU
Fatbardha Doçi	PDS
Hajri Laci	LSI
Dallondyshe Kaja	LSI
Vildan Qoku	LSI
Kadri Muça	AD

Jashtë koalicioneve

Astrit Ademi - i Pavarur

BASHKIA KLOS

APPD – 9 këshilltarë

Lutfi Ademi	PDMERE
Fatmir Molla	LZHK
Artur Elezi	PPKDSH
Femi Hoxha	PR
Zana Elezi	PD
Gani Lili	PD
Mazllëm Çeliku	KONS
Veri Kuka	PBD
Lulzim Muharremi	LDK

ASE – 12 këshilltarë

Bashkim Dardha	PS
Drita Bala	PS
Gentian Gjinaj	FRD
Qemal Hasa	PDIU
Arben Çollaku	PSHA
Naim Sadikaj	LSI
Aishe Hoxha	LSI
Altin Toska	LSI
Sefki Shinjatari	PUK
Hysen Lela	PDM
Flamur Bala	PSM
Kujtim Martani	PDK

BASHKIA MAT

APPD – 9 këshilltarë

Sefer Lezaj	LZHK
Murat Koliqi	PBKD
Afrim Stafasani	PLL
Behar Qerimi	PR
Rustem Nuzi	PD
Lutfie Barçi	PD
Arjan Lika	PD
Hysni Bukaçi	KONS
Nazmi Mallunxa	BLD

ASE – 12 këshilltarë

Qazim Gjoni	PS
Elisa Gjasta	PS
Selman Duka	PS
Qemal Cenaj	FRD
Roland Sulika	PDIU
Nezir Sinani	PLIDR
Agim Hysa	LSI
Luljeta Skura	LSI
Ibrahim Kurti	LSI
Albert Nuzi	LDSH
Luftim Vani	PSM
Aranit Shpani	PDK

Kujtimet për Peshkopinë



Njerëz të thjeshtë e të mëdhenj në ndershmërinë e tyre

© Foto: Edmond Hasani

Nga **EDMOND HASANI**

Ikam parasysh si dikur, kur një pjesë e tyre ishin gjallë dhe fryma e tyre i jepte jetë qytetit dhe duk punës së tyre. I shihja si njerëz të veçantë, plot dhunti, gati-gati mistike. E pra, ishin njerëz fare të thjeshtë, qytetarë të urtë, punëtorë, vitalë. Secili ndryshe nga tjetri, secili më i mirë se tjetri, secili i ngjashëm me tjetrin, të gjithë qytetarë të mrekullueshëm të Peshkopisë!

Agush Selishta më dilte në ëndërr çdo natë me një gërshëre lulesh në dorë duke më prerë veshët! Padyshim një njeri emblematik i qytetit tonë, si ndërtuesi dhe mirëmbajtësi legjendar i lulishteve tona të famshme, që nuk ju gjendej shoqja në Shqipëri! Sa i egër dukej kur vraponte pas nesh, luleshkulësit e vegjël, aq i dashur, human dhe tolerant ishte në të vërtetë!

Adil Shehu, brilanti i estradës dhe qytetarisë dibrane!

Vasfi Xheladini, pionieri i futbollit dhe gazetarisë dibrane!

Haxhi Gjapi, tregtar për të cilin qarkullonin legjenda se ushqehej me napolona floriri, aq i pasur ishte! Mbahej mend se përpara ndeshjeve të futbollit ulej këmbëkryq pranë fushës së vjetër në Dobrovë, vinte përpara të shtrirë xhaketën e tij ku hidhte një napolon flori ose një kartëmonedhë, e cila do të pasohej e shumohej nga paratë që hidhnin të gjithë spektatorët e tjerë, të cilat shkonin për ekipin e Korabit!

Shaqir Shehu i dyqanit të vajgurit ose Shaqiri i Gazit!

Mirush Mati, mësuesi dhe aktori i lindur!

Cen Manga, kamerieri dhe banakieri legjendar i Turizmit, shpirtmadh, komunikues, dinak, profesionist, bujar tek zoti, kur thonë!

Lejla Tola, një vajzë e shkëlqyer, që mund të ishte edhe missi i parë dibran!

Halla Shaje dhe Remzi Verzivolli, çifti i famshëm, i njohur sidomos për manjakërinë për pastërti të Shajes së shkretë dhe për intelektualizmin e Remziut, i cili ishte diplomuar për veterinari, në mos gaboj, në Gjermaninë e Hitlerit e më vonë kishte luajtur qendërsulmues me Vlorën!

Hysi Shehu, shkodrania fisnike dhe elegante, martuar në një nga familjet e hershme qytetare dibrane!

Ali Baboçi, tregtari e banakieri shurdh pothuajse, që ulërinte kur fliste, një gjirokastrit bujar!

Ahmet Alliu, patologu më i mirë shqiptar, të cilit i thërrisnin Sire Alliu!

Inajet Shehu, aktori brilant, ironik i lindur i estradës së qytetit!

Zake Shahu, tregtari i njohur i ëmbëlsirave me një lokal aty ku sot është Telekomi! Tullumat e tij edhe sot nuk bëhen siç i bënte ai, ashtu i urtë e babaxhan njeri!

> I shoh tani, të gjithë pranë meje, të gjallë e të vdekur, me duart drejt meje duke m'u hakërryer të indinjuar, sepse nuk ka këtu emra të tjerë qytetarësh, por edhe duke më falënderuar që i kam në qendër të kujtimeve të mia për qytetin!

Qamil Bellova, karrocieri më i madh i plehrave!

Qemal Abulja, këpucari i famshëm, më i miri për të cilin tregoheshin lloj-lloj historish!

Bajram Mata, piktor i madh, me një fytyrë ku spikasnin tiparet burrërore e një hollivudiani!

Haxhi Lleshi, presidenti i vendit që nuk jetonte këtu, por kur vinte gjeneronte respekt te njerëzit, të cilët i takonte të gjithë në rrugë dhe gjithmonë na ngjallte kureshtje me syrin e tij fals!

Seiti i Kadiut, një njeri enigmatik, që jetonte sipër librarisë së qytetit e që bëhej gjithmonë objekt shpotitjesh e shakash nga banorët sidomos me të famshmin ''kryq i Seitit''! Kishte një torbë ku mbante një koleksion të madh çibukësh e llullash! Sa herë vinte president Haxhiu këtu, atë do takonte të parin!

Tatjana Alliu, një grua prezentabël e plot hire si rrallëkush!

Jorgji Sinjari, profesori i pavdekshëm, tifoz i çmendur i sportit që hidhte fishekzjarre e shtrihej pastaj përtokë kur bënte gol Korabi!

Sabri Kodra, që shiste kinkaleri tek e famshmja barake e Sabriut!

Sheh Besimi, kleriku mysliman që gjithmonë e kujtoja se ishte pronari i gjithë pazarit, ngaqë xhamia e vjetër poshtë ishte e Shehajve!

Qani Pertafi, mësuesi im i dashur i letërsisë!

Fatmira Vani ose ndryshe Nani, që si edukatore ne çerdhe rriti qindra fëmijë e bashkë me ta 4 vëllezërit e mrekullueshëm Vani!

Tonin Rota, kompozitori brilant me ato flokët e dallgëzuar që, kur e shikoja në rrugë a në skenë, kisha frikë t'i shihja sytë se më dukej mistik!

Emin Lami, tregtari poshtë tek zyrat e komunales, ku shpeshherë pija bozë e haja ëmbëlsira gratis.

Refik Xhilaga, shofer i mirënjohur bashkë me kolegët Hasan Zullumi [çfarë mbiemri!] dhe Abazi!

Melita Shehu, këngëtarja e madhe dibrane, që, sa herë më shikonte në rrugë, më puthte e unë gjithmonë ndjeja një erë të mirë tek ajo!

Lam Zagradi, lypësi i famshëm, për të cilin qarkullonte ndër të tjera legjenda se ishte shumë i zgjuar, por që përtonte të punonte!

Haziz Ndreu i artit popullor!

Nazif Pijaneci, laboranti dhe xhezbandisti i shkëlqyer edhe si aktor!

Riza Sadiku, lustraxhiu më i njohur i qytetit, tifoz i madh i Korabit dhe Tiranës, te baraka e të cilit në qendër të qytetit rrija me orë të tëra duke parë fotografitë e futbollistëve ngjitur në xhama e mure!

Gjyzel Hasani, një qytetar king!

Skënderi i Rikës, një lëkurzi i lezetshëm, i njohur sidomos për kërcimet zbathur në dasma, ku spikaste me Bohamela, Bohamela!

Hiqmet Elezi, një qeleshepunues, mjek popullor, mundës dhe aktor vital!

Hike Kodra, gruaja më e fuqishme e qytetit!

Latif Sala e kolegu i tij Izet Dardeshi, fotografi i njohur, valltar i njohur dhe fans paksa i alkoolit!

Bexhet Shehu, qytetar model dhe trajner i madh futbolli!

Rahim Gjika, gjinekologu i famshëm, që urrente injorancën!

Shah Kamberi i kinemasë që me gjyslyqet e tij më dukej shumë i frikshëm kur na ndiqte nëpër karriget e sallës ku kishim hyrë pa bileta!

Vera Stafa dhe Majla Shahinaj, gjimnazistet më të bukura të të gjitha kohërave në qytet!

Taf Kallaverja, kasapi i fuqishëm i gjatë, me pak mustaqe, që më jepte çdo të diel një shpretkë gratis!

Mësuesi i shëndoshë i rusishtes Boco Muho, për të cilin thuhej se kish luajtur tek Skënderbeu, rolin e bariut!

Ramiz Acka, pastruesi më i madh i oxhaqeve, njeri i përsosur dhe tifoz i madh i Korabit e sidomos Tiranës!

Lavdrim Selami, një njeri shumë i vlefshëm si shofer i druve gjatë dimrit!

Irena Puca, një shkodrane, mësuese, grua dhe njeri trup e shpirt e bukur shumë!

Muntaz Kodra, qytetari më fanatik i rregullit, disiplinës e pastërtisë!

Taxhi i famshëm, sportisti universal, shakaxhiu i pambarimtë!

Selim Alliu, mësuesi i supervlerësuar, të cilin nuk di pse e kisha frikë!

Muzikanti, këngëtari e mësuesi Myrto Baboçi me këngën e tij të famshme Suzi, Suzana!

Drita Pustina, gruaja më e shëndoshë e qytetit, shitëse e lindur, kavaliere, shakaxheshë dhe e sertë kur duhej!

Arif Shehu, ish-nxënësi i shkëlqyer i tim eti, kitarist autodidakt, personazh tragjik i jetës së tij dramatike, ku librat ishin lajtmotiv i saj!

I shoh tani, të gjithë pranë meje, të gjallë e të vdekur, me duart drejt meje duke m'u hakërryer të indinjuar, sepse nuk ka këtu emra të tjerë qytetarësh, por edhe duke më falënderuar që i kam në qendër të kujtimeve të mia për qytetin!

ANEKDODA E MUAJIT

Në kohën e komunizmit, në Kalanë e Dodës ishte një komandant me origjinë nga Jugu i Shqipërisë. Thonë se quhej Zalo. Ai ishte shumë i kënaqur me punën, jo vetëm se në aftësitë e tij mbështetej mbrojtja e atdheut, por se edhe fshatarët e mbanin mirë; i jepnin muhabet, e merrnin për darka e dreka, i gatuanin fli, i nxirrnin djathin më të mirë, kosin e deles e bënin veçan për të dhe herë pas here, i prisnin ndonjë kec a dash.

Meqë po ia kalonte mirë, në postën pranë kufirit, ku ngjitej gjatë muajve të verës, mori edhe familjen dhe atje po shijonte ajrin e freskët, ku përveç mishit të dashit dhe kecit, edhe ndonjë dhi të egër e vriste malit gjatë shëtitjeve të tij në mbrojtje të kufirit.

Një ditë, postieri i komandës e njoftoi se duhej urgjent të zbriste te posta dimërore pranë fshatit, sepse e kërkonin me telefon nga komanda në Peshkopi. Zalo i hypi kalit dhe zbriti në fshat.

- Duhet të nisesh urgjent për Peshkopi! Të kërkojnë në zyrat e Degës së Punëve të Brendshme!

- Po, pse më kërkonin, të thanë gjë?

- Jo, nuk më thanë, por thanë se ishte urgjente.

Në zërin e ushtarit të centralit ndjeu se kishte diçka që ai nuk donte t'ia thoshte.

U nis rrugës dhe mendoi për gjithë punët që kishte bërë në mbrojtje të atdheut: kujtoi rregulloren e sjelljes, marrëdhëniet me fshatarët, kontrollin dy-tre herë në ditë të brezit të butë, shkelësit e kufirit që kishte kapur, edhe ato tre që kishte vrarë dhe i tha vetes se kishte bërë çdo detyrë në rregull, kështu që nuk kishte pse të shqetësohej.

Sapo u fut në zyrën e komandantit, ai, pa e përshëndetur, i tha:

- Shoku Zalo, që sot transferohesh nga posta dhe do të shkosh me detyrë në një rreth tjetër?

- Po pse, shoku komandant, unë jam mirë atje!

- Është urdhër dhe urdhri duhet zbatuar!

Shoku komandant, por unë kam punuar mirë, i kam shërbyer me devotshmëri atdheut. Gjatë kohës që kam punuar unë asnjë diversant nuk ka hyrë dhe asnjë nuk është arratisur, madje-madje, ju e dini shumë mirë se unë i kam vrarë tre prej tyre se tentuan të shkelnin brezin e butë!

- I di të gjitha këto, - i përsëriti komandanti, - por urdhri është urdhër dhe ti që tani do nisesh për atje ku të kanë transferuar!

Kur pa se urdhri nuk kishte kthim, Zalo harxhoi edhe fjalën e fundit:

- Po unë kam edhe gruan në postë, duhet të kthehem të shkoj ta marr!

- Shko në central, merre në telefon dhe prite këtu! - urdhëroi komandanti!

Zalo iu drejtua zyrës së centralit dhe i ra telefonit.

Matanë i doli një nga ish ushtarët e tij. E urdhëroi t'i gjenin urgjent Eshrefin, një nga fshatarët që kishte disa mushka dhe herë pas here i vendoste në dispozicion të postës së kufirit, dhe t'ia nxirrnin urgjent në telefon.

Erdhi fshatari dhe kapi telefonin:

- Alo, - i tha. - Komandant Zalo jam! Duhet urgjent që të marrësh mushkat, të shkosh në postën verore dhe të marrësh gruan dhe plaçkat dhe të m'i sjellësh në Peshkopi!

Por, ndërkohë, atje ishte marrë vesh transferimi i tij, dhe fshatari iu përgjigj:

- Vallahi, nuk bahet çajo puna, - i tha Eshrefi. - Mushkat e maja janë për ata si vajn, or kumandant, jo për ata si shkojnë! - dhe e mbylli telefonin!

(Rishkruar sipas një anekdote, treguar nga Ruzhdi Bitri)

"DIBRA 4K VIDEO", projekti më i ri i Gazmend Kërkutit



Në vitin 2006 për Dibrën realizuam projektin "Dibra në HD", ku u shpërndanë mbi 5000 DVD free për shqiptarët në Europë dhe SHBA. Atëherë nuk kishte internet të fortë dhe facebook, siç ka sot. Me ndihmuan shumë dibranë, por do veçoj kontributin e Kushtrim Ushtelencës, që për 10 vjet na kujtoji ne kurbetqarëve. Sot kthehem me një projekt të ri "Dibra 4K" dhe do të veçoj në përshëndetje z. Bardhyl Marken, i cili prej një viti më ka ndihmuar të arrijmë te ky moment: "DIBRA 4K VIDEO"

"Dibra 4k Video" është një projekt që ka për qëllimi promovimin e natyrës dhe bukurive të Dibrës. Projekti është vazhdim i projektit të mëhershëm "DVD's Dibra në HD", i realizuar në vitin 2006 nga Z. Gazmend Kërkuti. Planifikohet që në vitit 2015 do të sjellim pamje të reja të Dibrës, nga kënde dhe pozita të ndryshme, duke shfrytëzuar fluturake pa pilot nga ajri në formatin 4k video.

Bordi drejtues i këtij projekti përbëhet nga Adhurim (Tallam) Kaja - regjisor, Afrim Kërkuti, inxhinier i elektroteknikës - teknik, Bardhyl Marku, inxhinier i arkitekturës - këshilltar, Bujar Karoshi - gazetar; Gazmend (Menny) Kërkuti në editim dhe Ibrahim Kolari dhe Mice Cenobafte, të dy biznesmenë të njohur, si sponsorë të këtij projekti.

Ka njerës që më duan dhe ka njerëz që nuk më duan! Unë do të vazhdoj të punoj për ata që më duan! Faleminderit Zot që më fal çdo second jetë! Deri në frymën e fundit unë me Dibrën do të jetoj.

Gazmend Kërkuti, Dibër 2015

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Kishim zgjedhje këtë muaj dhe tani zgjedhjet zhvillohen edhe në *facebook*. Të gjithë kandidatët kishin faqet e tyre, që zbukuroheshin me foto të bukura, citate nga njerëz të mëdhenj dhe fjalime të bukura shkruar nga mendimtarët. Madje, ato ngjarje që zhvilloheshin në terren, përgatiteshin me regji, në mënyrë që fotografitë dhe xhirimet që publikohen të dalin mirë artistikisht, Mundësisht, ndonjë portret që të duket një vajzë e qeshur, e cila ka shkruar numrin e partisë në dorë, ballë a faqe, apo ndonjë plak që mezi e mbajnë këmbët, por një kapele partie në vend të qeleshes e mban mbi kokë. Por kulmi ndodhi, kur përkrahës të qeverisë sulmuan faqen në *facebook* të opozitës dhe ia hoqën 800 pëlqime... Dhe për këtë pati deklaratë dënuese, sikur të ishin shkelur ligjet zgjedhore, tamam sikur komisioni t'i kishte hequr 800 vota!

Ama, zgjedhjet këtë herë mbaruan më shpejt, numërimi në fakt. Përveç disa incidenteve të vogla, sa për të mos marrë m'sysh kandidatët, gjithçka tjetër shkoi mirë. Dhe në faqen e fituesit filluan urimet, aq shumë urime, sa kandidati nuk i kishte parë as në ëndërr gjatë fushatës. Madje edhe urime me poezi, në bejte apo me tregime heroizmi... Ja njëri preje tyre: "Urime i nderuar! Ta gëzosh postin! Të uroj unë me gjithë familjen, xhaxhai im në Belgjikë dhe dajo në Amerikë! "U rrajtsh e u plaksh në at karrige për të majrën e sucialistëve dhe lsi-stëve dhe për inat të demukratëve!".

Tani pritet fushata e heqjeve nga puna dhe futjes në punë. Këta të dytët pritet t'i thonë kryetarit të ri: "Or dashamajr, unë e due i vend si drejtor, se t'i kam ba like në *facebook* të gjitha fotot!"

Gjatë fushatës Kryeministri shkoi në Tunelin e Qafë Buallit! Sukses i madh! Fotografi të bukura! Qeveria në 18 muaj e hapi tunelin, tani ka edhe 24 muaj përpara për të bërë rrugën dhe tunelin tjetër! Sikur është shumë, 27 km gjithë e gjithë! Veç dy numra dhe dy shkronja!

Kryetari i Parlamentit tha në Bulqizë se në vjeshtë fillojnë punimet dhe vjeshtë mbarojnë. Por se në cilën vjeshtë fillojnë dhe në cilën vjeshtë mbarojnë, do të na e thotë fushatën tjetër.

Iku qershori dhe qindra kuintalë qershi i hëngrën mizat dhe zogjtë dhe qindra të tjera u hodhën në plehra. Kujtohen politikanët: "Vitin tjetër do të marrim urgjent masat që kjo të mos ndodhë më!" Pastaj vjen vjeshta dhe treg nuk ka për misrin, për grurin, mollët kalben magazinave dhe patatet gjithashtu në kavaleta. Dhe politikanët, prapë netëve të gjata të dimrit, na mbushin mendjen në seminare dhe debate se kjo që ka ndodhur këtë vit, nuk ka për të ndodhur më. Dhe kështu ndërrohen stinët dhe të njëjtat gjëra kalben vit pas viti. Dhe politikanët nxjerrin prapë justifikime, sikur nuk kanë ndodhur më parë. 25 vjet kjo histori dhe 25 vite nuk na është mbushur mendja t'u themi shporru mashtruesve dhe vetë ta ndërtojmë tregun. Dibranët janë punëtorë dhe mund ta bëjnë tregun pa ndihmën e kodoshëve mashtrues që ndryshojnë partitë e karriget, por gjithmonë thonë të njëjtat gjëra.

Me qershorin fillon dhe vera, dhe po erdh' vera, fillon edhe plazhi. Dhe mërgimtarët do të mblidhen në Dibër për t'u çmallur me familjarët, për t'u larë në Drin e liqen, për të kërcyer në dasma me tufa lekësh në duar. Dhe pastaj prapë ia nisin nga e para, ikin të mërzitur me bindjen se "Dibra nuk bëhet"...

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashtu si në mbarë gjuhën shqipe,edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe,qe kane hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale,ndërsa disa të tjera jane transformuar.Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke,nga e cila erdhën tek ne,ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve.Unë nuk e njoh gjuhën turke,që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë.Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre,se mund të ketë edhe të tjera,duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe.Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe,gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes,disa të tjera tashmë jane rrënjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor.Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *

(Vijon nga numri i kaluar)

Merhum – i ndjerë, i vdekur
Mesele – çështje, problem
Mexhelis - vend uljejej, kuvend, këshill
Meze – ushqim midis të ëmblës dhe të thartës
Mihrab – kryevend; vendi i imamit ne xhami
Milet – popull, komb, bashkësi fetare
Minder – vend per pritjen e miqëve në shtëpitë fshatare
Mindil - shami
Misir – Egjipti
Misk - lloj parfumi
Mistri – vizore
Muezin –(muedhdhin) thirrësi për në falje
Muhabet – (mehabba) dashuri, simpati
Muhalebi – llojë embelsire me qumësht,oriz të bluar dhe sheqer
Muhasere – rrethim, bllokadë
Muhaxhir - refugjat
Muhib - dashurues, dashamir
Mukajet – i lidhur, i angazhuar
Mulazim – nëntoger
Murat – gjë e deshiruar; dëshirë
Murtad - tradhëtarë, renegat.
Musaf – liber
Musliman – besues ne fenë muslimane
Mutaf - vendrrotullim
Myderis – mësues
Mysafir – rrugetar, udhëtar
Myshteri - blerës
Nahije – anë, krahinë
Nallane - kepucë
Namus – nder
Nasihat – sinqeritet, çiltërsi
Naze - kapriço; ojnë, llastim
Nenexhik– (Fjale e perbere nga fjala arabe na'na dhe asaj turke xhik) - mente
Nijet - qëllim. Kam nijet – synoj,kam si qëllim
Nizam – 1.rregull; 2. rregjim
Nur – dritë, lule
Okë– masë peshe e barabartë me 1.248 kg
Pelivan – gjimnast, qe ecën në tel apo litar
Puçër– kethizë
Qafir– i pafe, mohues i të mirave të Zotit
Qatip– shkrues, sekretar
Qeder - shqetësim,brengë.
Qef– deshirë, humor,gëzim. Kam qef – kam dëshirë,më pëlqen.Si ma ke qefin? Si m'i ke dëshirat?
Qefil –garantues, garant
Qefin–beze me të cilën mbështillen të vdekurit tek muslimanët
Qemer - dritare, baxhë për të dalë në çati
Qenef – nevojtore
Qerim – bujar. Prej këtu: Allah qerim - Zoti është bujar
Qese – kuletë, pajisje per mbajtjen e parave
Qibar – nder, pozitë
Qibër – mbajtje më të madh
Qibrit - squfër
Qira – rent; dha me qira- arentoi
Qitap – libër
Rab – zot, pronar. Ja Rabb! – O Zot!
Rabilalemini – (rab-il-al-alemin) Zoti i botëve; Zoti
Raft– dërrase që vihet në murë etj. ku vihen plaçka e gjëra të tjera
Rahim - mëshirues
Rahman - mëshirues
Raja– popullsi, nënshtetas
Rakat– gjunjezim; ulje në gjunjë
Raki – (arak) raki
Ramazan– muaji i nente i kalendarit hënor me 30 ditë. Muaji i agjerimit terk muslimanët
Raxhim – i mallkuar; shejtani rasxhim – djall i mallkuar.
Rehat– pushim, qetësim.Prej këtu rehatoj- qetësoj
Resme– vizatim
Resul – i derguar
Reze - rreze dere, kllapë, vegë, hekur dere
Rezil - i keq; i poshtër, i ultë; njeri me vese të këqia

(Vijon numrin e ardhshëm)

Një përshkrim për Agimin,
Zabitin, Azisin, Lutfiun, Bujarin etj.

Rrugëtim *mes psherëtimash dhe* **mall mërgimtari**

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



1


2

Me autobusët e linjës Top-line, udhëtohet rehatshëm, në qetësi, në respekt për pasagjerin e në një komunikim me kulturë. Nuk është pak por rreth katërmbëdhjetë orë ngrirë në ngushtësinë e karriges komoditeti i së cilës ta lehtëson ose jo rrugëtimin.

Kakavinë, pikëdhembjen mërgimtare ku akrepat e orëve ndalen e durimi ngjitet në rezonancë, e kaluam si të ishim në Evropë. Përpara nuk kishim asnjë autobus çka na e ngjiti buzëqeshjen si me zamkë, e një nga një, pa u ngutur zbritëm për tu vënë në radhë për vulën e kalimit mbi pasaportë. Radha u prish. Tre policë, në tre kabina, na e bënin me duart zgjatur si shatë duke na tërheqë secili në drejtim të tij. Në pak sekonda mbaruam e për disa minuta u nisëm drejt pikës kufitare shqiptare.

Një kalim kufiri që do ta donim të ishte çdo ditë, çdo natë, në dimër dhe në verë...

E urova...

Megjithëse dita ditës nuk i ngjan...

KOMPLEKSI "AGZA-DIBRA" DHE KANALI FOLE MUSHKONJASH...

Agimi dhe Zabiti janë dy dibranë që pak kohë më parë bashkia e Durrësit ku jetojnë dhe punojnë u dha titullin "Qytetar nderi". Nuk njoh rast tjetër por që t'u jepet titulli më i lartë i qytetit dy ndërtuesve është një vlerë e shumëfishtë. Dhe titulli u është dhënë për korrektësi dhe cilësi në ndërtime...

Agimi dhe Zabiti në plazhin e Malit të Robit i kanë qëndruar paksa larg detit, nuk janë përzierë në mishmashin e ndërtimeve dhe të pushtimit të detit me linja të gjata me gurë e panele çimentoje në mbrojtje të pronave të tyre. Ata kanë ndërtuar një kompleks modest me tre godina tre plus papafingo, rrethuar me mure dekorativë, shtruar me kalldrëm tullash, gjelbëruar me shije urbanisti...

Ke dëshirë të pushosh, madje të jetosh tërë vitin në këtë mjedis. Të përjetosh qetësinë, të dëgjosh zërat e fëmijëve tek luajnë me njeri tjetrin në oborr pa shqetësimin e prindit kur fëmija del nga dera e apartamentit...

Mallin dhe dëshirën ma prish kanali i zhytur në ujëra të zeza e kallamishtesh që gjejnë ushqim të bollshëm për tu rritur e harbuar, fole mushkonjash që nuk ndalen përpara asnjë helmi...

Thonë se kanalin dhe rrugën nga autostrada ende në zhavorr e gropa do ti sistemojnë. Kanalin do ta fusin në tuba e rrugën do ta shtrojnë me asfalt, vetëm pesëqind metro rrugë dhe diku tek dy kilometra deri në derdhje në det...

Thonë...

E kanë thënë tash dhjetë vjet...

Me të thënë e me të bërë kanali vazhdon t'i derdhë ujërat e pista në një det të tërë...

MIQ QË MË ÇUAN NË VENDLIDJE

Tiranën në dy tre ditë nuk e sheh dhe as të sheh. Koha në maj edhe të djeg edhe të lag. Ke dëshirë t'i takosh të gjithë, gjini e gjak, miq e shokë por nuk mundesh...

Nuk e njihja Azis Ketën përveçse në komunikimet në internet. Më kishte kërkuar shumë herë që sapo të vija në Shqipëri ta takoja. Kur u nisa i përcolla numrin e celularit në Shqipëri.

Ishte telefonata e parë që mora dhe këmbëngulja e fortë që të takoheshim. Më tha se do të mërrte me vete Lutfi Hankun, bashkëmësuesi im në shkollën e mesme bujqësore "Nazmi Rushiti", autorin e librit për heroin e njohur partizan që hyri në këngë me krismën e pistoletës në Zerqan mbi kapitenin e xhandarmërisë italiane...

"Se ky popull ka djem me huqe,
Këmishën e zezë ta bën të kuqe"...

U ulëm në një lokal ku dikur ka qenë hoteli "Vjosa" dhe gjerbëm kujtimet e viteve të largëta.

Ketët e Bulqizës i kam njohur herët. I pari ka qenë Esat Keta portretin e punës si tornitor në Ndërmarrjen Gjeologjike të Bulqizës e kisha skicuar dhe botuar në "Zërin e Rinisë" në vitin 1964...

Më vonë në jetën time fisi i Kete do të ishte i pranishëm e respekti për ta do të rritej vazhdimisht...

Lutfi Hankun kisha kohë që nuk e kisha takuar, afro njëzet vjet...Ishte po ai Lutfi që njoha nga afër në shkollën e mesme bujqësore, i qetë në nxjerrjen e fjalës, Lutfiu që edhe në emigracion më ka ardhur sa e sa herë në kujtimet e dy ish nxënësve tanë të dhënë pas letërsisë, Gjon Neçaj tash në Tropojë, poet e hulumtues në vlerat e mëdha të trevës verilindore të vendit tonë mbushur me këngë e legjenda që ta ndalin frymën, dhe Gjovalin Lumaj nga skaji më verior i Shqipërisë, Vermoshi, poezitë dhe proza e të cilit më vjen në faqet sociale si margaritar i një malli që nuk shuhet nga Miçigani i Shteteve të Bashkuara të Amerikës...

Kthehemi së bashku në Peshkopinë tonë që me mall e dhimbje e lamë apo na la. Nën kurorën e blirëve, tash kur pemët janë kapur duarsh për të formuar një tunel me gonxhet gati të varin gonxhet në lulëzim për të shpërndarë erën e mrekullueshme, kujtimet na ulen në gjunjë e malli na bërtet "Kthehuni, ju jeni për këtu" ...

Lutfiu ka qenë mësues letërsie, ka lëvruar tregimin, reportazhin e përshkrimin në publicistikë. Ka lëvruar edhe romanin. Por mbi të gjitha parmenda e punës së tij letrare ka bërë hulli të thellë në arën e madhe të monografive për njerëzit e mëdhenj të luftës. Pas NazmiRushitit ai do të rrëmonte në jetën dhe veprën e Baba Faja Martaneshit. Libri për të do të rrëmbehej pa ra në tokë. Më tej do të vazhdonte me Gjokë Doçin, trimin lurjan që ra në Symizë të Mallakastrës, lapidarin e të cilit banorët e kanë ruajtë si në ditën e parë të vendosjes...

Azizi merrej me pikturën, kishte një koleksion



3

të madh me piktura dhe një studio për ruajtjen dhe propagandimin e tyre...

Ishte një mbrëmje e bukur mes dy njerëzish që të "lodhin" në udhëtimin në vendlindje duke të çlodhë me mallin e dashurinë që përcjellin...

NË STUDION E BUJAR KAROSHIT...

Nuk mund të shkoj në Tiranë e të mos vizitoj studion e Bujar Karoshit dhe bashkëshortes së tij Miranda Golecit, njeri me rrënjë të vjetra në Fushë të Çidhnës, "një pash" larg Drinit, e tjetra me rrënjë në Rabdisht, "një pash" nga kufiri shqiptaro-shqiptar, një fshat i vogël me bjeshkët në krye e vargmalet që nga njëri krah, majë pas maje kapen dorë për dore me Korabin, e nga ana tjetër me Kërçinin në prehrin e të cilit mban Dibrën e Madhe m'atë anë e fushën pjellore të Maqellarës në këtë anë. Një çift që rrallë e gjen...

Bujari është botues i librave të mi dhe i librave të shumicës së krijuesve dibranë.

Atë ditë, bashkë me mikun tim të viteve të shkuara të punës në një gazetë të madhe të vendit, Naim Zoton, përgatiteshin për festën e librit, festë në të cilën kishin stendën e tyre...

Si gjithnjë, kësaj radhe do të merrja me vete një libër enciklopedi për arsimin në trevën e Dibrës, vëllimin II të mësuesit dhe studiuesit kaladodas Xhemal Domi "Dibra në hulli të historisë" si dhe librin e mikut tim të vjetër Mevlud Buci "Alegoria e Dibrës filozofi e shekujve" (Gjurmime alegorike, anekdota, shprehje popullore) për tua shtuar librave të shumtë botuar nga Bujari dhe Miranda, që zënë një raft të tërë të bibliotekës së mërgimtarit...

Në do ta marrësh Dibrën me vete larg e larg "nëntë male kaptuar" për të shuar mallin e vendlindjes shko në studion e Bujar Karoshit...

Foto 1: Kompleksi AGZA, Golem, Durrës.
Foto 2: Azis Keta, Lutfi Hanku dhe Abdurahim Shiku.
Foto 3: Fragment nga rafti i librave të autorëve dibranë në librarinë M&B

BLERTA METHASANI
photographer
Mob. 069 88 55 999
E-mail. blerta.methasani@gmail.com
FB: Blerta Methasani Photography
Wedding, Event
Potraits & More

Qendra Shqiptare e Syve
Prof. Asc. ALI TONUZI
kirurg vitreorentinal
Adresa: Rr. "Dibrës",
Kompleksi Halili,
Përballë Vila "**Gold**", Kati II.
Tel: **+355 4 2419087**
Cel: **0694003600**
E-mail: **tonuzi_ali@hotmail.com**

Eja në Botën e Ngjyrave
"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë
ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT
Së bashku ne mund:
- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ
Adresa: **Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.**
***Tel:* 068 22 46 400**

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*
***Merr versionin* PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj**
Për informacion: E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

intervistë

Intervistë me qitësen **Fitnete Lala - Schmid:**
Sporti i qitjes në Peshkopi ishte shumë popullor (si edhe shumë sporte të tjera si volejbolli, mundja, alpinizmi, shahu), që ia ngritën edhe më shumë vlerat dhe emrin Dibrës.



Dua të përfaqësoj ngjyrat kuq e zi në veprimtari ndërkombëtare

Nga **SASHENKA NDREKA**

- Si lindi dhe u zhvillua pasioni juaj për sportin e qitjes?

- Isha në vitin e dytë në gjimnaz kur nisa sportin e qitjes, pasi trajneri i qitjes së KORABIT, Hasan Shehu, në atë kohë më kishte pikasur për sy pushke. Dhe kështu fillova sportin e bukur të qitjes. Brenda një kohe të shkurtër arrita të merrja rezultate të larta.

- Me ç'vështirësi u përballët gjatë fillimit të karrierës, duke qenë se femrat në ato kohë duhet të zbatonin detyrimet që u ishin paracaktuar, jo të ndiqnin ëndrrat apo dëshirat?

- Nuk pata asnjë vështirësi në atë kohë, përkundrazi, pata mbështetjen e familjes. Madje, im atë më ka shoqëruar në disa aktivitete kombëtare duke më inkurajuar për rezultate më të larta.

- Sa ndikoi në karrierën tuaj prejardhja nga një periferi e Dibrës?

- Sporti i qitjes në Peshkopi ishte shumë popullor (si edhe shumë sporte të tjera si volejbolli, mundja, alpinizmi, shahu), që ia ngritën edhe më shumë vlerat dhe emrin Dibrës.

- Cilin do të veçonit si momentin më të bukur të atyre viteve? Po më të vështirin?

- Momenti më i bukur ka qenë kur u shpalla Kampione kombëtare për herë të parë, duke bërë shumë krenare familjen time veçanërisht tim atë, i cili kishte shumë besim tek unë.

- Si e ndryshoi jetën dhe karrierën tuaj zhvendosja në Zvicër?

- Me mbështetjen e bashkëshortit tim u prita shumë ngrohtë nga ekipi i qytetit ku unë jetoj. Kjo më bëri që unë edhe sot e kësaj dite stërvitem pranë ekipit, duke e përfaqësuar atë me dinjitet.

- Në qoftë se do t'ju kërkonin të përfaqësoni flamurin kuq e zi nëpër kampionate të ndryshme qitjeje botërore, a do të pranonit?

- Me shumë dëshirë.... sepse unë jam dhe mbetem shqiptare (madje krenare që jam cuc dibrane).

- Ç'mendim ka bashkëshorti juaj zviceran për Shqipërinë? Po fëmijët tuaj?

- E adhurojnë Shqipërinë si bashkëshorti, ashtu edhe fëmijët.

- A e kanë vizituar ata Dibrën? Po dialektin dibran, jua keni trashëguar?

- Jo vetëm që vijmë çdo vit në Shqipëri, por shkojmë edhe në Peshkopi, madje dhe në Qafëmurrë në fshatin e gjyshit. (Im shoq sapo është kthyer nga Shqipëria si i ftuar në festën e organizuar nga komuna në Balgjaj, i mrekulluar nga mikpritja e banorëve të Katër Grykëve).

- Cilat janë planet tuaja afatshkurtra që do të donit t'i ndanit me lexuesin tonë?

- Krahas detyrimeve familjare dhe punës time si përkthyese, të përfaqësoj ngjyrat Kuq e Zi në një nga aktivitet ndërkombëtare.



SHKOLLA 12-VJEÇARE JOPUBLIKE
"Sarina"
REGJISTRIMET KANË FILLUAR
Çmimi vetëm për mësimdhënie për 1 vit akademik:
CIKLI 9-VJEÇAR: 80 000 lekë
CIKLI I MESËM: 100 000 lekë



SHKOLLA "SARINA 2002" OFRON:
- Programe bashkëkohore të miratuara nga MAS.
- Staf të përzgjedhur mësuesish.
- Kushte të mira mësimdhënie-nxënie.
- Numër të kufizuar nxënësish në klasa.
- Trajtim të barabartë të të gjithë nxënësve.
- Respekt maksimal të individualitetit, personalitetit dhe prirjeve të secilit nxënës.
- Mësim të gjuhëve të huaja: anglisht e italisht.
- Laboratorë informatike, bio-kimie, fizike.
- Siguri dhe shërbim shëndetësor periodik.
- Ushqim cilësor.
- Mjedise çlodhëse, sportive, fushë minifutbolli, volejbolli, basketbolli, palestër etj…
- Transport deri në shtëpitë e nxënësve.
- Komunikim në çdo moment me prindërit.
- Monitorim të vazhdueshëm të procesit mësimor edukativ.

MISIONI I SHKOLLËS
- Të arsimojmë (të japim njohuri , shprehi, shkathtësi bashkëkohore)
- Të edukojmë, transmetojmë parime e vlera.
- Të zhvillojmë (te rrisim aftësitë fizike e mendore të nxënësve)
- Të njohim nxënësit me rregullat e shoqërisë në të cilën jetojmë dhe të kërkojmë zbatimin e tyre.

SYNIMET AFATËGJATA
- Zhvillimin e personalitetit, mendimit e veprimit të pavarur, kritik, tolerant etj
- Nxitje për rezultate të larta e reale dhe për pjesëmarrje aktive në jetën e shkollës.
- Rritje e iniciativës dhe dëshirës për ndryshim.
- Edukimin e vlerave atdhetare, njerëzore, morale e demokratike.
- Mundësimin e krijimit e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit.
- Aftësimin e tyre për përballimin e jetës.

NE ASPEKTIN VETJAK
- Të njohë, të kuptojë të drejtat e tij dhe ti mbrojë ato.
- Të planifikojë një mënyrë të shëndetshme jetese.
- Të rrisim interesin e nxënësve për të mësuarin gjatë gjithë jetës.
- Të përshtatet ndaj ndryshimeve shoqërore.
- Të njohë të drejtat e individëve të tjerë, ti respektojë e ti mbrojë ato.
- Të mirëkuptojë larminë e kulturave shoqërore.
- Të ndihmojë në përmirësimet shoqërore të komuniteteve që u përket (familja, shkolla,etj..)
- Të bëjë zgjedhjen e tij të suksesshme të karrierës.
- Të kuptojë përgjegjësitë në mbrojtje të mjedisit.

SHKOLLA JONË SIGURON
- Programe bashkëkohore të miratuara nga MAS.
- Staf të përzgjedhur mësuesish.
- Kushte të mira mësimdhënie-nxënie.
- Numër të kufizuar nxënësish në klasa.
- Trajtim të barabartë të të gjithë nxënësve.
- Respekt maksimal të individualitetit, personalitetit dhe prirjeve të secilit nxënës.
- Mësim të gjuhëve të huaja: Anglisht e Italisht.
- Laboratore informatike, bio-kimie, fizike.
- Siguri dhe shërbim shëndetësor periodik.
- Ushqim cilësor.
- Mjedise çlodhëse, sportive, fushë minifutbolli, volejbolli, basketbolli, palestër etj…
- Transport deri në shtëpitë e nxënësve.
- Komunikim në çdo moment me prindërit.
- Monitorim të vazhdueshëm të procesit mësimor edukativ.

Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 1
Përballë Vodafonit.
Tel. 04 240 7828 Cel. 068 20 37 865
E-mail: shkollasarina@gmail.com
ëëë.sarina2002.edu.al

Monografia ‘”Jashar Zeneli” e studiuesit Zabit Lleshi ka vlera njohëse dhe edukuese, prandaj dhe për këtë është i dobishëm botimi.Estetikisht libri është i arrirë. Jashar Zeneli e meritonte një monografi dhe autori ia ka arrirë.

PREZANTIMI I LIBRIT

Një emër i njohur jo vetëm në Grykën e Vogël

Më datën 18 qershor ora 18, në sallën e Akademisë së Shkencave dhe nën përkujdesjen direkt të shoqatës së historianëve të rrethit Dibër e shtëpisë botuese “M&B” u bë promovimi i librit “Jashar Zeneli (Bllaca)” me autor Zabit Lleshi.

Kishin ardhur miq e të ftuar, nga Dibra e Skrapari, nga Tropoja e Kruja, studiues e historianë. Krejt ndryshe nga herët e tjera në të tilla raste moderator i këtij evinementi ishte një mësues, një mësues që kishte dhënë në vitet para nëntëdhjetës gjuhë frënge në shkollën e mesme Sllovë, Sejfulla Kada. Diskutantët nuk e kishin të vështirë të flisnin rreth librit dhe figurës së Jashar Zenelit (Bllacës) pasi ishte një figurë e njohur jo vetëm në Grykën e Vogël por në të gjithë Dibrën dhe më gjërë se veprimtaria e tij arsimdashëse,patriotike e atdhetare kishte një gjeografi të madhe por që në fakt ende nuk kishin gërmuar kaq thellë sa autori i kësaj monografie Zabit Lleshi.

Rreth vlerave të librit por dhe për të folur edhe mbi fugurën e Jashar Zenelit i pari e mori fjalën Elmaz Lala i cili ndër të tjera tha: ”Autori i monografisë na e gdhend figurën e Jashar Bllacës edhe në një dimension tjetër, si njeri prej kontribuesve me emër në luftë për arsimin e shkollës shqipe. Fillimisht analfabet,por me intelekt natyror, që njohuritë e para të shqipes i mori te Teqja e Bllacës e që u rrit më pas nga kontaktet me figura të shquara të qytetit të Dibrës së madhe si Seit Najdeni etj, për të vijuar me shërbimin si mësues në shkollën e Bllacës dhe punoi përhapjen e shkollave shqipe në tërë krahinën.Është ndoshta unikale që tre breza të familjes së tij i janë përkushtuar arsimit e shkollës kombëtare në etapa”.

Moisi Murra ,historian por edhe kryetar i shoqatës së historianëve të Dibrës u ndal më gjatë rreth personalitetit të Jashar Bllacës i lidhur ngushtë ky edhe me parinë e Dibrës. Nëpërmjet kësaj figure ne njohim të gjithë Dibrën dhe historinë e saj ndaj shpreh bindjen se autori na ka dhënë një vepër të mirëfilltë shkencore.

Mësuesi veteran Mendu Dema solli kujtimet e tij të bukura si bir i krahinës së Grykës së Vogël jo vetëm për rolin në fushën e arsimit shqip të Jashar Zenelit por dhe ne veprimtarinë e tij patriotike e atdhetare.

97 vjeçari Ferit Alimani na solli të tjera kujtime i cili e kishte njohur nga afër Jashar Bllacën, e kishte njohur kur punonte në administratë shtetërore të cilin së bashku me djalin e tij Skënderin, të dy fëmijë të vegjël i mori në Gramësh, pasi atje ishte me punë ku dhe vazhduan shkollën, por vetëm dy muaj në Gramësh.Jashari trasferohet në Shijak, kështu dhe ne të dy me Skënderin e e ndoqëm pas në Shijak për të vazhduar shkollën. Jashar Zenel (Bllaca) punoi në Gramësh, Shijak, Koplik, Fier,Tepelenë e Tiranë dhe kudo që punoi la gjurmë të pa shlyera tek vendasit, tha ndër të tjera Ferit Alimani.

Shemsi Manjani solli kujtimet e tij që edhe pse në moshë të vogël në ato vite kujtonte Jashar Zenelin kur vinte në fshat e kur të gjithë e reaspektonin dhe ia dëgjonin fjalët dhe mendimet që shfaqte.

Autori i librit Zabit Lleshi shprehu konsideratën e lartë për të gjithë ata që i kanë qëndruar afër gjatë kësaj kohe që ishte i angazhuar për të përfunduar monografinë e Jashar Zenelit,falenderoi edhe të pranishmit që u shkëputën nga punët e tyre dhe erdhën në këtë promovim.

Në fund, në emër të familjes përshëndeti djali i Jashar Zenelit, Skënderi, i cili i falenderoi të pranishmit, autorin si dhe diskutantët e shumtë që folën në këtë takim. Në fund i ftoi të gjithë të pranishmit në një koktej që organizonte vetë familja Zeneli.

Shaqir Skarra

Jeta dhe vepra e atdhetarit Jashar Zeneli sipas optikës së studiuesit Zabit Lleshi

Nga **MOISI MURRA**

Atdhetari Jashar Zeneli ka një veprimtari, në dobi të lëvizjes kombëtare, plotë katër dhjetvjecar, Jashar Zenelit.Autori kësaj monografie, studiuesi Zabit Lleshi, i mbështetur në dokumentet arkivore, literaturën historiografike, shtypin periodik të kohës dhe tregimtarët e shumtë gojor, na e ka dhënë portretin e Jashar Zenelit me realizëm, vertetësi e pa komplekse. Domosdo në trajtimin e figurave atdhetare po nuk pate një farë opinion që vjen nga njohja personale apo nëpërmes dokumenteve, nuk mund ta trajtosh .Këtij tundimi nuk i ka shpëtuar dhe autori i kësaj monografie, gjë që do të thotë se vec aparatit shkencor ka derdhur gjithë ndjenjat e dashurisë, sepse në fund të fundit po qe se nuk e dashuron një figurë atdhetare është vështirë të shkruajsh qoftë dhe dy rrjeshta për ‘të. Autori, ka meritën që këtë figurë atdhetare që njihej për peshën e fjalës, ta nxirrte nga Oda Dibrane, për një publik më të gjërë.Me një gjuhë të rrjedhshme, vertetësi, e objektivitet autori ka arritur të realizojë një lidhje të brendshme organike në konflikt me faktorin e Jashtëm, turqinë osmane dhe pushtuesit tjerë, duke e bërë punimin interesant, të kapshëm e të lexueshëm për të gjitha moshat e nivelet arsimore.



Atdhetari Jashar Zeneli ka një veprimtari, në dobi të lëvizjes kombëtare, plotë katër dhjetvjecar, Jashar Zenelit.Autori kësaj monografie, studiuesi Zabit Lleshi, i mbështetur në dokumentet arkivore, literaturën historiografike, shtypin periodik të kohës dhe tregimtarët e shumtë gojor, na e ka dhënë portretin e Jashar Zenelit me realizëm, vertetësi e pa komplekse.

Botimet M&B.
ISBN: 978-9928-172-51-8
Çmimi: 700 lekë

Jashar Zeneli i përket atij brezi që i pa dhe i matin ngjarjet e kohës me fuqinë e mendjes, por dhe grykën e pushkës.Fillesat e para të veprimtarisë atdhetare të Jashar Zenelit i përkasin vitit 1908 kur një grup intelektualësh të qytetit Dibrës, Shehrit, themeluan klubin “Bashkimi “ të Dibrës, që dha një kontribut të jashtzakonshëm në zgjimin e ndjenjave kombëtare të dibranëve në prag të shpalljes së pavarësisë.Në këtë klub (shoqëri) Jashar Zeneli, anëtar I së cilës ishte, u njohë e bashkëpunoi me shumë figura atdhetare që i dhanë tonin e duhur lëvizjes kombëtare në Dibër, si në rafshin arsimor ashtu dhe atë të pregatitjeve për organizimin e kryengritjeve kundër Osmane. Jashar Zeneli ka meritën e pa diskutueshme të mësimit të shqipes në Bllacë. Nën shembullin e klubit Bashkimi të Dibrës dhe Jashari, me mbështetjen e Baba Sufës së Teqesë së Bllacës arriti të krijoi shoqërinë e të mësuarit shqip në Bllacë.Në këtë shoqëri, ku bënin bënin pjesë Selman Jella, Osman Xheka, Rexhep Krosi, Murat Daci, Seid Tasha, etj që autori i librit , Zabit Lleshi i ka përshkruar me detajëë. Në vitin 1918, pasi kreu një kurs për xhandarmëri në Tiranë, ai titullohet oficer dhe shërben në armën e xhandarmërisë në Tiranë, Dibër, Koplik, Gramsh e Shkodër.

Në korrrik të vitit 1920, me c’rast krijohet Prefktura e Dibrës, që përfshinte nënprefekturën e Homeshit, të Hasit dhe Peshkopisë, qeveria e Sulejman Delvinës vuri në dispozicion të Prefekturës një trupë prej 150 xhandarësh, ku si officer shërbenin Preng Jaku tek Ura e vezirit, Duleman Cela i Patinit tek Ura e Arrasit dhe Jashar Zeneli në Luzni.Në këtë kohë ushtria serbe kishte kapur dhe mbante gjithë pjesën lindore të Drinit të Zi nga Ura e Dodës deri tek Ura e Spiles .Për të dëbuar ushtrinë serbe nga Dibra përfaqësuesit e qeversë dhe krerët e Dibrës u u tubuan në Fshatin Arras. Në këtë tubim morën pjesë : Ramiz Bej Dibra, Dine Bej Maqellara, Izet Bej Maqellara, Ramiz Daci, Jashar Erebara, Dulejman Cela nga Patini i Matit, Ismail Strazimiri, Dine Hoxha, Rushit Sina, Selim Alia, Selë Bajraktari, Selim Noka, Haxhi Noka (Grykë Nokë), Murat Kaloshi, Avdi Kaloshi, Selim Kaloshi (Sinë), Met Skepi, Dan Cami, Selman e Hakik Mena nga Lurai, Llan Destani (Lukan), Kurt e Dik Spata (Grykë Nokë), Jashar Zeneli, Ali Tahiri (Pira-Muhurr), Destan Puca Sopot, Osman Lita i Ploshtanit e shumë burra të tjerë me zë nga gjithë Dibra. Kuvendi vendosi të sulmonin ushtrinë serbe dhe pasi të clironin Dibrën e Poshtme të marshonin dhe të rimerrnin qytetin e Dibrës me rrethina. Ditën e 13 gusht 1920, që krerët e Dibrës kuvendonin në Arras, trupat jugosllave sulmuan karakollet në Luzni, dhe goditën me artileri, nga Lisi i Trenës, shtëpiat e Dine Hoxhës në Muhurr dhe shtëpinë e Hazis Manukës në Luzni, që kjo e fundit ishte kthyer objekt i xhandarmërisë shqiptare e ku Komandant i postës të xhandarmërisë ishte toger Jashar Zeneli Bllaca dhe pastaj sulmoi me trupa.Sipas tregimtarëve gojor dhe që autori e ka përshkruar mjaftë mirë , Jashar Zeneli Luftoi si burrë, si dibran, si Bllacas.Dibra vullkanizoi. Ushtria serbe u thye keqas dhe më 15 gusht 1920 në darkë kishte kaluar hanet e Mavrovës. Pas kundërofensivës serbe Jashar zeneli luftoi bashkë Destan Pucën e Mehmet Duricin në Qafë të Buellit e në Dhoks të martaneshit.Pas dëbimit të ushtrive serbe nga Dibra ai vazhdoi të shërbente në ushtrinë kombëtare në Shkodër e Krujë.Edhe kundër nazifashizmit Jashar Zeneli u përfshi gjallërisht në luftë dhe dha një kontribut të dorës së parë si në rreshtat e forcave vullnetare që komandoheshin nga Aqif Lleshi ashtu dhe më pas në ngritjen dhe konsolidimin e këshillave nacional clirimtar në Grykën e Vogël.Pas clirimit, ku plagët e luftës vazhdonin të rridhnin gjak, ai shërbeu komandant zone me qendër në Homesh. Në vitet 50 kaloi në jetën private dhe në vitin 1952 ndërroi jetë i bindur se i kishte shërbyer ceshtjes kombëtare me denjitetet e përkushtim atdhetar.Zabiti thoteë se në ceremoninë mortore morën pjesë nga ana e anës dhe se për në banesën e fundit u përcoll me flamur kombëtar, me atë flamur për të cilën ai luftoi gjithë jetën.

Jashar Zeneli njohu e bashkëpunoi me shume personalitete të qënjes kombëtare shqiptare si : Shyqyri Iljaz Pashë Qoku, Qamil Daci, Azis Mezelxhiu, Dan Cami, Ismail Strazimiri, Riza Rusi, Kadri Fishti, Mersim Dema, Elez Isufi, Ramis Daci e Ramis Dibra, Ahmet Zogun, Halit e Aqif Lleshi, Sheh Sulën e Zerqani, Jashar Erebarën, Lim Petrelen e Tiranës, Aqif Pashë Elbasanin, Dine Hoxhën etj.Ai njohu dhe hoqi pushtetin e gjat turk, serb, bullgar, austrohungarez, Italian e gjerman.Dhe në të gjithë këta pushtues ai dijti ta rrokte mirë situatën duke qendruar vertikalisht në shërbim të atdheut, të Dibrës, të Bllas së tij.

Monografia ‘”Jashar Zeneli” e studiuesit Zabit Lleshi ka vlera njohëse dhe edukuese, prandaj dhe për këtë është i dobishëm botimi.Estetikisht libri është i arrirë.Një punë të mirë duket se kanë bërë Bujar Karoshi dhe Miranda Goleci, por dhe mbështetësi i botimit, kush do qoftë, meritojnë vlerësim. Jashar Zeneli e meritonte një monografi dhe autori ia ka arrirë.

Ftesë për bashkëpunim

Gazeta “Rruga e Arbërit” në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për vitin e ardhshëm disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojmë individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion mund të shkruani në emailmbbotime@gmail.com, rrugaearberit@gmail.com ose mund të telefononi në numrin 069 20 68 603.

arkeologji



Vrojtime arkeologjike në zonën e Lurës

Në skajin veriperëndimor të krahinës së Dibrës, si një kështjellë natyrore, ngrihet Lura e bukur, e rrethuar nga Runja hijerëndë, Kunora e veshur me pishat qiellgërvishtëse dhe liqenet e magjishëm. Bukuritë natyrore të saj pasurohen edhe me vlerat arkeologjike që ajo ruan në gjirin e saj, dhe që unë ju ftoj t'i vizitojmë së bashku.

Nga **Prof. dr. ADEM BUNGURI**

Zona e Lurës shtrihet në pjesën më veriperëndimore të krahinës së Dibrës. Ajo përfaqëson një zonë me reliev tërësisht malor, me disa lugina akullnajore, me shumë kullota alpine dhe pak toka bujqësore. Lumi i vetëm që e përshkon atë është ai i Mallës me gjatësi mbi 18 km, afluent i majtë i Drinit të Zi. Kufijtë e saj natyrorë shënohen nga qafa e Mërkurthit, maja e Gurit të Kuq dhe kurrizi i malit të Zebës në perëndim, që e ndajnë atë me Mirditën, nga lumi i Mallës në veriperëndim që e ndan atë me zonën e Kukësit (fshatrat Arëza, Nome dhe Arrni), nga qafa e Pratit në lindje që e ndan me Çidhnën (Mustafaj) e Zall-Dardhën dhe kanioni i Gjalicave të Lurës në juglindje, shtegu që e lidh atë me Çidhnën e Poshtme. Masivi malor i Lurës përbëhet nga male të rinj me lartësi mbi 2000 m. Në qendër të këtij blloku gjenden Kunora dhe Nezhda e Lurës, ku gjendet një grup prej 9 liqenesh të bukur glacialë. Në juglindje si pararojë ngrihet Runja e Lurës, e cila me shpatet e saj të zhveshura bën kontrast me malet plot pisha të Kunorës së Lurës më në perëndim, në verilindje mali i Ndërshenës, që e ndan atë me Reçin, dhe në veriperëndim Zeba, që e ndan me luginën e Fanit.

Në pikpamje gjeologjike Lura dhe i gjithë vargu i maleve perëndimore të luginës së Drinit të Zi, përfshihet në zonën gjeologjike të Mirditës. Ajo është e ndërtuar nga shkëmbinj sedimentarë e magmatikë me prejardhje vullkanike (diabazë). Shkëmbinjtë paraqiten të rudhosur e të ndërprerë nga futjet e magmës ultrabazike, bazike e mesataroacide gjatë Jurës, që kanë formuar shkëmbinj të shumtë magmatikë intruziv. Relievi i sotëm i Lurës është formuar gjatë kenozoit (terciar), kur ka qenë i mbuluar nga akullnajat, kështu që forma përfundimmtare është fituar gjatë kuaternarit, përkatësisht në pleistocen. Karaktersitikë themelore e kësaj zone është relievi i theksuar malor dhe veshja e tij sipas zonalitetit vertikal me vegjetacion të zhvilluar pishe, bredhi si dhe kullotash alpine. Në këtë zonë gjenden malet e Dejës, të Nezhdës dhe të Kunorës së Lurës, dhe në këtë të fundit 9 liqenet e bukur glacialë, të vendosur pranë e pranë njeri tjetrit, prej të cilëve më i bukuri është liqeni i luleve. Kjo zonë dallohet gjithashtu edhe për ruajtjen e dy luginave glaciale në formë govate, nga më të bukurat në Shqipëri, lugina e Lurës në perëndim dhe ajo e Lan-Lurës në lindje. Ato janë të vendosura në një aks lindje-perëndim, por në trajtë të shkallëzuar, me një disnivel kuotash prej 0.50-0.60m. Lugina akullnajore e Lurës gjendet në lartësinë 1050 m mbi nivelin e detit. Ajo ka trajtën e një govate me gjatësi 10 -15 km dhe gjërësi 3-5 km, me drejtim lindje-perëndim. Në fshatin Fushë-Lurë luginës i bashkohet një degëzim jugor i saj, i cili zgjatet drejt fshatit Borie-Lurë dhe vazhdon deri në qafën e Bulshe në kufi me Gurë-Lurën. Në faqet e kësaj lugine të rallë për nga bukuria natyrore, të bien në sy veç të tjerash morrenat e gurëve të zbritura bashkë me akullnajat gjatë pleistocenit.. Kjo është një tregues se pikërisht tek ato morrena mund të gjenden të fosilizuara gjurmët e jetës paleolitike, të faunës, florës apo të veprimtarisë së njeriut paleolitik, por për këtë nuk janë kryer studime të specializuara.

Lugina akullnajore e Lan-Lurës shrtrihet në kufijtë më lindor të zonë së Lurës. Ajo ka gjithashtu formë govate dhe ka orientim lindje-perëndim. Kjo luginë me gjatësi 3-4 km dhe gjërësi 1.5-2 km, dhe lartësi mbidetare rreth 1100 m, është më e hershme se ajo e vetë Lurës. Në anën veriore, ajo vazhdon në trajtën e një degëzimi të ngushtë drejt Tytyrës dhe Ndërshenës, drejtim nga kanë rrjedhur një pjesë e akullnajave gjatë pleistocenit.

Në skajin veriperëndimor të krahinës së Dibrës, si një kështjellë natyrore, ngrihet Lura e bukur, e rrethuar nga Runja hijerëndë, Kunora e veshur me pishat qiellgërvishtëse dhe liqenet e magjishëm. Bukuritë natyrore të saj pasurohen edhe me vlerat arkeologjike që ajo ruan në gjirin e saj, dhe që unë ju ftoj t'i vizitojmë së bashku.

Në tradicionin etnologjik të krahinës së Dibrës, zona e Lurës, përfaqëson një bajrak më vete dhe, megjithë karakterin malor të terrenit, nuk përfshihet në definicionin "Malësi". Ajo përbëhet nga 9 fshatra, të emërtuara si më poshtë: ***Fushë-Lurë, Lurë e Vjetër, Krej-Lurë, Vlashaj-Lurë, Arrë-Mallë, Pregjë-Lurë, Borie-Lurë, Arthi dhe Gur-Lurë.***

Deri në mesin e shek. XX, Lura kishte një administratë autonome, që qeverisej nga instuticioni i pleqve dhe paria e vendit, sipas ligjit të maleve, që njihej me emrin ***" Kanuni i Skënderbeut*** "ose ***"Kararet e Dheut" (Lurë)***. Bajraktari njihej si komandant i forcave të armatosura të bajrakut të tij, ndërsa plaku ishte gjyqtar i vendit, dhe merrej me zgjidhje konfliktesh, pajtime gjaqesh dhe lidhje bese (itifaqe). Ky organizim politik, ruan elementë të jetës politike të qytetërimit antik ilir.

Në pikpamje arkeologjike Lura është shumë pak e njohur jo vetëm nga opinioni publik. Vetëm një ekspeditë përnjohëse e kryer në vitin 1969 nga D. Komata[1], është shumë pak për të. Në fundin e viteve '70 të shekullit të kaluar, mjeku pasionant nga Durrësi, dr. S. Prifti, përveç detyrës së tij, u muar edhe me gjurmime arkeologjike, në zonën e Lurës e të Reçit. Rezultati më i rëndësishëm i punës së tij, është padyshim, zbulimi i guvës së Kojzakut (Gjur-Reç), me motive të skalitura në shkëmb[2] Gjithashtu mjaft intrigues ishte njoftimi i tij mbi zbulimin në qytetin e Livadhit të Xharit të një pllake guri me mbishkrim etrusk[3], gjë që solli në Lurë për verifikim informacioni arkeologët nga Tirana S. Anamali dhe H. Spahiu[4]. Kontribut të veçantë për arkeologjinë e kësaj zone ka dhënë arkeologu dibran I. Kaca[5]. Gjithashtu janë realizuar 3 survej arkeologjikë nga autori i këtij shkrimi.

Në gushtin e vitit të largët 1976, kur sapo kisha mbaruar studimet e larta për historigjeografi, fillova vitin e stazhit si mësues në shkollën 8 vjeçare Arrë-Mallë, dhe pas 3 vjetësh, si drejtor në shkollën 8 vjeçare Gur-Lurë, prej ku në nëntor 1981 u transeforova në Qendrën e Kërkimeve Arkeologjike (sot Instituti i Arkeologjisë Tiranë), ku punoj aktualisht. Megjithëse emërimi im atëkohë në njerin nga skajet më të largëta dhe të vështira të Dibrës, nuk ishte në përputhje me rezultatet e shkëlqyera të studimeve universitare, unë e prita mirë atë, duke mbajtur parasysh se në shkollat ku punova kishte edhe mësues të ardhur nga Saranda dhe Gjirokastra. Megjithë vështërsitë e mëdha të rrugës, të cilën njëherë në muaj e bënim kryesisht në këmbë dhe shumë rrallë pjesërisht me maqinë (rreth 60km), atje njoha njerëz fisnik dhe të dashur, dhe në mënyrë të veçantë, nxënësit e mi të vegjël, shumë të zgjuar dhe të dashur, tani burra dhe gra, miqësinë me të cilët e ruajmë si vlerë të çmuar edhe sot. Vitin e parë pasi fillova punë në arkeologji, u ktheva në Lurë në një survej sipërfaqësor (1983), i cili do të pasohej edhe nga dy survej të tjerë në vitet e mëvonshëm (1988 dhe 2011). Shkoja në Lurë jo vetëm për nostalgjinë e kujtimeve të mira të atyre viteve, por edhe me dëshirën për të evidentuar vlerat arkeologjike të saj, dhe për t'i vënë ato në shërbim të turizmit kulturor, si një mundësi për t'i kthyer në këtë mënyrë, qoftë dhe një pjesë të vogël të detyrimit që ndjeja për atë zonë dhe njerëzit e saj.

Sipas kronologjisë, po shënojmë disa nga qendrat arkeologjike të Lurës:

I. PERIUDHA E BRONZIT TË VONË (1500-1100 PARA KR.)

1. Qyteza e Lurës

Kjo kala ndodhet në krahun e djathtë të rrugës automobilistike, që të çon në Fushë- Lurë, poshtë majës së Bakullimës. Ajo është vendosur mbi një kreshtë shkëmbore me prerje eliptike, të njohur me emrin "gjytet", në një pozicion mjaft strategjik dhe dominant, në lartësinë mbidetare 1271 m. Nga sipërfaqja e saj, mund të kontrollohen lëvizjet në të gjithë luginën e bukur glaciale të Lurës, që nga qafa e Lan-Lurës në lindje, deri në Krej-Lurë dhe qafën e Mërkurthit në perëndim, që nga Borie-Lura dhe qafa e Bulshe në jug, deri në qafën e qytetit në veri nga kalon rruga për fshatrat Pregjë dhe Arrën-Mallë. Kreshta ku ngrihet kalaja, bie me shpate të pjerrta në të gjitha anët, veç anës verilindore, ku kjo pjerrësi zbutet mjaft dhe me anë të një qafe të lehtë, lidhet me ambientin rrethues. Pikërisht në këtë anë, hapet një luginë e butë dhe e mbrojtur nga erërat, mjaft e përshtatshme për banim, ku mund të sondohet në një gërmim të mundshëm. Kalaja ka qenë e forifikuar me mure, që ruhen në gjendje mjaft të rrënuar, në trajtë ledhesh. Pjesa më e lartë e kreshtës, me formë eliptike dhe diametra 58m dhe 25m, dhe sipërfaqe 1165m^2 luan rolin e "akropolit". Ajo ruan gjurmë murresh të nëdrtuar me gurë të hedhur në trajtë ledhesh në anën veriore dhee atë lindore të saj. Muri ka qenë ndërtuar me teknikën karakteristike të periudhës së hekurit, prej gurësh mesatar e të vegjël, të lidhur në të thatë.

Qyteza ruan edhe një linjë të dytë fortifikimi, të ndërtuar me të njëjtën teeknikë si edhe ato të "akropolit": ledhe gurësh mesatarë e të mëdhenj, të lidhur në të thatë. Kjo linjë muri mund të ndiqet vetëm në anën jugore të kreshtës, 20-25m nën izoipsin e "akropolit", i cili ka shfrytëzuar vetitë mbrojtëse të terrenit. Kështu në anën jugperëndimore dhe juglindore të kalasë, aty ku terreni është i thiktë dhe me mbrojtje natyrore, në një distancë 20-25 m, nuk ka asnjë gjurmë fortifikimi. Linja e murit me gjatësi të ruajtur 72.50m krijon një planimetri eliptike, pa kënde e kthesa, me perimetër 228 m. Gjendja mjaft e rrënuar e murit, nuk lejon dallimin e strukturës së tij dhe elementëve më të qartë teknik, megjithatë, mendojmë se fortifikimi i përket periudhës së vonë të bronzit dhe fillimit të periudhës së hershme të hekurit. Për këtë mendim na vijnë në ndihmë të dhëna të tjera, si pozicioni topografik i kalasë, planimetria eliptike e mureve të saj, si dhe një buzë ene, shumë e konsumuar dhe e porozuar, me ngjyrë kafe të hapur dhe fakturë të qartë të periudhës së hekurit.

2. Kalaja e Çezës

Kjo kala gjendet në rrethinën lindore të fshatit Ndërshenë (toponim i formuar me lëndë vendi : ndër shehër = nën qytet), në krahun e djathtë të rrugës natyrore që lidh zonën e Lurës me atë të Reçit, ose e shprehur me terma më arkeologjikë, midis kalasë së Tytyrës (Lurë) në jug dhe asaj të Qimekeqit në lindje (Fusha e Bujanit-Reç), të njohur nga banorët me emrin " Kapra ". Për lexuesin e kultivuar, nuk është e vështirë që të bëjë përqasjen fonetike të Tytyrës dhe të Kaprave, me dy kala të njohura si të rindërtuara nga Justiniani në provincën e Epirit të Ri, dhe përkatësisht me fortesat *Tythyra* dhe *Kapaza*, dhe të pranojë pa dyshime lokalizimin e tyre, sipas këtij barazimi topik[6].

Kalaja gjendet në lartësinë mbidetare mbi 1000 m, në një ambient baritor, e rethuar me kullota e livadhe të shumtë, të veshur aty këtu me ahishte.

(Vijon numrin e ardhshëm)

[1] KOMATA 1970.
[2] PRIFTI 1981, 55-56.
[3] Idem, 56.
[4] ANAMALI –SPAHIU 1977, nr. 3698.
[5] KACA 1981, 74-77; KACA 2012, 75-76, 251-252.
[6] Proc.Caes, De Aedificis, IV, 4, f.440. Përveç barazisë fonetike, të dy kalatë ruajnë rrënoja të mureve të lidhura me llaç gëlqeror.Material të imtë arkeologjik nuk kemi gjetur, por ai duket se është shpëlarë nga errozioni.

Rruga e Arbërit nr. 110

recensë

Libri më i ri i Zyber Gjonit, që mban titullin "Çidhnakë në shekuj", është një kontribut për historinë e Dibrës, mbasi ai, ndonëse kalimthi, prek disa nga figurat më në zë të popullit të kësaj krahine, duke i dhënë mundësi çdo lexuesi, hulumtuesi, studiuesi, që të informohet ose të gjejë lëndën e nevojshme për ndonjë trajtim më të ri ose më të thelluar

"Çidhnakët në shekuj", një libër me vlerë për historinë e krahinës së Çidhnës



Nga **XHAFER MARTINI**

Libri më i ri i Zyber Gjonit, që mban titullin "Çidhnakë në shekuj", është një kontribut për historinë e Dibrës, mbasi ai, ndonëse kalimthi, prek disa nga figurat më në zë të popullit të kësaj krahine, duke i dhënë mundësi çdo lexuesi, hulumtuesi, studiuesi, që të informohet ose të gjejë lëndën e nevojshme për ndonjë trajtim më të ri ose më të thelluar. Kur një libër i kësaj natyre e jep këtë kontribut, ai në tërësinë e tij quhet libër i mirë, aq shumë i nevojshëm për të gjitha shtresat e shoqërisë. Nëse do të bëjmë ndonjë vërejtje ose sugjerim, këtë e bëjmë për një libër të mirë, e bëjmë edhe për ta ndihmuar sado pak autorin mbasi ai, siç thuhet në libër, do të botojë edhe vëllime të tjera me çidhnakët më të shquar.

Figurat për të cilat ka shkruar Zyberi në këtë vëllim, nuk janë të barazvlefshme në asnjë drejtim. Disa kanë kontribut më të madh, disa më të vogël, për disa është shkruar shumë, për disa vetëm sa u është përmendur emri. Këto të fundit janë figura të dorës së dytë që për herë të parë marrin formë të përshtatshme për t'u shijuar dhe për të mësuar rreth tyre më shumë.

Për zgjedhjen e figurave të këtij vëllimi të parë sigurisht Zyber Gjoni ka pasur parasysh disa kritere. Të gjitha këto figura kanë një gjë të përbashkët. Ky është kontributi atdhetar.Natyrisht, kontributi i tyre nuk është i njejtë, por këndi i shikimit i tillë është, një kënd shumë i njohur nga i kemi vështruar kontributet njerëzore gjatë gjithë shekullit që kaloi, pa marrë parasysh se fushat e veprimtarive ku njeriu mud të japë ndihmesën e tij në të mirë të njerëzimit, janë shumë më të gjëra. Në këtë libër figura e Hoxhë Gjonit mund të dilte nga kjo kornizë dhe mund të trajtohej me një individualitet më të spikatur. Me aq pak radhë sa është shkruar për të, del që Hoxha ka qenë njeri i shkolluar. Figurën e tij e kanë dëmtuar frazat hipotetike si kjo: "Thuhet se ai u diktua në një spital të Irakut gjatë mobilizimit (ç'është kjo fjalë këtu?-Xh) të fraktuarave një të dëmtuari, që do të thotë se Hoxha ose kishte hapur një klinikë private ose ishte punësuar aty" (f. 122) Në histori nuk mund të nxjerrim përfundime duke përdorur fjalët: thuhet, duhet, mundet, flitet...Por, sidoqoftë, kishte vend për të ndriçuar botëkuptimit të tij, për të vënë në dukje idetë filozofike etj.

Siç ishte e natyrshme, libri fillon me një kapitull për Çidhnën dhe me përpjekjen për të treguar edhe prejardhjen e këtij emri. Lokalizimi i fshatit të vogël të dikurshëm Oenea për të ardhur tek Çidhna e sotme na duket me vend dhe me interes. Një numër studiuesish, thotë autori, e shikojnë Oenenë, ashtu siç e shikon Kristo Frashëri, në Çidhën. Këtu, thotë autori, e shikojnë Oenenë edhe studiues të tjerë dhe historianë amatorë.

Natyrisht që figurat historike të Çidhnës do të kishin në krye Gjergj Kastriotin, Skënderbeun, të cilin autori edhe e trajton, por ai ka shkuar më tej në shekuj dhe ne marrm informacion edhe për dy figura të tjera, njera fare pak e njohur, Gjergj Kastrioti i Parë dhe për Gjon Kastriotin, të atin e Skënderbeut. Janë trajtuar mirë, me masë, me informacionin e nevojshëm dhe për këtë arsye kanë vendin e vet në libër.Sidomos kjo duhet thënë për Gjergj Kastriotin e Parë.

Figura e Skënderbeut u prin pastaj gjithë figurave të tjera. Përmenden me radhë betejat që ka zhvilluar Skënderbeu në truallin e Dibrës. Këto pothuaj janë në çdo libër që është shkruar për historinë e kësaj treve. Bëhen përpjekje të mira për lokalizimin e vendit ku u bë beteja e Torviollit dhe Beteja e Otonetës. Mund të kemi dyshimet tona, por rruga e ndjekur është për t'u admiruar. Me poshtëshënimet që autori vë, dëshmohet si historian me përvojë dhe me bagazh në këtë fushë. Fraza trajtuese është në përshtatshmëri me stilin shkencor, sadoqë i thatë dhe uniform. Brenda këtij stili duhet të ketë gjallëri dhe zhdërvllejtësi, madje edhe emocion. Nëse një mënyrë të shkruari është e zhveshur totalisht nga këto tregues, nuk ka pse të quhet stil. "Nga të gjitha instrumentet e njeriut, libri është, pa dyshim, më i çuditshmi.Të tjerët janë zgjatime të trupit të tij.Mikroskopi dhe teleskopi janë zgjatime të vështruarit të tij, telefoni zgjatim i zërit.Kemi gjithashtu parmendën dhe shpatën, zgjatime të krahut. Po libri është tjetër gjë:libri është zgjatim i kujtesës dhe i përfytyrimit të njeriut"(Jorge Luis Borges). Borgesi nuk flet thjesht për stilin, por për librin. Pavarësisht nga natyra e tij, libri është edhe "zgjatim i kujtesës dhe përfytyrimit", çka do të thotë shpalojse sa më e bukur dhe e lirë e mendimit.

Për figurën e Skënderbeut mund të shkruhej më shumë. Nuk është fjala për numër faqesh, por për probleme që lidhen me të. Për Skënderbeun nga autorët dibranë është shkruar mjaft. Ndonjëri prej tyre nuk pranon as origjinën dibrane të Skënderbeut, por thotë që Kastriotët janë nga Kosova. Por këtë le ta quajmë një mendim të skajshëm, megjithëse edhe me të mund të hysh në polemikë. Kryesorja qëndron në faktin që gjatë këtij çerekshekulli, për Skënderbeun kanë lindur shumë pyetje: A ishte ai Atlet i Krishtërmit, apo luftëtar dhe udhëheqës i popullit të vet? Çfarë karakteri kishin luftërat e Skënderbeut kundër turqve- karakter çlirimtar apo për të sunduar? Si i kishte Skënderbeu marrëdhëniet me disa vende Perëndimore? Për çfarë qëllimi e ndihmonin ato? A ka një mitologji rreth figurës së Skënderbeut dhe sa e dëmton ajo figurën e tij? Si kanë qenë marrëdhëniet e Skënderbeut me sllavët? Ka edhe plot pyetje të tjera një pjesë e të cilave burojnë edhe nga trajtimi që i bën Schmitt-i figurës së tij, një trajtim shumë denigrues. Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve me themel duhet të shkruhej një libër i veçantë, por të mos cekësh asgjë nga sa thamë dhe të mjaftohesh me një informim të thatë dhe të njohur, është e pamjaftueshme. Kur bën një libër të tillë si Zyberi duhet të kesh parasysh edhe raportin midis figurave, vendin që ato zënë në libër. Në një libër për burrat e shquar të Çidhnës, Skënderbeu duhet të ketë vendin e vet edhe si numër faqesh. Në librin e Zyberit Skënderbeu pothuaj zë më pak vend në krahasim me disa figura të tjera.

Në libër, veç atyre që përmendëm, trajtohen figura, si: Gjon Çidhna (Noka), Demir Lusha, Vesel Stafë Lusha, Sali Noka, Salë Demir Alia, Hasan Shini, Çup Bitri, Hoxhë Gjoni, Llan Kaloshi, Dali Mud Xhika, Selman Alia, Halil Kaloshi, Riza Vesel Lusha, Shaban Lusha, Osman Paci, Murat Kaloshi dhe Hoxhë Kuta.

Për mendimn tim, libri duhet të kishte një strukturë tjetër më të përshtatshme për t'u shërbyer figurave. Ato janë renditur në libër pa ndonjë kriter. Kështu, të paktën, më duket mua. Si e mendoj strukturën e librit? Në libër ka shumë Kaloshë (Llan Kaloshi, Halil Kaloshi, Murat Kaloshi); ka shumë Lushe (Demir Lusha, Vesel Stafë Lusha, Riza Vesel Lusha, Shaban Lusha); ka dy Nokë (Jovan Noka, Sali Noka); ka dy Alie (Salë Demir Alia dhe Selman Alia); ka dy hoxhallarë (Hoxhë Kuta dhe Hoxhë Gjoni); figura të shkëputura ka pak. Këto figura duheshin trajtuar si Dyer të Mëdha, si Dera e Kaloshit, Dera e Alisë, Dera e Lushës etj. Lexuesi kishte nevojë për një informacion më të plotë, më të thelluar. Patjetër që duhej të mësonte prej këtij libri për origjinën e këtyre atdhetarëve, jo thjesht për veprimtarinë individuale, por si shtresë shoqërore. Po bëhem më i qartë: cila është prejardhja e kësaj shtrese të parisë dibrane? Si është formuar ajo? A është shtresë nga paria e lashtë, apo është pari e re, e krijuar nga sunduesit osmanë? Kujt i ka shërbyer kjo pari? Këto pyetje kanë arsye të bëhen mbasi na imponohen nga historia.

Që kjo nuk është pari e lashtësisë, nuk e vështrirë për ta kuptuar. Kjo është pari shumë e vonë, e kohës së pushtimit osman. Paria e lashtësisë është para kohës së Skënderbeut. Madje më e hershme. Ishte kohë luftërash të përgjakshme, "...kur romakët, venedikasit, normanët, anzhutë kërkojnë "kapërcimin e detit" me synimin Konstadinopojën. Bizantët, bullgarët, serbët e së fundi, osmanët, lakmojnë daljen në Adriatik. Në një truall të tillë formohen dhe konsolidohen familjet e bujarëve arbër: Engjëllorët, Topiajt, Dukagjinët, Arianitët, Blinishtajt, Zenevisët, Gropajt, Balshajt, Spata, Muzakajt, Komnenët." (Aurel Plasari: "Vija e Teodosit rishfaqet..",Tiranë 1995,f. 20) Kjo ishte paria e Arbërit. Asokohe edhe ne kishim kontë e baronë si gjithë Europa. "Deri në fund të periudhës humaniste dhe në prekjen më të hershme të ish-perandorisë osmane, dheu i Arbërit ishte i organizuar me zotërime të ngjashme me ato të Europës. Ky ishte një vend që kishte dukë (si Dukagjini), kontë (si kont Urani), kapitenë, si "capitaneus montanae Hottorum", që përmendet nga M. pl. Sufflay në veprën e tij "Serbët e shqiptarët." (Sh. Sinani: "Epos në etnos",Tiranë 2011, f. 165) Mbas vdekjes së Skënderbeut, për të mos jetuar në robëri, kjo pari ikën në Europën Perëndimore, kryesisht në Itali.

Turqia donte të ngrinte një pari të re, të përshtatshme që ta qeveriste popullin me anë të saj. Prandaj ajo i shtoi gradat dhe ofiqet për njerëz të aftë dhe që tregoheshin të gatshëm për t`i shërbyer. Turqia në fakt e krijoi këtë pari në Shqipëri. Edhe paria e Dibrës është e kohës së Turqisë dhe e krijuar prej saj. Por do të ishim dogmatikë sikur, duke u nisur nga ky fakt, ta konsideronim këtë pari këmbë e kokë në shërbim të Turqisë. Edhe pse e krijuar prej saj, ajo nuk iu bind deri në fund sulltanëve. Me të drejtë është thënë "...sulltanët osmanë shpresuan se do të krijonin në Shqipëri një bazë shoqërore e politike besnike ndaj sulltanit. Shumë shpejt doli që as feja e përbashkët, as interesi i përbashkët me feudalët shqiptarë, nuk mund të ishin baza të sigurta politike për një sundim të qetë të Perandorisë Osmane në Shqipëri." (K.Frashëri: "Identiteti Kombëtar...", Tiranë 2006, f. 123) Me kalimin e kohës, "sa më tepër forcohej klasa feudale shqiptare, madje sa më tepër ajo ngrihej në shkallën e aristokracisë feudale, aq më tepër zhvillohej prirja e saj për t`u lehtësuar nga varësia prej Portës së Lartë". (Frashëri 2006:124)

Megjithatë, paria e kësaj kohe është duar-duar: një pjesë karakterizohej vetëm nga interesat personale, kurse një pjesë edhe nga interesat kombëtare. Prej një qëndrimi të tillë kjo pari "ka anën e vet të errët dhe të ndritur: në një brez ka arritur të bëjë shumë për vendin e në një brez tjetër ka dështuar ose i ka bërë të zezën atdheut". (Sh. Sinani: Pasthënie për librin e I. Strazimirit: "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", Tiranë 2011)

Qeveria turke e krijoi parinë se i duhej për të qeverisur vendin. Ajo e njihte popullin kryengritës dhe kokëlart shqiptar. Ai nuk nënshtrohej veçse duke ia gjetur mënyrën për ta nënshtruar. Kjo ishte ruajtja ose krijimi i një tradicionalizmi të ri, kur populli të udhëhiqej nga krerët e tij tradicionalë, në bazë të kanunit, ligjit të tij të pashkruar, por që kishte dëshmuar efikasitetin e tij. Turqia ia la popullit tonë edhe Kanunin, nuk ndërhyri në punët dhe zgjidhjet e tij. Në Dibër u krijuan të ashtuquajturit Oxhaqe, me kuptimin e shtëpive të para që e kishin tagrin për të udhëhequr dhe qeverisur të tjerët. Përveç Oxhaqeve në Dibër kishte edhe krerë të tjerë parie. Organizimi i saj tradicional ishin Nëntë Malet e Dibrës, me kuptimin jo të malit fizik, por të një njësie administrative, vetëqeverisëse. Në Dibër me ndikim të madh në jetën shpirtërore të popullit ishin edhe Shtatë Teqet.

Në Dibër kishte edhe një lloj tjetër parie, që nuk kishte pasur asnjë lloj lidhjeje me Turqinë, madje kishte luftuar historikisht kundër saj. Këta ishin kapedanët popullorë, luftëtarët, që ishin dalluar në udhëheqje të kryengritjeve popullore kundër pushtuesve të ndryshëm. Unë kam mendimin që në këtë lloj parie hyjnë Kaloshët. Zyber Gjoni meqë kishte marrë përsipër ta bëjë një studim të tillë, ishte e nevojshme t'i trajtonte këto probleme. Mënyra e trajtimit varej nga ai. Mund që këto probleme të trajtoheshin me pak faqe, por edhe me një hyrje pak a shumë të gjatë dhe serioze, ku, në mos të gjitha pyetjet që shtruam, një pjesë e tyre të merrnin përgjigjie. Po të veprohej kështu, figurat do të ishin me bazament, veprimet e qëllimet e tyre do të kuptoheshin më mirë, dhe lexuesi do të krijonte vërtet një përfytyrim të qartë për parinë e Çidhnës dhe, për parinë e Dibrës në përgjithësi, se rruga e saj e formimit është pak a shumë e njejtë.

Nuk dua t'i japë askujt mësime, por, meqë erdhi rasti, dua ta them mendimin tim për parinë shqiptare. Unë nuk jam për atë që kjo pari duhet hyjnizuar dhe absolutizuar, por as të hidhet poshtë dhe të anatemohet. Vështrimi bardhë e zi është kurdoherë i dëmshëm. Si të karakterizohej paria në tërësi, dilnin në pah edhe veçoritë individuale të secilit prej tyre, se ata edhe si njerëz, por edhe si veprimtari atdhetare, nuk kanë qenë të gjithë njëlloj.

(Vijon numrin e ardhshëm)

KËTU MUND TË ISHTE
REKLAMA JUAJ
PËR VETËM 1000
LEKË BARDH E ZI
DHE 2000 LEKË
ME NGJYRA
Porosite tani: 069 20 68 603

vështrime

E gjithë jeta dhe vepra e Haki Stërmillit në shërbim të Atdheut e Kombit shqiptar

Nga **BEQIR AJET SHEHU**

Haki Stërmilli, kur viheshin në rrezik interesat e atdheut e kombit , për të cilat kishte luftuar gjithë jetën,me gjithë kundërshtitë që kishte me mbretin Zog dhe persekutimin që ai i kishte bërë, nuk do t'ia lejonte vetes kurrë që veprimtaria e tij të cënonte interesat madhore të kombit.



Haki Stërmilli në rininë e tij

Në historinë e letërsisë shqiptare, Haki Stërmilli përfaqson shkrimtarin demokrat, jeta dhe veprimtaria e të cilit u lidh ngushtë me fatet e atdheut dhe të luftës së forcave partiotike e revolucionare për një Shqipëri të lirë; të bashkuar dhe të përparuar. Haki Stërmillit përjetoi pasojat e ngjarjeve më dramatike në historinë e popullit shqiptar, e në veçanti të Dibrës,vendlindjes së tij, e që në momente të veçanta, i'u vu në pikpyetje edhe mbijetesa; Por këto vite qenë edhe vitet e qëndresës së pashembullt të luftës heroike të popullit shqiptar për ruajtjen nga coptimi të trojeve shqiptare, si dhe për ruajtjen e identitetit kombëtar, e çlirimit te vëndit. Traditat patriotike dhe jeta e pasur zakonore në vendlindjen e tij,atmosfera që krijuan në Dibër zhvillimet e vrullshme të lëvizjes patriotike të atdhetarve të shquar dibranë; Hoxh Voka, Dervish Hima, Josif Bageri e të tjerë, si dhe rënija e Dibrës nën robërinë e pushtuesve sërbë dhe pasojat e tmerrshme që i sollën vendit, masakrat me egërsi shtazore të kryeera mbi popullsinë e pafajshme, qenë atmosfera ku i riu Haki Stërmilli u rrit, u shkollua dhe u formua për të marrë përsipër detyrën e vështirë të dalzotësit ndaj vendit e njerëzve të tij. Sapo mbaroi gjimnazin në Manastir ku ishte derguar me ndihmën e interesimin e patriotit Dervish Hima, bëhet një prej drejtuesve kryesorë të shoqërisë "Djelmënia Dibrane" ku zhvilloi një veprimtari të guximshme patriotike mes vëllezërve të vendlindjes. Pas Kongresit të Lushnjes Haki Stërmilli vendoset në Tiranë, në administratën e shtetit të ri dhe merr anën e lëvizjes rinore përparimtare në luftën e ashpër mes forcave politike që zhvillohej në atë kohë. Haki Stërmilli, u bë një nga militantët më të shquar të lëvizjes demokratike të rinisë dhe si drejtues i shoqërisë "Bashkimi"mori pjesë me armë në dorë në ngjarjet e Revolucionit të Qershorit 1924, që synonte të sillte në fuqi një qeveri demokratike. Pas rënies së qeverisë Fan Nolit, Haki Stërmilli, si shumë patriotë demokratë, u detyrua të emigronte në disa shtete të Europës dhe duke qenë edhe anëtar i "KONARE-së"nuk e ndërpreu asnjëherë veprimtarinë e tij patriotike revolucionare në interes të atdheut u kombit.. Në vitin 1929, me ndërhyrjen e Ahmet Zogut, qeveria Jugosllave ktheu në Tiranë Haki Stërmillin dhe e burgosi duke mos marrë në konsideratë as protestën e "KONARE-s" të nënshkruar edhe nga personalitete; si shkrimtari Henri Barbys, fizikanti Ajnshtajn , Sen Katajama e shumë deputet e profesor nga katër anët e botës. Pushtimin fashist të vendit , të cilin e kishte parashikuar në një artikull të botuar në gazetën "Liria Kombëtare" e priti me shumë trishtim."Okupacioni fashist , shkruan ai më egërsoi tepër ....Deri në Konferencën e Pezës punova ashtu si ma muer mendja se mund t'i shërbejsha popullit e atdheut.Mbas Konferencës u rrjeshtova në Kampin e Frontit Nacional Çlirimtar". Dhe ashtu veproi : Megjithëse e kishte kaluar moshën e veprimeve të guximshme, në verën e vitit 1943 u hodh në radhët e luftës partizane duke perballuar vështirësi, rreziqe e beteja deri në ditën e çlirimit të vendit. Dhe ja ç'farë shkruan në ditarin e tij më 28 nëndor 1944 luftëtari i shquar, shkrimtari demokrat, Haki Stërmilli: "Në këtë ditë feste, dy herë historike, sytë e zemrave të popullit tonë drejtohen kah vorret e mija dëshmorve që siguruen fitoren,dhe me gjakun e tyre të pastër shkruen nji epope të madhnueshme", dhe pasi përshkruan aktivitetet e zhvilluara të kësaj, dy herë historike, duke filluar që nga ora 10e30, me daljen e Komandantit Enver Hoxha me Qeverinë demokratike, ku nga tribuna e ngritur para Hotel Dajtit, përshëndeti parakalimin e 15 mijë djem e vajza të brigadave partizane". Ditarin e kësaj dite feste, dy herë historike, e përfundon me fjalinë."Festa vazhdon"! . Citova fletë ditarin e kësaj dite dy herë historike pasqyruar në "Ditarin Partizan" të Haki Stërmillit, për dy arsye. Së pari se e gjithë veprimtaria e tij, si shkrimtar dhe si luftëtar me armë në dorë, lidhet me këto dy sihariqe që shkruan në fletëditarin e kësaj dite ; Shpalljen e Pavarsisë dhe Çlirimin e vendit nga okupacioni fashist.. Së dyti Kremtimi i 28 nëntorit 1944, si "ditë dy herë historike",Dita e shpalljes Pavarsisë dhe Dita e çlirimit vendit nga okupacioni fashist, të pasqyruara në këtë fletë ditari, nga historjani dhe shkrimtari Haki Stërmilli është një dekument i vërtetë shkencor për histori shkruarjen.

Rruga e jetës së Haki Stërmillit ishte rruga e jetës së një luftëtari të shquar i cili tërë qenjen e tij fizike e shpirtërore, tërë aftësit kulturore e talentin e tij i vuri në shërbim të luftës për çlirimin e vendit ,për ruajtjen e forcimin e identitetit kombëtar, si dhe për demokratizimin dhe prosperitetin e tij.Pjesë e kësaj lufte, madje edhe më e rëndësishmja, që e veçon Haki Stërmillin, si shqiponjën që nuk është bërë për të fluturuar në turmë, eshtë vepra letrare e tij.

Një nder veçoritë më të spikatura në veprën letrare,të cilën edhe unë e kam më për zemër për ta trajtuar është, lëvrimi i temës patriotike. Duke qenë nën përshtypjen e ngjarjeve tragjike me të cilat u perball vendlindja e tij duke i përjetuar ato edhe personalisht, si dhe duke i gërshetuar këto me ngjarje e probleme etike të jetës zakonore, si njohës i thellë i tyre, Haki Stërmilli jo vetëm që na ka dhënë vepra dinjitoze me vlera të veçanta ideo-artistike në forma të ndryshme të gjnive letrare, por na ka lënë edhe një arkiv vlerash me të vërteta historike për njohjen e jetës dhe zhvillimeve të kësaj perjudhe.

Si studjues në fushën e historishkruarjes, në këtë trajtim të shkurtër, dua të veçoj disa nga vlerat e romanit historik "Kalorsi i Skenderbeut", jo vetëm pse është shkruar më pak për të, por më intrigon edhe fakti : Përse, shkrimin e këtij romani e ndërpreu në vitin 1939 dhe e filloi përsëri ta shkruajë në vitin 1952.

Romani " Kalorësi i Skënderbeut" është ndërtuar mbi sfondin e ngjarjeve të verteta historike të viteve 1451- 1456 , ku populli shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut luftonte trimërisht për mbrojtjen e tokave të shtetit shqiptar dhe për çlirimin e viseve të tjera të trojeve arbërore të pushtuara nga turku,siç'ishte edhe Kalaja e Sfedigradit. Duke hyrë në rrjedhën e ngjarjeve të kohës nëpërmjet të dhënave historike dhe traditës popullore, autori i këtij romani ka arritur të na pasqyrojë atmosferën heroike të atyre viteve duke na treguar se ndergjegjësimi patriotik i popullit ishte elementi thelbësor i sjelljes së kësaj atmosfere. Malsorët e thjeshë trima e fisnikë ishin ata që përbënin ushtrinë e Skënderbeut e cila përballon me sukses hordhit osmane. Këta malësor trima janë edhe mbartësit e traditës dhe zakoneve fisnike, pjesë e jetës së tyre të përditshme, që i trasmetuan nga brezi në brez, i aplikojnë në jetën e tyre të përditëshme, dhe i ruajtën me fanatizëm si pasurinë e tyre më të shtrejtë. Protagonistët kryesorë të romanit nuk janë marrë nga figura historike por nga bijtë e popullit pariot.Të tillë janë: Mark Spani(Kalori i Bukur), prortagonisti kryesor i romanit, pjestar i Gardës Pretorjane të Skënderbeut,i cili mishëron veti e vyrtyte të luftëtarëve të kësaj epoke: trim e besnik, kalorës finik, dashnor zemër zjarr e kavalier, luftëtar i devotshëm i kauzës së shejtë të atdheut. Mira Mireshi ,e bija e luftëtarit të paepur të lirisë Zef Mireshit, vajza fytyrë hënë me zemër të bardhë, besnike e dashurisë së pastër e të sinqertë me Kalorsin e Bukur, por edhe luftëtare e pa trembur dhe e vendosur në mbrojtje të lirisë e jetës së kryetrimit,mbretit të shqiptarve Skenderbeut.. Këto figura e të tjera, si ajo e Hil Veshkuqit, e Qerimit dhe motrës së tij e të tjera, të ndërthurura me ngjarje e situata ku pasqyrohet atmosfera patriotike që rrethon popullin e ngritur në luftë ;tregojnë edhe fatin e të rijve dibranë, fati i të cilëve ishte pleksur me fatet e Dibrës dhe të gjithë vendit.

Figurën e Skënderbeut në roman, për mendimin tim, shkrimtari Haki Srërmilli na e ka dhënë mbi modelin e shkrimeve të kryera për profetin Muhamed. Ndonse është një figurë episodike, Ai ndjehet në të gjithë romanin. Shkrimtari nuk e ka trazuar kryezotin me intrigat e aventurat dashurore që ndodhin në trajtesën e romanit. Populli e quan atë diell që ngroh çdo zemër shqiptare Në roman nënvizohet jo vetëm misjoni historik i Skënderbeut në luftë për tu bërë ballë agresorëve, por edhe për të krijuar një shtet të përqëndruar shqiptar.

Në romanin "Kalorsi i Skënderbeut", pasqyrohen edhe tendencat seperatiste të kohës të cilët kanë gjetur shprehje në trajtimin e dy figurave historike të kohës, Moisi Golemi dhe të të shoqes së e tij Princeshë Zafinës. Duke pohuar të vërtetën historike të tradhëtisë e të pendimit të princit të Dibrës Moisi Golemit dhe rolin intrigues të princeshës Zafina në këtë tradhëti, autori jep mesazhin e të paturit kujdes,se shkak i joshjes drejt seperatizmit e tradhëtisë ndaj interesave të atdheut janë po ato element e faktor, që i kanë sjellë zhvillimet historike, që nga agimet e shoqërisë njërzore.

Dua të ndaj me ju, mendimin tim në dhënjen përgjigje të pyetjes, se përse shkrimtari Haki Stërmilli, romanin Kalorsi i Skënderbeut, që kishte nisur ta shkruante në vitet 1937-38, e ndërpreu në vitin 1939 për ta filluar përsëri më vone e për ta përfunduar në vitin 1952.

Haki Stërmilli ishte burrë me vizion të largët politik dhe njohës i shkëlqyer i gjeopolitikës, veçanërisht asaj në Ballkan.Vendimet e padrejta të Fuqive të Mëdha për coptimin e tokave shqiptare, ku përfshihej edhe ndarja e Dibrës në dy pjesë dhe lënia e Dibrës Madhe me trojet tjera shqiptare, jashtë kufirit të shtetit shqiptar, vendosur më 1913, ashtu si të gjithë popullin shqiptar, tronditën pa masë edhe zemrën e shkrimtarit patriot. Pritmëria se me përfundimin e Luftës parë Botërore do të rregullohej kjo padrejtësi, jo vetëm që nuk solli zgjidhje por mbylli dhe shpresat. Kjo bëri që detyrat e shtetit dhe shoqërisë shqiptare të ishin po ato të viteve 1451-1456, me ndryshimin e vetëm, atë të pushtuesit, nga turk në sllav. Ndaj në vitet 1937-38 Haki Stërmilli, filloi të shkruajë romanin historik "Kalorsi i Skënderbeut", shkrimin e të cilit e ndërpreu me fillimin e Luftës Nacional –Çlirimtare. Në ditarin e tij ai shkruan "Mbas Konferencës së Pezës u rrjeshtova në kampin e Frontit Nacional Çlirimtar me besimin se kohët kishin ndyshuar dhe kjo luftë do të çlironte vendin nga fashizmi dhe do të realizohej edhe bashkimi i trojeve shqiptare me shtetin amë". Besimi i tij se do të realizohej kjo zgjidhje shprehet edhe në fletën e ditarit të datës 29 nëntor 1944 ku thot.: "Divizionet tona çliruan Prishtinën dhe po marshojnë drejt Kosovës". Por edhe lufta Nacional- Çlirimtare nuk i realizoi pritmëritë e luftëtarit patriot ashtu si të të gjithë popullit shqiptar, pasi dy të tretat e trojeve shqiptare ku bënte pjesë edhe Dibra e Madhe mbetën pësëri jashtë kufijve të shtetit shqiptar.Kjo ishte dhimbja më e madhe e këtij luftëtari të paepur. Me gjithë këtë dhimbje, me gjithë rëndimin e viteve e lodhjes që i solli lufta tre vjeçare në radhët e ushtrisë Nacional –Çlirimtare, shkrimtari patriot nuk dorëzohet. Ai i rikthehet shkrimit të romanit, e përfundon atë,duke na bërë me dije se detyra nuk kishte mbaruar dhe do të sugjeronte, me gjuhën e Dibrës, edhe rrugët për realizimin e saj ; që do të ishte, në radhë të parë ndërgjegjësimi patriotik i masave popullore, që të vihen në lëvizje për të realizuar bashkimin e trojeve shqiptare.

Nuk ndaj të njëjtin mendim edhe për kritikën që i bëhet veprës së Haki Stërmillit, sidomos asaj të viteve të mbretërisë, ku thuhet se kufizimet botkuptimore nuk e kanë lejuar shkrimtarin që në krijimtarinë e tij të shtrojë nevojën e përmbysjes së rendit shoqëror ekzistues, por kufizohet vetëm në mohimin e disa normave të moralit dhe mentalitetit sundues të kohës. Unë mendoj se nuk janë kufizimet botkuptimore, por vizjoni dhe symprehtësia e shkrimtarit, që i lexonte në thellësi zhvillimet gjeopolitike të kohës, për të mos përdorë "grushtat migjenjan" për rrëzimin e Monarkisë. Shkrimtari patriot e kishte të qartë se në vitet tridhjetë, kur të gjitha shtetet e Ballkanit ishin Monarki dhe kur synimet e tyre grabiqare ishin në rend të ditës, rrëzimi e saj do të ishte një rrezik real për coptimin e plotë të tokave shqiptare. Ai e kishte të qartë gjithashtu, se Monarkia do të ishte një siguri më e madhe për ruajtjen e pavarsisë se shtetit të ri shqiptar. Haki Stërmilli, kur viheshin në rrezik interesat e atdheut e kombit , për të cilat kishte luftuar gjithë jetën,me gjithë kundërshtitë që kishte me mbretin Zog dhe persekutimin që ai i kishte bërë, nuk do t'ia lejonte vetes kurrë që veprimtaria e tij të cënonte interesat madhore të kombit.

Le të jetë edhe fjala ime modeste, në përvjetorin e 120 të lindjes, së shkrimtarit patriot, Haki Srëmilli një lule kujtimi e mirnjohjeje për veprën e tij të pavdekshme në shërbim të atdheut e të kombit shqiptar.

Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË!
BASHKËPUNO EDHE TI!

rrugaearberit@gmail.com

Rruga e Arbërit nr. 110
kujtesë

Në vlerësim të përkushtimit të Musa Hysen Shehut (Kuqi) e vlerësova që dorëshkrimin e tij ta zbardh në vlerë të një dokumenti për historinë e gjuhës shqipe në trevën e Lurës, një ndër trevat që i ka dhënë shumë Dibrës dhe Shqipërisë me pushkë, penë e mendje.

Musa Shehu, mësues i parë në shkollën shqipe të Lurës

Musa Hysen Shehu (Kuqi) i njohur nga brezi im në qetësinë e shëtitjeve nën kurorën e blirëve të qytetit, shok i pandarë me Haxhi Gjapin, Adem Shehun, Arif Besatarin e të tjerë, në humorin e pastër shoqëror rreth tavolinës në klubin e Ali Baboçit, më vjen larg nëpërmjet një dorëshkrimi për jetën e tij si mësues në Lurë.

Disa fotografi dokumentesh arkivore marrë rastësisht në Burrel e paraqesin Musa Shehun mësues në Lurë...

Në vlerësim të përkushtimit të Musa Hysen Shehut (Kuqi) e vlerësova që dorëshkrimin e tij ta zbardh në vlerë të një dokumenti për historinë e gjuhës shqipe në trevën e Lurës, një ndër trevat që i ka dhënë shumë Dibrës dhe Shqipërisë me pushkë, penë e mendje.






Musa Hysen Shehu (Kuqi) i njohur nga brezi im në qetësinë e shëtitjeve nën kurorën e blirëve të qytetit, shok i pandarë me Haxhi Gjapin, Adem Shehun, Arif Besatarin e të tjerë, në humorin e pastër shoqëror rreth tavolinës në klubin e Ali Baboçit, më vjen larg nëpërmjet një dorëshkrimi për jetën e tij si mësues në Lurë.

Më 22 maj 1925 shkova në Lurë si mësues në shkollën fillore. Atë natë shkova në shtëpi të prindërve të Gjokë Doçit. U prita me bujarinë karakteristike të kësaj zone. Atëherë në Lurë ekzistonte një varfëri e madhe. Asnjë fshatar nuk kishte tesha fjetjeje. Për të fjetë më sollën një dyshek me kashtë thekre, një trup druri për jastëk dhe një dolla me grash për tu mbuluar. Më porositi i zoti i shtëpisë "Në këto tesha nuk ka fletë kush. Fli rehat se janë të pastra"

Të nesërmen shkova dhe takova mësuesin e besimit At LudovikKiri. Ai banonte në kishë dhe kishte tre dhoma. Më propozoi për të më liruar një dhomë për fjetje. Dhomat ishin të rregullta, me krevat, shtresa etj. Po në kishë kishte një virgjëreshë e quajtur Age Kiri. Prifti ma prezantoi si motrën e vet.

Të nesërmen shkova në zyrën e krahinarit të Lurës Zef Doçi dhe i kërkova që të më gjendet një lokal për shkollë. Ai u interesua dhe më gjet një përdhese që kishte qenë mashën e pronarit Hazis Koçeku në Fushë-Lurë.

Të nesërmen, pasi kisha lajmëruar krahinën, filluan të vijnë nxënësit për regjistrim. Atë ditë duke regjistruar filluam të bëjmë pastrimin. Na ndihmuan MuharremTollja dhe një prej të Kaçorrit që nuk e mbaj mend emrin. Këto u interesuan për gëlqere dhe na e sollën. Gëlqerja erdhi por nuk gjenim furça për lyerje. Atëherë na u deshtë të marrim një copë postaqi dhe me të lyem lokalin. Lokali mori një formë nga e zeza në të bardhë. Të nesërmen unë shkova dhe i thashë kryeplakut për të më siguruar disa dërrasa për banka shkolle. Ai mu përgjigj se nuk kam ku ti gjej. I thuaj krahinarit. Atëherë mua mu desh t'ua shtroj fëmijëve duke u thanë se na duhen disa dërrasa dhe se a keni mundësi të na sillni ju nga një copë ose gjysmë cope. Të gjithë u shprehën dakord dhe të nesërmen filluat që ti binin. Dërrasa u sollën mjaft por derisa u bënë bankat fëmijët rrinin në shesh. Unë bashkë me fshatarët arsimdashës Tollja, Kaçori me Halil Met Koçekun filluam të bëjmë bankat në mënyrë që një copë të ishte për tu ulë dhe një copë dërrasë për të vendosur librin. Dhe kështu bëmë 8 copë banka. Kishim të regjistruar 41 nxënës. Në secilën bankë vendosëm



nga pesë fëmijë ngjesh njeri me tjetrin. Ngeli një pa vend. Këtij i bëmë një stol të veçantë afër bankave. Më prapa improvizuam për mësuesin një tavolinë dhe bëmë një dërrasë të zezë.

Nxënës kishim 41 kurse libra kishim 19 Abetare dhe 22 aritmetike. Kështu na u desh që afërsisht në dy fëmijë me shtëpi afër njeri tjetrit të shpërndanim një libër.

Fletore dhe lapsa nuk gjendeshin. Për t'i sjellë nga qytetet dhe veçanërisht nga Shkodra ku në atë kohë kishte lidhje më shumë kjo krahinë. Me të hollat e mia u bleva në Shkodër 15 copë dërrasa guri me kornizë të drunjtë dhe ua dhashë gratis.

Nxënësit e mi të parë mbaj mend Gjokë Gjet Rajta, Gjokë Ndue Rajta, Zef Llesh Kaçorri, Tahir Mena, Met Kaci, Ali Gjoçi, Ndue Prenga...

Në shtëpinë e Zef Doçit kur shkova atë natë për të flejtë vura re një varfëri që më vonë e takova në të gjithë krahinën. Ai theri berr dhe më priti shumë mirë. Karakteristike se me atë sahan prej teneqeje që na u shtrua darka, në atë sahan na shtinë me larë duart. Ishte ndër orenditë e rralla të shtëpisë që përdorej për shumë nevoja të familjes.

Në Lurë gjeta një Musa Osmani. Ishte plak 123 vjeç. I shëndoshë, i fortë në trup. Ky më tregonte disa gjëra të vjetra. Kishte qenë gjyqtar i vendit. Kur bëheshin krime ky i gjykonte sipas kanunit të Lekë Dukagjinit. Më tregonte për punën e liqeneve. Liqeni i Iljaz Perkroses, liqeni i Koçekut. E pyesja se pse i thonë liqeni i Koçekut. Ai më thoshte se në këtë liqen familja Koçeku ka kap një vajzë njëzetvjeçare brenda në liqen. E ka marrë në shtëpi dhe ka bërë fëmijë. Për ta detyruar të fliste sepse nuk folte pas tre vjetësh ia morën fëmijën t'ia presin. Foli por në atë minutë vdiq bashkë me djalin.

Për liqenin e zi thoshte se Austria e pat rrethuar me tela me gjemba sepse kishte fuqi magnetike dhe të tërhiqte. Musa Osmani thoshte se në këtë liqen ka hyrë një ka dhe ka dalë kau në Bunën e Shkodrës. Ishte e çuditshme se në Gurrë të Nezhdës, tek liqenet shkonim me fëmijë. Atje dëgjohej ditët e diela në orën tetë një kambanë. Nuk kuptohej se ku bie. Bënin kontroll me fëmijët për ta gjetur. Dukej sikur binte mbi kokë.

Në Lurë kishte pasanikë dy-tre shtëpi, Ibrahim Gjoçi dhe Hakik Mena, bajraktari i Lurës. Në shtëpitë e tyre kishte qilima, sixhade dhe bagëti të mjaftueshme.

Unë kisha mbaruar në atë kohë gjimnazin në gjuhën serbe në qytetin e Dibrës së Madhe. Në këtë kohë unë u largova prej atje dhe erdha për të banuar tek motra ime Zyra Zeraliu, e shoqja e Jashar Zeraliut. Prej këtu shkova në Tiranë për punë. U paraqita në drejtorinë e përgjithshme të arsimit duke kërkuar të më gjendet një punë për arsimtar në fshatrat e Dibrës. Ata më dërguan në Mat pasi më sorollatën më shumë se një muaj. Prej këtu shkova në Lurë. Asnjëherë në jetën time nuk kisha parë fshatra kaq të varfër, ndërtesa pa tavan, vetëm me rrasa guri e furde të mbuluara përsipër. Rroga ishte 110 franga ose 5.5 napolona ari. Unë pagoja dy napolona në muaj dhe ushqehesha bashkë me fratin në kishë ku edhe flija. Rrogat i merrnim një herë në pesë muaj. Kur u pushova prej pune mora me vonesë rrogat e muajve të kaluar.

KRYENGRITJA E DUKAGJINIT

Më përpara se të shkoj në Lurë njihesha me Ejup Xhidrën, Tajar Zavalanin, Mehdi Ndreun, Lame Tominin, Mustafa Gjinishin dhe Mustafa Kaçaçin. Këto të fundit ishin rreth 16 vjeç. Bisedonim mbi organizimin e organizatës së Dukagjinit dhe bënim regjistrimet për njerëzit e besueshëm. Kishim korrespondencë me të gjithë priftërinjtë e rrethit të Matit, Lurës etj. Në fillim të vitit 1925 ka ardhur nga Sofja Jako Radoviçi i cili na solli 500 copë letra kartëvizita nga Fan Noli. Në letra thuhej: "Të dashur arsimtarë! Përpiquni për atdheun kundër regjimit zogist" Ky njeri emrin e kishte Jako Radoviçi. Shqipen e zotëronte shumë mirë. Ndoshta ky emër ishte pseudonim. Me vete kishte një sasi parash prej 200 napolona ari.

Ai ndenji 15 ditë në tavanin e shkollës. Nga dërrasat që tepruan prej bankave i bëmë një vend të posaçëm mbi tavan. Sapo iknin fëmijët dilte. Natën e merrnim në kishë dhe rrinim bashkë. Zhvillonim biseda se si të organizojmë kryengritjen kundër Zogut.

Nënprefektura e Matit i shkruante krahinarit të Lurës. Letrën e kam lexuar vetë në krahinari. Shkruante se në rajonin e Matit ka dalë fshehtas duke kaluar kufirin një i quajtur Jako Radoviçi. Ky është kriminel i rrezikshëm kundër regjimit në fuqi. Kush ta diktojë të lajmërojë. Për ta kapur ka si shpërblim 50 napolona ari dhe gradim. Ky njeri pasi ndenji atje u përcoll për në Fan të Mirditës i shoqëruar nga Dalip Kaci dhe Llan Kaci. Sot Llani është gjallë dhe banon në Ushtelencë. Llani kur u kthye erdhi dhe na njoftoi se Jaku mbërrini shëndosh e mirë në Fan.

Një ditë përpara se të arrestohemi ne u kam thanë nxënësve në shkollë: "Filloi lëvizja e Dukagjinit. Poshtë satrapi Zog! Rroftë Fan Noli!"

Të nesërmen na arrestuan së bashku me fratin. Fshatarët na dhanë ndihmë. Na sollën kafshë për të shkuar në Burrel. I detyruan xhandarët që të na hipnin në kafshë. Ata na zbritnin kurse fshatarët u thërrisnin se do tu vrasim po i zbritët. Këta na shoqëruan deri në Burrel pasi kishin frikë se po na vrasin rrugës xhandarët. Kur u nisëm për në Tiranë më ndanë nga prifti dhe më lidhën pas një trungu dhe deshëm të më vrasin. Në këtë kohë dëgjohen këmbët e dy kuajve dhe ata të frikësuar më zgjidhën dhe nuk më vranë.

Ndenja në Lurë rreth tre vjet. Vitet që erdhën më vonë nga 41 nxënës ngelën 31. Gjashtë ngelën në klasën e parë. Në klasën e dytë mbetën 35.

DYQANI I LURËS DHE MALLËRAT QË I SHITESHIN POPULLIT.

Dyqani kishte vajguri, kripë, sapun, litar, opinga lope, kafe e sheqer. Tre çerek të popullatës nuk kishin siguruar bukën e ditës. Gaz blinin gjysma e popullatës kurse gjysma tjetër përdornin pishën. Më e shumta konsumohej kripa dhe bezja. Këtë tregtari, kur e jepte me kredi kripën e jepte tre lekë kilen kurse në qytet shitej një lek e gjysmë. Një punëtor merrte në ditë tre lekë. Këto i shiste në afat të caktuar. Në ditën e mbarimit të afatit i vinte klientit në shtëpi, i ulesh në votër dhe i merrte leshin, bagëtinë me çmim që donte vetë. Përndryshe nuk i dilte nga dera e shtëpisë. Unë një ditë shkova të blej 8 kut beze (Një kut është baras me 64 centimetra) për plakun Musa Osmani për ta ndihmuar sepse ishte i varfër. Tregtari më pyeti në se do ta paguaj me lekë në dorë apo kur të marr rrogën. Këtë pyetje e bënte me qëllim që të merrte vesh në se e marr me kredi dhe të më dyfishonte çmimin. Unë i thashë duke qeshur: "I kam paret në dorë. Edhe mua deshe të më fusësh në defterin tuaj dhe të më merrnit fajde." Tregtari u përgjigj: "Jo desha të pyes se njerëz jemi dhe edhe kemi edhe nuk kemi."

Mishin e shisnin me çmim dyfish dhe nga kjo fshatarët vinin e varfëroheshin çdo ditë. Fillonte shamata njeri me tjetrin. Nga këto shkaktoheshin edhe grindje e vrasje të kota. Në Lurë nderi i familjes ekzistonte shumë lart. Hala zbatoheshin zakonet e Lekë Dukagjinit. Njerëzit e liq dënoheshin vetë nga populli. Për këto dënoheshin me dënime shumë të randa ai që bënte poshtërsina.

Tregtar i atëhershëm në Lurë ishte një krutan. Dyqanin e kishte vendos në Fushë-Lurë. Nga Lura merrte bagëti, lëkura, lesh, tëlyen. Vezët fshatarët nuk i shisnin: Kishin turp të shisnin vezë. Kur u kërkoje thoshin se megjithëse ishin të varfër t'i falnin. Thoshin se nuk e kemi zakon të shesim vezë.

Lamë në Lurë në atë kohë kishte vetëm Hakik Mena, kapiten i Zogut, Ibrahim Gjoçi dhe Rajtet.

wPërgatiti: **Abdurahim ASHIKU**

Shënim: Fotografitë janë fiksuar nga ana ime në udhëtimin në Lurë me rastin e përvjetorit të hapjes së shkollës shqipe dhe të sesionit shkencor zhvilluar me atë rast.

AjA
AlpJon ALBANIA
Address: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kati II.
Tiranë, Albania
Mob: +355 (0) 67 47 32 492
E-mail: info@alpjonalbania.com
Web: www.alpjonalbania.com



Zall Dardha di t'i nderojë bijtë e saj

Nga **SHAQIR SKARRA**



Nderimi që komuna Zall Dardhë i bëri Agim Canit ishte disi ndryshe, mori përmasat e mëdha dhe u kthye vërtet në një spektakël. U mblodhën jo vetëm dibranët, por dhe miq të saj nga të gjitha trevat në tempullin e artit dhe kulturës, pikërisht aty ku përgatiten e dalin artistë, këngëtarë, valltar, instrumentist, regjisor e aktor, në sallën prestigjioze të Akademisë së Arteve.

Jo vetëm njëherë por tashmë është bërë traditë e bukur që dibranët mblidhen tok së bashku hera herës në metropolin shqiptar, mbushin salla të mëdha për aktivitete të ndryshme si sesione shkencore, jubile, promovime librash, aktivitete kulturore e artistike. Dhe e veçanta e dibranëve është se ajo natë nuk quhet vetëm e Dibrës, por e gjithë Shqipërisë se mysafirë, të njohur dhe pa njohur, të ftuar dhe pa ftuar mbushin këto salla kur marrin vesh se mblidhen bashkë dibranët.

Kjo vërtet është diçka e veçantë, diçka e madhërishme pasi na rriten edhe më shumë vlerat tek komunitetet e tjera që banojnë në Tiranë. Duke filluar që nga ata sallat më të shtrenjta, më të bukura e deri tek më të thjeshtat dibranët janë futur në to, kanë kënduar e kërcyer, kanë mbajtur kumtesa të ndryshme, kanë zhvilluar sesione shkencore e kongrese. Dhe jo vetëm por edhe profesorë e akademikë, studiues e historianë të ndryshëm kanë referuar këtu bashkë me dibranët dhe për Dibrën.

Kujtojmë jo njëherë, por disa herë sallat e Hotel Tirana me të ndjerin Prof. Nuri Abdiun,Teatrin e Operas dhe Baletit me të ndjerin Naim Plakun ku ftesat nuk na u deshën fare por u hap dera dy kanatëshe e njerëzit u futën të gjithë brenda, Akademia e Shkencave me Xhafer Martinin, Qendra Kulturore "Pjetër Arbnori" me Agron Tufa e Hasan Leka, Akademia e Arteve me Vera Laçi, Muzeu Historik me Xhemal Domi, Shpëtim Cami e plot të tjerë.

E kur isha para pak ditësh në Muzeun Historik përsëri për të rezervuar sallën për një vjetorin e vdekjes së poetit të këngës popullore dibrane Naim Plakut, sekretarja e këtij institucioni sapo mori vesh se jemi dibranë tha: "Nuk ka të paktën një ditë, dy apo dhe më shumë në muaj që dibranët të mos jenë të pranishëm me aktivitete të ndryshme këtu në muzeun historik kombëtar.

E këtë muaj qershor me një klimë të nxehtë dhe fushatë elektorale të ndezur në të gjitha anët e vendit , dibranët i bëri bashkë Agim Cani, biri i Zall Dardhës, biznesmen i suksesshëm dhe ish kryetari bashkisë Kamëz.

Janë nderuar shumë figura dhe personalitete të ndryshme nga komuna, bashki e qarqe. Janë nderuar dhe vlerësuar akademikë, profesorë, doktorë e shkencëtar, janë mbledhur kanë ndarë gëzimin tok së bashku.

Nderimi që komuna Zall Dardhë i bëri Agim Canit ishte disi ndryshe, mori përmasat e mëdha dhe u kthye vërtet në një spektakël. U mblodhën jo vetëm dibranët por dhe miq të saj nga të gjitha trevat në tempullin e artit dhe kulturës, pikërisht aty ku përgatiten e dalin artistë, këngëtarë, valltar, instrumentist, regjisor e aktor, në sallën prestigjioze të Akademisë së Arteve.

Salla e mbushur plot për plot nga të gjitha moshat, nga të gjitha krahët e politikës shqiptare,miq e të ftuar të Agimit por dhe njerëz të artit e kulturës dibrane. Ora kaloi paksa nga 18 ku ishte planifikuar të fillonte ky aktivitet e të gjithë sy e vesh të gozhduar drejt perdes së skenës. Pas pak perdja hapet e në skenë ngjiten valltarët, apo vallja e brezave ku ishin të gjitha moshat, një valle kjo e bukur por më të bukur dhe të larmishme e bënin veshjet kombëtare të valltarëve. Pas pak shfaqet në skenë gjithë nur Silvana Braçe ,një emër kjo e njohur e ekranit shqiptar ndër vite e cila do të ishte dhe moderatorja e kësaj mbrëmje dibrane.

"Jam tepër e lumtur, e njëkohësisht e privilegjuar që ndodhem sonte mes dibranëve ku së bashku do të kalojmë plot momente e emocione të bukura", tha Braçe.


Dokumentari fliste për historinë, doket e zakonet e bukura të Zall Dardhës për të ardhur më së fundi tek personazhi kryesor i kësaj mbrëmje Agim Cani, që nga vitet e hershme e deri në ngjitje në biznes e politikë, në administrim e deri kryetar bashkie në Kamëz. Skenari përgaditur nga Hajri Mandri e Shaqir Skarra. Lexoi tekstin gazetari i njohur i televizionit Marin Mema. Filmimet dhe montazhi nga studio e televizionit "Bulqiza" me president zotin Edmond Isaku. Një dokumentar afro tridhjet minuta por për të gjithë u duk i shkurtër. Këtu ishte pasqyruar bukur dhe me vertetësi historia e Zall Dardhës nga lashtësia e deri në ditët tona. Portreti i Agimit për të gjithë edhe për ata që nuk e njihnin por dhe për miq e shokë doli më i plotë nëpërmjet këtij dokumentari. Agim Cani që nga Zall Dardha, drejt metropolit shqiptar, në udhën e bukur e të vështirë të biznesit,në investimet e shumta në infrastrukturë, ndërtim pallatesh, objekte social kulturore e deri në humanizëm për njerëzit në nevojë e sponsorizime të ndryshme në art e kulturë ku vetëm për vendlindjen e tij Zall Dardhën ka sponsorizuar dy libra si dhe gazetën "Krenaria e Dardhës" e "Dibra" . Por gjatë këtij dokumentari intervista e drejtorit të Qendrës Kulturore Peshkopi Veli Vraniçi e bëri më të plotë portretin e Agim Canit i cili ndër të tjera tha: "Ishin vitet e para të Odës dibrane, ishin vite të vështira për ne si artistë. Nëse më është dashur të trokas në mjaft dyer të biznesit të Dibrës,tek Agimi nuk ka qenë nevoja por ka ardhur vetë tek unë. Në saj të ndihmës, kontributit financiar bujar që na ka dhënë u bë e mundur që Oda dibrane të zhvillohej për tre vite rresht pa probleme financiare. Ky është Agim Cani që njoh unë, ky është Agim Cani që njeh Dibra, ndaj them se ky titull është paksa i vonuar, megjithatë më mirë vonë se sa fare".

Qerim Sula ngjitet në skenë. Jo vetëm për Agimin që janë të dy nga i njëjti fshat por Qerimi është i pranishëm në të gjitha aktivitetet që zhvillojnë dibranët, dhe e veçanta e tij është se nuk kërkon ftesë, nuk kërkon ti përgjërohesh e lutesh. E Qerimi e ngriti sallën në këmbë, e ndezi heshtjen që kishte pllakosur duke ndjekur sy e vesh dokumentarin deri para pak minutash. Skenari ishte përgatitur mirë, jo rutinë, jo i lodhshëm për të pranishmit. Pas çdo kënge dhe një përshëndetje. Përshëndetje nga të pranishmit që ishin në sallë. I pari përshëndet biri i Dardhës, mjeku kardiolog, Petrit Bara. Më pas, bija e Zall Dardhës, Liri Rasha, me zërin e saj brilant elektrizoi sallën. Përshëndetën Eduard Abazi, ish pedagog në shkollën e bashkuar të oficerëve si dhe miku i Agimit dhe i gjithë dibranëve Azgan Haklaj. Përsëri skena do të jehonte nga këngët e Saje Poleshit, Sherif Dervishit, që të dy nga Zall Dardha.Nuk ishin vetëm këngëtarët e njohur dibranë ata që mbajtën spektatorët e veçantë këtë natë qershori sy e vesh në skenën e Akademisë së Arteve por kishin ardhur edhe këngëtarë nga rrethet të ftuar për këtë mbrëmje dibrane. E thjeshta, e mira, princesha e këngës popullore pukjane Dava Gjergji e ngriti sallën në këmbë me të rinj dhe të moshuar duke duartrokitur deri në fund të këngës. Një tjetër këngëtare e re, e re në moshë, e re dhe në skenë, por zëri i saj kumboi fuqishëm në këtë natë qershori, në këtë nate dibrane me një këngë patriotike "Jam arbneshë, jam Shotë Galica"

Pika kulminante e aktivitetit ishte kur në skenë ngjitet kryetari i këshillit komunës Zall Dardhë Gëzim Kaca, i cili duke lexuar vendimin e këshillit fton Agimin t'i dorëzojë titullin "Qytetar Nderi" i komunës Zall Dardhë.

Në fund ngjitet këngëtari Dritan Jashari i cili së bashku me sallën këndoi këngën më të re për Zall Dardhën me tekst të Hajri Mandrrit e muzikë të Edmond Zhulalit. Mbrëmjes i erdhi fundi, salla filloi të boshatisej, por holli i Akademisë së Arteve përsëri i mbushur plot për plot. Tashmë Agimi kishte shtruar një koktej për të gjithë të pranishmit, jo pak, por mbi pesëqind veta. Trokitje gotash, urime, fotografi me këngëtarë që morën pjesë në këtë spektakël disi të veçantë. Ora kaloi nëntë e darkës kur njerëzit filluan të largohen. Jashtë kishte rënë mbrëmja e makinat kishin filluar të pakësohen, por dibranët grupe-grupe të gëzuar për këtë natë të bukur në metropolin shqiptar që u çlodhën sadopak nga punët e hallet e përditshme u larguan të gëzuar.

Poetët dibranë në një antologji poetike në ndihmë të Shtëpisë së fëmijës Sarandë



Nga ILMI DERVISHI

Kur Sofi Gjiknuri, një grua fisnike që kishte ndihmuar me ndihma të herë pas herëshëm Shtëpinë fëmjve në sarand, mori për të bërë një Antologji,përvec dëshirës, ishte dhe përfshirja e poeteve neëte gjitha rtojet shqipfolse, dhe këto te ardhura do shkonin në ndihme të kësaj shtepie në Sarandë.

Botimi i librit erdhi dhe me një promovim ne Tirane ku krahas lexuesve e dashamirës te poezis kishte dhe poet, shkrimtare e gazetar. E pranishme dhe me fjalën e saj ishte dhe zv. Ministraj e Arsimit dhe Kultures, zonja Nora Malaj.

Ne përmbledhjen poetike" Antologji Poetike" lexuesi gjen poezi nga autor shqiptar nga te gjitha trevat, si Theodhori Baba Vlorë, Zade Kuqi Prishtine, Agim Desku Pej, Mirela Ropi Korrca,Sokrat Habibaj, Fatmir Terziu, Namik Selmani e tjerë por dhe nga arbereshët , nga Tirana e Shkodra, Shkupi, Prishtina e Tetova, por dhe disa poet nga Dibra Nuk mund te mos ishte Josif Bagëri që jeten e tij ja kushtoj Kombit e letersise autori I parë dibrane qe boton librin e tij më 1908. Nexhat Pustina (1926-1982) autor I disa librave si "Zë bilbili lule mali", 1969,, " Këngë rebele "1981. Halil Basha, nje tjeter poet dibranautor I librave me poezi si "Lapidatët e verdhë" 1981, "Vargu im I vogël" 1998; "Flutura në pikëllim" 2002 e tjere. Agim Nivica, poeti, studiusi që ndonse jetoj e punoj jashtë dibrës, gjithmonë thonte me krenari jam dibran! Autor I disa librave mes tyre, "Feniks" 1972, "Bregu i mallit" "Në vend të një biografie" " Arrëna e ëndërra" e te tjerë që lexuesi shqiptar brenda dhe jashtë kufirit shtetërori ka lexuar dhe vlërsuar, po keshtu dhe dy poet të rinjë dibranë si Astrit Balliu, autor I vëllimit me poezi "Princesha ime" dhe Donika Paci autore e librit "Ma thave lotin"'

Botimi cilësor, i perzgjedhur dhe me nje shtrirje gjeografike te autorëve beri te mundur jo vetem njohjen por dhe shitjen etij duke shkuar jita te ardhurat ne ndihmë t Shtepise së fëmijës Sarandë.

Ai ishte i paqmë e i qetë, i afërt e dashamirës, i përkushtuar në punë e prind i dytë për nxënësit, sepse vlerësonte e çmonte përzemërsisht profesionin e pedagogut e të mësuesit

Profesor Mois Cami, mësuesi dhe edukatori ynë i dashur

Nga Prof. **HAJRI SHEHU**

Ndihem i nderuar që mund të them sadopak edhe unë fjalë respekti e mirënjohjeje për mësuesin tonë të shkollës pedagogjike, profesor Moisin. Por në raste të tilla, çështja është se ç'mund të përveçosh nga tërë ajo mori kujtimesh aq të mira. Dhe, përveçova ca copëza, duke menduar se po të mblidhen, mund ta formojnë, sidoqoftë mozaikun. Do të isha i lumtur nëse e kam përçuar plotësisht mendimin e ish-bashkënxënësve për gjithë atë punë që ka bërë profesori për të na mësuar e edukuar, për pasionin e ndezullinë (zellin) e profesorit për të na dhënë gjithë dijen e tij, jo vetëm në shkencat e natyrës, por edhe për jetën në tërësi, për profesionalizmin e tij të admirueshëm e kulturën e tij të lartë pedagogjike, për sjelljen e tij fisnike, për kujdesin e tij prindëror për nxënësit, sidomos për ne konviktorët.

Për të parën herë profesor Moisin e pamë një ditë para se të fillonte mësimi. Ishte 31 gusht, 1956. Nxënësit ishin shpërndarë në oborrin e shkollës nga prapa. Ishin çaste kur ne të klasës së parë po njiheshim me njëri-tjetrin. Vinim nga rrethe të ndryshme, kryesisht të Veriut. Të tjerët, ata të viteve të dyta, të treta e të katërta, tashmë ishin shokë e shoqe. Ne përpiqeshim të bëheshim të tillë. Na kishin thënë të mos largoheshim nga oborri. Diku aty, pasi kishim ngrënë mëngjesin me marmelatë e qumësht në mensë, dikush thirri te sheshpushimi i shkallëve: "Nxanësit e vitit të parë të mblidhen këtu!". U mblodhëm. Njëri nga mësuesit, i bëshëm, bardhavel në fytyrë, shpatullgjerë e ballëgjerë, i qeshur, lexoi emrat sipas paraleleve. Dy paralele ishin – A dhe B. Mësuesi na tregoi klasat e mësimit sipas paraleles. U ngjitëm shkallëve, te sheshpushimi e te klasa në katin e parë të shkollës. Ishim të gjithë fëmijë, katërmbëdhjetëvjeçarë, por me kureshtje e dëshirë për të parë mësuesit teksa ngjisnim shkallët. Tek ecnim ashtu, në rresht e me rregull, dikush tha me pëshpërimë se profesori që kishte folur parëz, kishte qenë vetë nxënës i kësaj shkolle. Eu!, - ia bëri tjetri, - ka kanë nxanës e asht ba profesor! Kaq u desh. Gjithë klasa e mori vesh që profesori kishte qenë nxënës këtu, ndoshta në një nga bankat ku do të ulej dikush nga ne. Kjo e bëri punën e vet: Me logjikën tonë fëminore, ai ishte i afërt e i mirë për ne se ja, kishte qenë si ne, kishte qenë nxënës si ne, kishte mësuar në këtë shkollë e kishte ngrënë në këtë mensë si ne. Ai që foli kështu, shtoi pastaj në klasë se ishte patriot i profesorit (kuptimi i fjalës "patriot" për ne ishte "ai që është nga i njëjti fshat a nga një fshat i afërt me dikë tjetër") dhe se profesori ishte shumë i mirë. Ne nuhatëm se ky profesori do të ishte mësuesi ynë kujdestar. E, ç'ishte mësuesi kujdestar, e dinim nga shkolla 7-vjeçare; ndaj donim që "të na binte (!) një mësues i mirë", sikur kjo punë të bëhej me short! "I mirë" për ne do të thoshte që "të mos ishte i vranët në fytyrë e të mos na bërtiste, madje, edhe kur të bënim ndonjë zarar (!).

Dhe vërtet, profesor Moisi kishte mbaruar vetë shkollën pedagogjike të Peshkopisë - një shkollë me emër në Republikë, thuajse, një institut, një fidanishte e mësuesve për rrethet Dibër, Kukës, Bajram Curr, Mat, Krujë etj. Në këtë shkollë, ai tashmë, ishte vetë pedagog. Fare i ri. Kishte mbaruar Fakultetin e Shkencave në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Këto i tha vetë profesori kur u prezantua me ne më pas. Edhe pedagogët e tjerë ishin të rinj. Por të rinj që bëjnë pjesë tek intelektualët që ngritën arsimin tonë kombëtar dhe që luftuan për përsosjen e arsimit tonë kombëtar.

Hymë në klasë dhe u ulëm në banka. Pas ca minutash hyri në klasë ai mësuesi që na kishte vënë në rresht pak më parë. Nuhatja nuk na kishte gabuar: ai do të ishte mësuesi ynë kujdestar. Mësuesi hyri fytyrëqeshur, ashtu siç e donim ne. Kjo do të thoshte që mësuesi ishte i mirë. Mësuesi u paraqit para klasës, a si i thonë ndryshe, u prezantua. Tha emrin dhe mbiemrin e vet dhe lëndët që do të na jepte. Tha edhe se do të ishte mësuesi ynë kujdestar dhe ca fjalë e këshilla si prej prindi. Këtë lloj prezantimi e kam parë më vonë në universitet. Pastaj, ashtu, më këmbë para klasës, tha: "Tashti e keni radhën ju, do të më thoni emnin, mbiemnin dhe rrethin e fshatin nga vini". Dhe ne, njëri pas tjetrit, sipas rreshtit të bankave ku qemë ulur, thamë atë që kërkonte profesori.



Kuptohet pak si me ndruajtje. Ishte fjala jonë e parë në atë klasë e në atë shkollë. Më pas, mësuesi na foli për mësimet, për shkollën, për dijen. Na njohu me shkollën ku kishim ardhur. Nga fjalët e profesorit kuptonim se kishim ardhur në shkollën më të mirë të Shqipërisë. Kjo do të thoshte se ne duhej të ishim shembullorë, që ta meritonim atë derë shkolle. Dhe, vërtet ajo qe shkollë shumë e mirë. Atëherë, kur ishim nxënës, por edhe pastaj, na dukej se po të mos ishte shkolla pedagogjike, nuk ishte as vetë qyteti i Peshkopisë. Sigurisht, e kishim zmadhuar shumë sepse shkolla ishte pjesë e qytetit. Por ishte pjesë thelbësore e qytetit, ngaqë i jepte atij tonin rinor e gjallërinë rinore. Si? Ku? Kur? Me vetë ndërtesën - më e madhja e më e mira e qytetit. Në oborrin e shkollës. Te ndeshjet e futbollit, si tifozë, kur luante skuadra e Peshkopisë me skuadra të qyteteve të tjera të Shqipërisë. Në kinemanë e qytetit. Në veprimtaritë artistike. Në mëngjesin e hershëm, kur kishte votime.

Në shkollën pedagogjike mësimi bëhej në nivel të lartë teorik. Në të gjitha lëndët. Te lëndët e profesor Moisit shkonim në klasë me dëshirë të madhe. Jo vetëm për ato që mësonim, por edhe për mënyrën e zhvillimit të mësimit. Pa e ndarë orën në mënyrë shabllone: kontrolli i njohurive; shpjegimi i mësimit të ri. E tërë ora ishte njësh. Nxënësi merrte pjesë tërësisht edhe në shpjegimin e mësuesit. Dhe, ne nuk e kuptonim se si mbaronte ora kaq shpejt. Ishte merita e mësuesit. Lëndët që jepte profesor Moisi, për vetë llojin e tyre, kishin edhe karakter praktik e eksperimentues. Dhe, ne mësuam shumë nga ato dhe ruajtëm shumë në kujtesë. Shumica e nxënësve vinin nga fshatrat. Njihnim lloje bimësh e lloje gurësh. Por nuk dinim të bënim herbariume (bimëtore). Nga profesor Moisi e mësuam. Madje, e pëlqenim aq shumë punën e herbariumeve. Siç pëlqenim shumë punëdoren "papije mashé", që na e mësoi profesori Andon Lakuriqi. Pas rreth 30 vjetësh, përvoja e herbariumeve në shkollën pedagogjike do të më shërbente për të ndihmuar djalin tim për herbariumet e tij në shkollën 8-vjeçare. Kishim mësuar ca më parë për barazimet (ekuacionet) algjebrike. Në lëndën e kimisë, sidoqë e shtrirë pak në kohë, mësuam barazimet kimike. Me mësues Moisin. Tani, dikujt mund t'i duket habi: Me lëndën e mineralogjisë që bëmë me profesor Moisin, ne ishim thuajse gjeologë, sepse njihnim shkencërisht xeherorët (mineralet). Sigurisht, ne u befasuam kur profesori ndezi magnezin për eksperiment. Edhe kur na tregoi mikën peta-peta të tejdukshme. Ne befasoheshim edhe kur profesori na tregonte kuriozitete nga bota e kafshëve. Por, edhe e bimëve. Të gjitha ishin mësim për ne.

Ishim fëmijë kur erdhëm në shkollën pedagogjike të Peshkopisë. Sa kishim mbaruar shkollën 7-vjeçare. Në këtë shkollë u bëmë adoleshentë e të rinj. Aty u rritëm. Për këtë rritje merita u përket personelit të konviktit dhe të gjithë mësuesve. Konvikti dhe shkolla ishin në një ndërtesë madhështore - jo vetëm për atë kohë. Sigurisht, edhe mërziteshim sepse ishim larg familjes dhe sidoqoftë, të vegjël. Por mësuesi kujdestar - e ai ishte profesor Moisi - na rrinte shumë afër.

Ishte një rregull – aq domethënës, që nuk

E donim profesorin. E donim gjithnjë shumë, sepse ishte i dashur dhe i thjeshtë. Në paraqitjen e tij. Në sjelljen e tij. Fytyrëqeshur gjithnjë. Me nxënësit e me të tjerë. Gjithnjë i qetë. Edhe kur nuk i pëlqente diçka. Ai kurrë nuk e vuri regjistrin rrëmbimthi në tavolinë. Edhe bisedat i kishte të këndshme.

bëheshin pushimet semestrore pa bërë mbrëmjen e Vitit të Ri. Bashkërisht: nxënës e mësues. Në sallën e madhe të mensës. Aty, profesor Moisi do të shkëputej herë pas here nga kreu i sallës, ku rrinin mësuesit e do të kalonte sa te një grup nxënësish te një tjetër. Në "orën gazmore" profesor Moisi qeshte e kënaqej. Dhe na e hiqte tërë perden e drojës përpara mësuesve. Ora gazmore ishte pjesë e programit festiv të mbrëmjes së Vitit të Ri. Teksti ishte i parapërgatitur. Ishte humor e shaka në poezi. Për shkollën. Për konviktin. Ndonjë batutë, edhe për mësuesit. Zakonisht e lexonte nxënësi që e kishte përgatitur. Diku te sporteli i mensës. Me megafon.

Mbaj mend, në vitin shkollor 1956-1957 ra një grip i rëndë në shkollë. I tërë konvikti ishte shtrirë. Profesori vinte disa herë në ditë nëpër fjetore për të na parë e për të na pyetur si ishim. Dhe një rast tjetër: Na u sëmur një shok klase. Me plevit. Nga Bajram Curri ishte. Ndenji tri javë në dispanseri. Doli i përmirësuar nga dispanseria, por bënte inxheksione në infermierinë e shkollës. Profesori shkonte në infermieri e pyeste nëse e kishte bërë ai gjilpërën e ditës. (Infermieri ishte nga Brezhdani - kushëri i një shoku të klasës sonë e ky na e sillte fjalën e tij për profesorin). Tamam si një prind.

Ekskursioni i majit në Rrafshet e Drinit dhe zbukurimi i klasës për Vit të Ri ishin diçka tjetër e bukur atëherë e nostalgji sot. Profesori ishte gjithnjë me ne. Edhe në ato ekskursione. Dhe ne shfrytëzonim çdo rast për të qenë me profesorin. Në biseda. Por, edhe kur do të kapërcenim ndonjë vijë a hendek. Do ta ngadalësonim ecjen a do ta shpejtonim ecjen për të gjetur pretekst për të qenë afër profesorit. Donim ta ndiqnim në çdo hap.

Mësuesi kujdestar, profesor Moisi na rrinte shumë afër në mbledhjet e organizatës së rinisë. Me fjalën e tij. Me sugjerime. Me këshilla mbushamendëse. Pa asnjë imponim e urdhër. Në mbledhjet e rregullta të klasës, po ashtu. Por këtu, sigurisht, do të kishte edhe urdhra. Sepse mbledhja e klasës ishte pjesë e shkollës e shkolla kishte kërkesë llogarie e disipline.

Profesor Moisi i njihte të gjithë nxënësit e të gjitha nxënëset e shkollës me emër. Edhe për kontroll dijeje i thërriste me emër. Dikush tjetër i thërriste me mbiemër. Dikush tjetër, me emër dhe me mbiemër. Ne na pëlqente mënyra e profesor Moisit sepse tregonte afërsi: Ne ndiheshim më të çlirët e më të qetë dhe na dukej se na vlerësonte më shumë ashtu.

Profesori njihte personalitetin e çdo nxënësi të klasës në kujdestari (sigurisht, edhe të klasave të tjera), por edhe e vlerësonte shumë personalitetin e nxënësit – një parim shumë i rëndësishëm i pedagogjisë. Si? Na dëgjonte ta thoshim fjalën (për klasën, për një rregullim a sistemim klase, për mënyrën si ta bënim një veprimtari jashtë klase a jashtë shkolle etj.), por edhe e vlerësonte fjalën tonë, madje, edhe e pranonte. Kjo, sikur na madhëronte. Në mësim, te notat nuk bënte lëshime profesori. Kjo, nga ana tjetër, na pëlqente sepse na mbushte me bindje që kishim mësuar e thënë diçka. Po edhe kjo, sikur na madhëronte.

Nxënësit vinin nga rrethe të ndryshme të vendit, kryesisht, siç u përmend, veriore e ishin me formim të ndryshëm intelektual. Ta themi edhe një herë: të mos harrojmë, ishin vitet 1956-1960. Për këtë arsye, edhe puna pedagogjike-edukuese e profesorit ishte e diferencuar. Do të përmend vetëm pak raste.

Diku nga viti i dytë, na erdhi në klasën tonë një vajzë nga një shtëpi fëmijësh, mundet nga Tirana. Në krahasim me ne, ajo ishte shumë e hedhur e rrinte si larg të tjerëve. Profesori e miqësoi shumë me të gjithë ne. Klasa jonë organizonte shpesh mbrëmje vallëzimi. Ishte një mënyrë tjetër afrimi e kujdesi për njëri-tjetrin. Një herë, me sugjerimin e mësuesit tonë kujdestar, profesor Moisit, klasa III A organizoi një mbrëmje për një nxënës të dalluar. Ishte një emulacion i gjetur e me vlerë. Në klasë kishim një djalë si të ngathët. Mësuesi kujdestar e angazhonte atë më shumë se të tjerët në disa punë të klasës. Ai kërkonte vetëm t'i afronte nxënësit. Por pa privilegjuar askënd. Sidomos, të afërm të tij. Mbaj mend që në shkollë ishin pesë vajza me mbiemrin Cami. Thoshin që katër prej tyre profesori i kishte kushërira. E pesta ishte e motra, Tefta. Kurrë s'kemi parë as privilegjin më të vogël për to. Madje, më kujtohet një herë: Po ngjiteshin shkallëve Tefta dhe Fanija, një shoqe e saj e klasës. Profesori po zbriste. U ndal e foli, por foli më shumë a thuajse vetëm me Fanijen. Si i doli mësimi Hajri Shehut?, - kishte pyetur një herë profesori mësuesen e ushtrimores, ku bënim praktikë mësuesie. Po, jo veç për mua. Edhe për dikë tjetër, dikë tjetër e dikë tjetër ... Kishte pyetur edhe mësuese Femijen në shkollën "Demir Gashi", kur bëja praktikën mësimore dyjavore përfundimtare. Më bëri, sigurisht shumë përshtypje interesimi i mësuesit kujdestar, por e mora, thjesht pyetje për punë përparimi, siç mund të pyetej, b.f., si shkon aksh nxënës në aksh lëndë. Femija ishte motra e profesorit. Po aq fisnike sa profesori. Më vonë, kur u bëra vetë mësues, vlerësova pyetjen e profesorit. Ajo nuk ishte, thjesht pyetje; ishte kujdesi i profesor Moisit për të ardhmen. Sepse mund të mësoje mirë kimi e biologji, histori e gjuhë ... Po, a do të thoshte kjo se mund të ishe mësues i mirë? Dhe, pashë, vërtet merakun prej mësuesi e prej njeriu: nxënësit e pedagogjikes dilnin mësues dhe profesori i biologjisë i donte nxënësit e tij mësues të ardhshëm të mirë.

A e kemi kënaqur ne nxënësit profesorin gjithnjë? Nuk besoj. Ishim nxënës. Ishim adoleshentë. Ishim të rinj. Personalisht, do të përmend dy raste. Ishim paralelja A. Që nga klasa e parë deri në klasën e katërt. Klasë e mirë gjithmonë. Klasë që dallohej për veprimtari artistike: shfaqje në shkollë për festa a ditë të shënuara. Por një herë, shfaqja pati probleme. U ngatërrua recituesi i parë. Ishte vajzë. U ngatërrua edhe i dyti. I dyti isha unë. Pati edhe një ngadalësi në një numër më pas. Ishim gati të dështonim. Dhe nuk ishte aspak mirë. Do të bëheshim gazi i shkollës. Spektatorët ishin, vërtet shokë e shoqe të shkollës. Por sidoqoftë, ishin spektatorë dhe shikonin e prisnin. Grupi i shfaqjes u bë pikë e vrer. Dhe ja, nga pas perdes erdhi mësuesi kujdestar - profesor Moisi. Për habi, nuk na bërtiti. Se asnjëherë nuk bërtiste e nuk e ngrinte zërin me të keq. Por në këtë rast mund ta kishte ngritur zërin e të thoshte: "Ç'po bani kështu!". Kjo na lehtësoi shumë. Pastaj, dy-tri kështilla. Dy-tri fjalë kurajimi. Ndonjë përndryshim (modifikim) programi. Të gjitha këto, ndërkohë që shfaqja po vijonte. Dhe vijoi e përfundoi mirë.

Një moment tjetër imi ka qenë te komiteti i rinisë së shkollës. Isha në klasë të parë. Nuk kishin kaluar as tre muaj që kisha ardhur në shkollë, por paraqita kërkesë për t'u pranuar anëtar rinie. Trokita e hyra në dhomën ku mblidhej komiteti i rinisë. Rreth një tryeze ishin anëtarët e komitetit – nxënës të dalluar e të zgjedhur, nga klasa më të larta. Ishte edhe mësues Moisi. Nuk e di nëse ishte anëtar i komitetit. Mundet edhe të ketë qenë, sepse edhe ai ishte i ri e mund të ishte zgjedhur. Mbase e kishte detyrë shkolle të ishte pranë atij komiteti. Nuk e di. Nuk më pranuan si anëtar rinie. Më thanë edhe arsyet. Unë u mërzita shumë dhe e shpreha me sy të rrëmbushur. Ndërkohë, vura re që u mërzit shumë edhe mësuesi im kujdestar. Pas disa orësh, në pushimin midis orëve të studimit të pasdites, në korridor, te klasa jonë ishte mësuesi im kujdestar. Nuk besoj t'i kishte rënë rruga. Më zuri emër dhe më tha: "Mos u mërzit! Do të bahesh anëtar i rinisë. Ka edhe të

tjerë që nuk janë ba hala". Unë u rrëmbusha edhe më shumë. Profesori tha edhe disa fjalë të tjera prekatare. Pastaj buzëqeshi dhe më preku supeve. Ato fjalë, ajo buzëqeshje dhe ajo prekje supeve më rigjallëroi dhe hyra në studim.

Momenti i tretë ka qenë mbledhja e organizatës së rinisë së klasës për zgjedhjen e sekretarit. Isha në klasë të tretë. Kur nisi pjesa e mbledhjes për propozime, dikush propozoi për mua. U thanë fjalë të mira. Pas tri-katër diskutimesh, kërkova fjalën. Kryesia e mbledhjes më dha të drejtën të flisja. Në mbledhje ishte edhe mësuesi kujdestar, profesor Moisi. Ishte ulur në fund të klasës, që do të thoshte se ishte, thjesht dëgjues. Unë vlerësova propozimin dhe fjalën e shokëve e të shoqeve, pastaj thashë: "Ju faleminderit për propozimin, por së pari, nuk e meritoj vlerësimin dhe së dyti, më duhet që të merrem më shumë me mësime, domethënë, besoj se nuk do të më mbetet kohë për punë të rinisë". Të gjitha sa thashë, i kisha me çiltëri. Por fjala ime u mor justifikim, vjegë, tërheqje, bishtnim etj. për interesa personale, siç u shprehën dy të tjerë. Mbledhja mori karakter tjetër.

Dikush propozoi që të përjashtohesha nga organizata e rinisë, si i ri që nuk merrte përsipër detyra shoqërore, që mendonte vetëm për vete etj. Po të kishte ndodhur kjo, do të kishte qenë me pasoja jo të vogla për mua. Nuk ndodhi. Mësues Moisi këshilloi. Mbeta anëtar i rinisë. Por jam i bindur që profesori ka mbetur i pakënaqur nga unë. Dhe këtë ma ka thënë – ashtu siç dinte ta thoshte ai, me takt e pa e prekur tjetrin, por pak dibrançe – aty nga fillimi i viteve '90. Te hotel "Drini" prisnim – profesori dhe unë – të vinte autobusi i Peshkopisë. E ftova për një çaj, ndërkohë që prisnim. Më pyeti gjerë e gjatë për punën, edhe pse dinte shumë gjëra për Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. "Mirë shumë, - më tha. Instituti asht vend i mirë pune. Institutet kërkimore - shkencore duen shumë punë. Por, besoj se nuk asht punë e mbyllun. A bani ekspedita gjuhësore në terren ju të Institutit? Njeriu hapet sysh kur shkon në fshat. E di nga vetja, kur isha student e kur shkojshim në ekskursione mësimore për me njoftë florën e faunën e vendit. Po anglishtja a të hyn në punë aty? Po, a gjen kohë për t'u marrë me ndonjë punë shoqnore?" Dhe shtoi: "Punë shoqnore në Institut, por edhe në lagje."

Natyrisht, këto që përmenda, janë pengje e autokritika personale. E, njeriu ka shumë pengje, kur kthehet e shikon prapa në kohë. Koha është armiku më i egër i njeriut. Por, në lidhje me mësuesin tonë kujdestar për të katër vitet e shkollës së mesme, ka edhe një peng kolektiv, të të gjithë klasës së katërt A. Kur ta lexoni, do të thoni: "S'paska qenë ndonjë peng kushedi se çfarë". Jo, është. Ka qenë. Kini parasysh një dëshirë të rinjsh. Është fjala për një ekskursion njëjavor në disa qytete të Shqipërisë (Burrel, Krujë, Tiranë, Durrës) që u organizua me klasën e katërt A pas provimeve të maturës, si klasë e dalluar. Dhe që ishte e dalluar, ishte meritë edhe e mësuesit kujdestar. Mësuesin e deshëm të vinte me ne. Si në ekskursionet te Rrafshet e Drinit. E donim në autobus. Në sheshin "Skënderbej". Në Krujë. Në bregdetin e Durrësit. Në restorante. Thuajse, të gjithë nxënësit nuk kishin qenë asnjëherë në Tiranë e në Durrës, çka do të thoshte se ishte një "zbulim" për ne. Në këtë "zbulim" donim, pra edhe profesorin kujdestar. Si drejtues. Si udhëheqës. E, edhe si bashkudhëtar. Mirëpo, na thanë se profesori kishte punë më të rëndësishme. Erdhi dikush tjetër. I mirë edhe ai, por pak i vranët.

E donim profesorin. E donim gjithnjë shumë sepse ishte i dashur dhe i thjeshtë. Në paraqitjen e tij. Në sjelljen e tij. Fytyrëqeshur gjithnjë. Me nxënësit e me të tjerë. Gjithnjë i qetë. Edhe kur nuk i pëlqente diçka. Ai kurrë nuk e vuri regjistrin rrëmbimthi në tavolinë. Edhe bisedat i kishte të këndshme. Kur ndodhte që kishim dy orë njëra pas tjetrës me profesorin (për shembull, biologji e pastaj, darvinizëm), profesori nuk shkonte në këshillin pedagogjik në pushimin midis orëve. Rrinte me ne në klasë ose në korridor: profesori në mes, ne rreth. Ishin biseda si midis shokësh. E, ne miqësoheshim edhe më shumë me profesorin. Shkrydheshim e gjallëroheshim. Pastaj, sigurisht, vinte ora e mësimit, gjithë preokupim e disiplinë.

Këto e shumë më shumë se këto mund t'i thotë çdo ish-nxënës i shkollës pedagogjike për profesor Moisin. Janë fjalë vlerësimi e homazhi për mësuesin. Ai ishte i paqmë e i qetë, i afërt e dashamirës, i përkushtuar në punë e prind i dytë për nxënësit, sepse vlerësonte e çmonte përzemërsisht profesionin e pedagogut e të mësuesit

Përkrenarja e Skënderbeut: Kodi deshifrues, një dhuratë për shqiptarët

Nga **ISLAM CANI**



Përkrenarja e Skënderbeut, përbëhet prej çeliku dhe rrethohet nga një rrip i larë me ar. Në majë të saj është vendosur si simbol koka e dhisë me brirë të cjapit që shpreh kodin sekret, shkallën e evoluimit të dijes, simbolet e kalorësisë, fildish i rrallë, gjuhë kjo simbolike e fisnikëve, jo e masave popullore..

Shqipëria e gjithë Kombi Shqiptar, ka njohur në historinë e saj heronj e strategë të lavdishëm me tituj e grada, me simbole mistike të kohës. Duke filluar që nga Alekssandri i Madh e deri të Skënderbeu që nuk i hoqi nga koka e trupi shenjat orientuese, njohëse përkeranarja me dy brirët e cjapit dhe shqiponja me dy kokë. Nuk ishte një rastësi për kalorësin shqiptar, Skënderbeun, që të identifikohej me përkrenaren e tij me dy brirë. Ai ishte një alkimist i njohur, kalorës i rrallë, orientues i vecantë në astronomi, astrologji dhe shkenca të tjera.

Ndërsa, simbolet e Aleksandrit të Madh vinin nga Dodona Pellazgjike, me simbole të mitologjisë. Ky ishte dallimi që mund të bëhet ndërmjet kohrave dhe ndërmjet personave madhorë. Të njohjes së dijeve dhe gradave nga lloji i përkrenares. Ndoshta për arsye të shumta nga niveli njohës i paktë, padija, apo pamundësia, bëri që pas vdekjes së Skënderbeut nuk u mbajt më një përkrenare e dytë dhe nuk u përkthyen këto simbole në përkrenare se ç'ishin dhe çfarë simbolizonin ato?

Përkrenarja, stemat, shpata, rrobat, tregonin gjuhën analogjive të kodit mistik; forcë, madhështi, stoli, kulturë e fisnikëri, gjë, të cilat e shoqëruan gjithë jetën e tij ushtarake, si mbrojtës i vatanit dhe i Kristianizmit në Europë siç e quajnë të huajt. Ia kishin lakminë të huajt Kastriotit, gjeniut Europës, si njohës të artit ushtarak, dijetar e kulturë gjithëpërfshirëse, shpëtimtari i kristianizmit.

Skënderbeu vinte me rrënjët fisnore të Palit që dhuron bujarinë. Gjoni që u dhuroi kishave pasurinë dhe vetë ai, Gjergji i dha Europës shembullin e pashoq, me simbolet e tij në përkrenare na bëri të njohur në Europë e në botë.

Duhet ti njohim këto vlera, simbole e shenja mistike dhe ato të mbeten burim i pashtershëm krenarie për mbarë shqiparët. Ai njihte gjuhën e shpendëve si, pëllumbi, shqiponja, skifteri dhe korbi, për të cilat i shfrytëzoi në strategjinë e tij, parashikues e planifikues. Këto njohuri i kishte në sajë të astronomisë, astrologjisë, matematikës, të alkimisë, mjeshtër i dijes së asaj kohe, të dijes arcane (dije sekrete të antikitetit). Kastriotët, midis Lindjes dhe Perëndimit, mbanin stemën e shqipes me dy kokë, por e veçanta është se Skënderbeu mbajti veç saj, si personale, përkrenaren e famshme të tij. Ajo mbante dy brirët e cjapit, që fisnikë të tjerë nuk e kishin dhe kjo simbolizonte, merita të caktuara, kjo përkrenare u transmetua në breza. Për njohjen dhe studimin e simboleve të saj, duhen njohuri të astrologëve, shpeguesit e shenjave që me pak fjalë mund të sqarojnë në gjuhën e thjeshtë se përfaqësonte: simbolin e kalorësisë, diturisë dhe astrologjisë sepse ai dominonte në shenjën e saturnit, nivelin e gradave të shumta që në rastin tonë shpreheshin te brircjapi.

Simbolin e bricjapit mund ta mbanin vetëm ata që njihnin misterin e rimishërimit. Kjo lidhej dhe me shenjën zodiakale të bricjapit i lidhur ngushtë me Saturnin, sepse nga ky planet fillon rruga e rilindjes etj.

Simboli i bricjapit në atë kohë shprehte bashkimin e strukturës së brëndshme me të jashtmen. Arritja e këtij uniteti ishte qëllimi i shkollave antike dhe mesjetare. Veçori që karakterizohej vetë gjeniu shqiptar. Bricjapi udhëhiqet nga Saturni, zot i kohës, prandaj në Antikitet kjo lidhet dhe me shpatën, që mbron jetën e dominon vdekjen.

Është sa e çuditshme aq dhe e vërtetë lidhja e ndërtuesëve të katedraleve dhe të Bricjapit, strukturave të mëdha arkitektonike, me mistere Arkane të Bricjapit që ato i quanin "makara". Kjo është rruga e hershme e Kastriotëve, ndërtues të qytetit antik dhe rindërtues të Mesjetë.

Europa e njihte Skënderbeun jo vetëm si mbrojtësi i kristianizmit, por strateg, dijetar, lexues e mbajtës i simboleve të rralla me të cilat prezantohej në oborret mbretërore. Përkrenarja e tij shprehte më së miri motivet, kodin e familjeve princërore, cilësitë e fisnikërisë që zinin vend të rëndësishëm në zinxhirin e historisë së Europës. Përkrenarja e Skënderbeut është pjesa e pandashme e heroit, aq organike sa nuk ka figurë historike që mund të krahasohet.

Po citoj vetëm Niko Stylosin. Ai shkruan se në përkrenaren e Skënderbeut heroi i shqiptarëve dhe epirotëve kishte të veçantë brirët e cjapit, që gjithashtu i kishim në kokën e Panit (etrusk). Meqënëse Pani ose Albani, ishte i katërti i brezit të Pellazgut, i biri i tij Oineu (Ari) i pestë, dhe Aleksandri, që në shqip, por edhe në turqisht, i thonë Skënder, është i gjashtë. Në përkrenaren e Skënderbeut, të pasqyruar më lart, kemi dhe simbolin kësaj gjenealogjie, madje me 6 fletë. Kjo gjë, duhet të na shtjerë në mendime, qysh në ç'kohë shqiptarët humbën njohuritë e tyre historike, sepse e përjashtoj që simbolet e mësipërme të kenë hyrë rastësisht në këtë përkrenare. Sipas meje kjo bën fjalë për lashtësinë para antike, për shqiptarët e stërlashtë dhe shqipen e vjetër, heronjtë legjendarë ilirjanë deri te Gjergj Kastrioti.

Kodin e leximit dhe të shpjegimit të astronomisë e gjejmë të shprehur në mënyrën se si persona dhe dijetarë çidhnakë në kohra të hershme parashikonin kohën me diell, erërat, shiun, në shkallën e Diellit, pikërisht në shkëmbin ku u gdhend kalaja e Oenës. Kjo ishte vrojtuese, parashikuese, orientuese në sulm apo në mbrojtje, strategji e përdorur nga dibranët në kohra historike të ndryshme.

Më shumë për Skënderbeun do të njiheni në librin që do të botohet së shpejti.

Ese

Lypës të një fati të mirë

Nga **SAMET ZAGRADI**

Të shtrirë në tokë, të pashpresë dhe të përballur me vështirësinë e të shtyrjes së një dite. Të përlotur shpresëvenitur. Lot që prek ata që kanë zemër të prekën. Lot që lindi bashkë edhe që kurrë nuk i la që të shikojnë botën e pastër dhe të pamjegullt. Lot që kurrë nuk u thanë nga sytë e krijesave njerëzore më të pafat. Të diskriminuar deri në thellësinë më të thellë të palcës. Të strukur dhe të shtypur në fund të piramidës së shoqërisë njerëzore, ku maja e saj shtyp me forcë qindra njutonëshe, duke u thyer çdo shpresë atyre që janë poshtë. Të braktisur nga përkujdesi i të gjithëve, madje dhe i atyre qe i nxorën në vendin e padëshiruar nga askush. Prindër, që prindër nuk mund t'u thuash. Tutorë që mohojnë miliona të drejta, që shkelin qindra ligje dhe fitojnë qindra miliona para në shpinën e dhjetëra fëmijëve të pafajshëm. Statistika të frikshme, statistika që kuptohen dhe nga analfabeti më i madh në botë. Pikërisht ky realitet na shfaqet kudo që ne shkojmë. Sfondi ngjyrë gri shfaqet kudo. Ky sfond që përpara tij bëhen mëkate dhe pse nuk i intereson askujt.

Situatë e ftohtë, për ironi të fatit dhe mot i ftohtë. Ulur në cepin e tyre apo duke ecur në kryqëzime të pafundme drejt një qindarke. Tymi i skapamentove në semafor ngroh disi këmbët e zbathura. Xhama që ulen, injorim dhe raste-raste dhe ndonjë pështymë që del nga ajo shtresë që rri në majë të piramidës. Avuj që dalin nga gojët e futura në shallin e pambuktë, të ngrohtë dhe butësia e palltove të zeza bie në kontrast me realitetin. Këmbë të nxira nga i ftohti, foshnje të porsalindura në krahët e motrave apo vëllezërve pothuajse moshatarë për të krijuar tablonë më të shëmtuar që mund të shikosh. Foshnja thuajse të vdekura gjatë gjithë ditës, duke përdorur substancë shkatërruese për atë kategori moshe.

Prindër të pandërgjegjshëm apo tutorë të pashpirt. Prindër që mohojnë të drejta ligjore, morale dhe njerëzore. Vetëm emrin kanë prindër. Natyrisht, lind pyetja n.q.s. s'do të jenë këta prindër, si do të jetë gjendja? Ik nga shiu, përfundo në breshër, madje në furtunë. Në fund të rrugës i presin tutorët në patronazhin e tyre. Të gjithë i shohim, por askush nuk reagon. Askush nuk kujdeset për fatin e tyre, fat të cilin jam i bindur që kurrë në jetën e tyre s'do të kenë dëshirë ta kenë.

Rruga e Arbërit

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 2000 fjalë (12000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- **Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.**
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- **Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.**

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

Redaksia.

Rruga e Arbërit nr. 110

portret

Ne ballin e luftes ai nuk reshti nga 23 gushti 1943, kur la qytetin e Peshkopise dhe u bashkua me forcat e batalionit teritorial te Dibres deri sa u vra ne 8 korrik 1944, ku ne balle te sulmit komisari trim, te cilin populli e quajti ne kenget e tij te kreshnikeve „Luani i Dibres", qendroi ne kembe duke mos e perfillur vdekjen, qe megjitheate nuk e kurseu birin e Kolonjes

Stefan Luarasi, kolonjari që ra dëshmor në Dibër

Nga **GENCI LUARASI**

Ne Kolonje pranvera dhe vera vecanerisht, hyn me nje bukuri te vecante me lulezim dhe gjelberim, me nje klime te kendeshme dhe te shendeteshme, e cila i jep energji dhe force njerezve te cilet me forca te riperteritura nisin punet e stines. Si e tille Kolonja ka nje klime kontinentale me nje lartesi qe i kalon 1000 metrat nga niveli i detit, po te tille jane edhe kolonjaret njerez te forte qe i perballojne periudhat e ftohta te dimerit dhe kane kenaqesine ne stinet e riperteritjes, duke marre forca nga natyra. Nga ana tjeter jane njerez te forte, punetore , aresimdashes, por edhe mbrojtes te lirive dhe e duan vendin ku kane lindur. Ne stinet e ngrohta zakonisht punojne ne punet e bujqesise me te mbjellat, korrjen e te lashtave dhe te barit te luadheve. Nga kjo fjale rrjedh edhe emeri Luarasi kur hyn nga rruga e degezimit qe vjen nga Shen Mertiri, Clirimi i sotem e ngjitet lart ne ate fshat, pamja e te cilit sidomos ne vere e vjeshte eshte e bukur dhe i ngjet kraheve te hapur te shqiponjes. Edhe veshtrimi i njerezve eshte si ay i shqiponjes dhe kryesisht kane nje ngjyre te kuqeremte me nje forme te bukur te rregullt te kokes dhe nje trup te forte, qe perballon cdo veshtiresi.

Ne kete fshat gati 160 vjet me pare, aq sa e mbajne mend te paret lindi Stefan Kici, burre qe iu fal puneve te fese, i cili vdiq ne 1916 ne fshatin Zvirine te Korces. Ai pavaresisht se i bente punet e fese duke perkrahur edhe njerezit e pushkes per vatan u be armik me Kishen, pasi nuk ndiqte ne vitet 1893 urdherat e fese ortodokse te drejtuar nga Kisha greke qe dominonte ate treve. Nga ana tjeter psallte fjalet racionale te Zotit duke jetuar ne paqe me gruan e tij, qe i fali asaj familje 6 femije tre djem dhe tre vajza, nder ta me i permenduri ishte padyshim Kristo Papastefan Kici, i njohur me punet e tij Kristo Luarasi, i cili mori rrugen e kurbetit pasi u mbyllen nga Perandoria Turke shkollat shqipe ne ate treve..Per ate eshte folur shume sidomos keto vitet e fundit, por theksojme se krahas tij u rrit dhe i qendroi afer edhe njeri nga vellezerit Lluka Papastefan Luarasi, i cili e ndiqte te vellane ne rrugetimin e tij. Keshtu fillimisht ne moshe rinore i vajti pas ne Sofje te Bullgarise duke punuar ne cfaredo pune kryesisht ne pune te rendomta dhe te veshtira dhe me vone mori rrugen e kurbetit ne SHBA ku punoi ne shtrimin e rrugeve dhe kontribuoi ne Shoqerine patriotike Vatra. Ai kurdohere me shpirtmadhesi, pavaresisht se punonte puntor krahu e kalldremshtrues ne rruget e Sofjes dhe te Bostonit, kishte deshiren te bente ndonje darovi. Keshtu sa here qe ishte nevoja krahas shqiptareve te tjere jepte parane per te miren e aresimimit dhe te botimeve shqipe. Gjithashtu per Shpetimin e Shqiperise ai bashkohej me patriote te tjera te Vatres ne Boston me kryetar Kol Tromaren, sekretar Ndreko Stavro dhe arketar Goni Katundi e nuk ndahej nga Atdhetaret e tjere duke dhene kontributin prej 20 Dollare amerikane me 3 Qershor 1912. Por, nga ana tjeter kishte nje zemer te madhe, theksoj se shume vite me vone i mbetur i ve dhe i vetem, kur jetonte ne Korce erdhi ne shtepine tone ne Tirane kur isha vetem 14 – 15 vjec, ndersa ai tashme ishte nje i moshuar, me nje trup te ngjeshur i holle, i drejte si nje lis me nje fytyre simpatike, nje burre i urte, i qete qe rezatonte miresi edhe ne se shpirti i qante se kishte mbetur i vetem. Ai erdhi ne Tirane, pasi kur ky njeri i forte dhe i qete kishte humbur familjen e tij: gruaja i vdiq e vojtur ndersa i biri si produkt i prinderve te tij kishte perqafuar ne rinine e tij idete e njeriut te lire dhe idealet, per nje bote te lire te shoqerizuar ne nje barazi idealiste te nje populli te lire me te drejta sic shtrohej ne idete e komunisteve te asaj kohe. Xha Llukai sic e therisnin kurdohere me respekt pasi beri nje fare prokopie vendosi qe t'i thoshte mjaft kurbetit dhe u kthye ne vendlindje, jo ne Kolonje, por u vendos ne Korce dhe gjeti fatin e tij duke ngritur shtepine dhe u martua me Marien. Krye vitit 1913 atyre u lindi nje djale i qeshur, i fuqishem, i cili ne moshen e femijerise, vazhdoi shkollen fillore dhe mandej ne 1927 Liceun Frances te Korces, ku ne saje te njohjes me militantin e Grupit te Korces Ali Kemendi, keta krijuan nje celule ne vitin 1935, me shoke si Misto Treska, Ptoleme Xhuvani,Vasil Nathanailin,



STEFAN LL. LUARASI (1931 - 1944)

Raqi Qirinxhi, Stefan Luarasi, Fuat Babani, te cilet sipas udhezimit te Grupit komunist punuan dhe perkthyen „Manifestin e Partise Komuniste", te cilin e perfunduan ne vigjilje te Demostrates se Bukes, ku liceistet perparimtare u bashkuan me protestuesit ne radhet e para te te cileve ishte edhe Stefani. Kjo si pasoje solli qe ta paralajmerojne per perjashtimin e tij nga shkolla, por ai nuk u terhoq. Ai ishte nje djale i respektuar, i qete dhe nje sportist i dalluar si gjimnast dhe skijator. Vende si Guri i Capit, Bradvica, Ivani, Gramozi dhe Bozdoveci ishin stacionet e dashura ne sportin e skive, ku ai me shokun e tij Vaske Dushku jane nder skiatoret e pare te vendit, por sidomos dallohehej per pasionin dhe rezultate te larta ne mesime sidomos ne matematike dhe fizike, pra ai dallohej ne dy cilesi te vyera, shoqerizimin me shoket dhe rezultate e pasionin per aresimimin e tij. Kjo vihet re edhe nga nje leter shume intime derguar kusheririt te tij, i cili shume vite me vone me kerkese te xha Llukait, kur Stefanaqi nuk jetonte me u be vellai i tij , i biresuar nga ungji i tij, te cilin ne vitin 1930 me mbarimin e Universitetit ne Sofje e uron me shprehjen „La e me la nipi im Thoma." Ne leter me mbarimin e shkolles se mesme, Stefani i drejtohet kusheririt te tij Thoma me nje kerkese te cilter, por me insistim qe mundesisht me njohjet e tija institucionale te mundesonte per nje te drejte studimi per mesuesi. apo degen e pergatitjes fizike, sepse dallohej edhe si nje sportist-gjimnast ne vitet e shkolles. C'eshte e verteta Thomai u mundua me ate personalitet e respekt qe gezonte ne administraten e kohes, por arriti te siguronte vetem nje te drejte studimi per ne Itali per mjekesine veterinare. Ne fakt kjo nuk i pelqeu, por deshira per shkollim te metejshem beri qe te pranoje kete dege edhe kunder deshires, e pasionit. U nis per ne Torino dhe kreu vitet e studimit dhe diplomimit te tij. Torino dallohej si nje qytet me nje mjedis perparimtar sidomos ne qarqet studentore ndaj ideve te majta dhe shume komuniste vijne nga ai qytet dhe rrethet rinore te tij ku edhe Stefoja pati jo vetem kontakte, por u perfshi ne ate ortek te idealeve te majta, aq shume sa kur u kthye nga studimet ne fillim te viteve 1940 u vendos ne Tirane, ku punoi disa muaj prane Laboratorit veterinar ne zyren e veterinarise, ai shpesh vinte ne shtepine tone dhe ne bisede e siper hapte tema te tilla edhe me prinderit e mij sidomos me nenen time duke krijuar debate te fuqishme jo gjithmone te miratuara ndermjet bashkebiseduesve.Per vete karakterin e pergatitjen e tij ideologjike ai behet i padesheruar dhe emerohet ne Sarande, ku autoritetet mendonin se do t'a izolonin, por perkundrazi veprimtaria e tij u rrit me shume kur per veprimtarine e tij me forminin e celules komuniste ne vitin 1942 u pranua ne radhet e partise. qe e konsideronte si nje nder te madh, per te cilin thoshte: „ Mu, dha nje besim i madh, te cilin duhet ta justifikoj.." qe e justifikoi me pune aq sa per veprimtarine e tij ai arestohet dhe sillet ne burgun e Tiranes.

Vitet 1939- 41 ishin vitet e pushtimit fashist italian, qe shfrytezuan potencialin e tyre njerezor,

> Populli i Dibres e kujton gjate ketyre viteve komisarin e cetes se Slloves, sy patrembur, jo vetem ne bisedat me veteranet por edhe me perjetesimin e tij me bustin e ngritur ne Spitalin e Peshkopise ne shenje respekti dhe nderimi per djalin e Kolonjes qe sakrifikoi jo me fjale por me vepra lulen e jetes se tij.

poziten politike ne Europe, kishin nje udheheqes si Musolinin, i cili kishte delirin e madheshtise dhe kerkesen te qendronte ne krah te udheheqesit gjerman Hitlerit, te dy me bindjen se do te neneshtronin dhe .drejtonin Boten. Raporti shume i zhdrejte sasijor me Shqiperine iu dha mundesine ta pushtonin Shqiperine, e cila sapo mundohej te hynte ne Boten moderne te shtetit ligjor, por pa u zhveshur akoma nga petku feudal! Por pavaresisht nga kjo pushtuesit nuk kishin llogaritur aspektin idealist dhe te mos neneshtrimit te popullit, i cili arriti te nxjerre nga gjiri i tij udheheqesit politike e ushtarake qe me guxim morren pergjegjesine t'i benin balle ketij pushtimi. Mjerisht bijte e popullit shqiptar duhej t'i benin balle pervec armikut te jashtem edhe qeverive te brendeshme shqiptare, te cilat me politiken e tyre i u kundervune aspiratave liridashese te popullit, me motivin e kundervenies se tij ndaj fashizmit italian. Lajmin e hidhur te burgosjes beri qe xha Llukai, te ngrihet nga Korca dhe erdhi ta ndaje me nipin, duke iu lutur qe te gjente ndonje mundesi per t'a liruar te birin nga burgu duke qene nepunes ne Ministrine e tokave te Liruara. Rruge tjeter s'kishte dhe Thomai, pasi u takua me Mustafa Krujen ja shtroi kerkesen, i cili pasi e degjoi i tha:

„E keni nip te gjakut tuaj dhe e kuptoj nderhyrjen, por dijeni se edhe po t'a nxjerr shume shpejte do te perfundoje edhe me keq, pasi eshte nje element i bindur thellesisht ne ideologjine e tij, prandaj me mire te qendroje brenda per ca kohe qe te mos rrezikoje jeten e tij me qendrimin e tij antitalian!" Mundesine e lirimit te tij, Stefoja i u pergjegj me gjestin e mospranimit te daljes i pacenuar nga burgu dhe te linte nje hije dyshimi tek shoket e tij te „idealit" keshtu qe pas nje kohe , per mungese provash u detyruan ta lirojne vete. Duke e lene papune per nje fare kohe, por si nje specialist ishin te detyruar t'i gjenin pune ne profesionin e tij, e emeruan ne Diber me qender ne Peshkopi, por edhe atje e gjeti shume shpejte vetevehten, per te shpalosur idealet. Celula e partise e krijuar rishtas, u zgjerua , duke hyre edhe ne karabineri dhe rojen italiane te finances. .Ne shtepine e Nazmi Rushitit ai u be djali i tyre, ku ju njoh trimeria, burreria, goja e tij e embel, prandaj e donin dhe e respektonin. Keshtu qe prirjet e tija, qendrimi parimor i idealeve te komunizmit ndikuan qe shume shpejte te spikaste ne punen dhe luften e strukturave antifashiste dhe u inkuadrua ne forcat partizane te Dibres, ku punoi dhe luftoi per clirimin e Peshkopise dhe nga ana tjeter beri nje pune te madhe propagandistike ne masat e rinise dhe te popullit duke terhequr ne anen e struktuarave partizane shume simpatizante dhe luftetetare. Nga ana tjeter edhe vete ne momentin e duhur kur qenia e tij po rrezikohej u hodh ne ilegalitet dhe u inkuadrua ne forcat e partizaneve te Dibres, duke marre detyra te rendesishme, fillimisht si zv/komisar i Cetes se Slloves dhe me vone si komisar i atij formacioni partizan. Ketu spikati figura e tij jo vetem si nje udheheqes shpirteror i forcave ushtarake , por sidomos per rolin e ngritjes ideologjike te mases se partizaneve. Gjithmone i thjeshte, gojembel por konseguent punoi dhe luftoi brenda strukturave teritoriale te forcave partizane te Slloves. Figura e tij u rrit sidomos ne pjesen e pare te vitit 1944, kur u ndermoren nje sere veprimesh te rendesishme luftarake, qe perfunduan me clirimin e Peshkopise dhe izolimin e forcave pro italiane dhe gjermane. Ne ballin e luftes ai nuk reshti nga 23 gushti 1943, kur la qytetin e Peshkopise dhe u bashkua me forcat e batalionit teritorial te Dibres deri sa u vra ne 8 korrik 1944, ku ne balle te sulmit komisari trim, te cilin populli e quajti ne kenget e tij te kreshnikeve „Luani i Dibres", qendroi ne kembe duke mos e perfillur vdekjen, qe megjitheate nuk e kurseu birin e Kolonjes

Por ne vigjiljen e perfundimit te luftes Nacional-clirimtare ne Fushe Alije ne korrik 1944 po zhvillohen ngjarjet e bujshme ne mes forcave partizane dhe atyre proqeveritare dhe mbeshtetesve te tyre te Halil Alise. Beteja ishte shume e ashper me zenie e leshime pozitash, por ne fund triumfuan forcat partizane, pavaresisht se ne ate periudhe partizanet paten mjaft humbje, nder ta edhe i riu 31 vjecar nga Korca, sypatremburi, biri i Kolonjes Stefan Luarasi. Ne ate beteje rane edhe zv/komandanti i cetes, gojembeli i cetes nga Kalisi, Hasan Luma, qe aq bukur i fliste popullit me gjuhen e tij, Demir Gashi, nga Dibra e madhe, Riza Doda nga malet e thella te Recit, i cili i etur per aresim vajti deri ne Gjirokaster te beje shkolle, sidhe partizanet nga fshatrat e Dibres Man Jella, Abaz Ndreu, dhe Ismail Caka. Bukur e pershkruan Haki Stermilli, momentet e vrasjes se ketyre herojve ne kujtimet e tija" Shtigje te luftes".

„ Me daten 27 Korrik 1944 ka ardhur ketu Baba Faja. Mora vesh se ne luftimet, qe u zhvilluan dy-tri jave me pare ne rrethet e Peshkopise paskan rene deshmore veterineri Stefan Luarasi e Demir Gashi, dy djem shume te mire.... Stefani e Demiri, njeri nga Korca dhe tjetri nga Dibra, qene dy fatosa"

"Te gjithe kane mare pergjegjesira te ndryshme ne ushtri dhe jane gradue. U gezova shume kur i pashe por ne ane tjeter me kaplloi nje fare trishtimise ne mes tyre s'ishte ma Riza Doda , Stefan Luarasi , Demir Gashi... e shume te tjere, qe rane deshmore per realizimin e fitores".....(19.9.1944)

Lufta e Fush-Alise ishte shume e ashper, per te asgjesuar forcat armike dhe mercenaret e tyre, por gjithashtu aty dheu u pergjak nga bijt e popullit, te cilet idealet e tyre i flijuan per lirine e vendit. Me 8 korrik 1944, sebashku me partizane te tjere dha jeten edhe Komisari i cetes se Slloves Stefan Lluka Luarasi. Populli i kendoi:

...."Pushke e bombe beteja plasi,.. Shume lufton Stefan Luarasi"

Keto rrjeshta sintetizonin fuqishem jeten e kaluar ne lufte te paepur per lirine e Atdheut e te popullit liridashes, nga intelektuali i cili luftoi qe ne moshen shkollore kunder tiranise se pushtuesve nazi-fashiste dhe ra duke u perpjekur te shpetonte jeten e partizanit te cetes se tij, gjate kesaj perpjekje mori plumbin ne gjoks. Vdekja e tij ishte sinteza e jetes se tij perpjekjeve per t'u aresimuar dhe per t'i sherbyer popullit te tij packa se nuk arriti te vazhdoje degen qe desheronte, por nuk u ep, dhe si doktor veteriner ai kontriboi per nje jete me te mire. Edhe gjate studimeve ne Torino te Italise, ai diten e zeze te 7 Prillit 1939 u a perplasi studenteve italiane:

"Sot po u thyejme hundet e po u hedhim ne det. Neser do t'ua marrim shpirtin. Populli nuk eshte gjunjezuar kurre perpara armiqve te shumte shekullore te tij" Italianet e terbuar nga guximi i studentit shqiptar, e rrethuan per ta goditur por iken te lemerisur nga grushtet e Stefanit, ata nuk e njihnin kete atlet, i cili qe ne shkolle tregoi vyrtyte te vecanta guximi e force edhe ne saje te pergatitjes fiziko-atletike.. Sipas bisedes se shokut te tij te institutit ne Torino, Myslym Selenica bashkestudent ai kujton se si Stefan Luarasi i rrethuar nga 5-6 studente ne grindje e siper nga studentet pro-fashiste, te rrethuar te dy nderhyri shokut te tij gjate grindjes me ta , i thirri Myslymit: „ Jo me cader, por ketij qeni i tregoj une fytyren e felliqur qe ka" duke e goditur njerin me grushtin e tij te forte dhe beri qe te zhdukej nga syte kembet Pas mbarimit te shkolles dhe diplomimit si mjek-veteriner, ai pas kthimit ne Shqiperi, nuk u pajtua asnjehere me pushtimin fashist, por edhe atje ku punoi ne Sarande zyren

e tij dhe thertoren e ktheu ne nje fole te punes ilegale te krahines, megjithese aktiviteti ra ne sy te autoriteteve pushtuese dhe sherbetoreve te tyre duke e survejuar gjate kohes qe qendroi atje. Jemi ne shkurt te 1942, kur Stefani 29 vjecar pranohet ne radhet e Partise, duke shtuar aktivitetin e tij, gje qe shkaktoi burgosjen e tij ne burgun e Tiranes. nderkohe qe jeta ne qeli e kaliti edhe me shume karakterin dhe urrejtjen e tij per armiqte, te cilet u detyruan t'a lirojne por e lane pa pune per nje periudhe, e mevone e rimarin por duke e internuar ne Diber me qender ne Peshkopi. Por atje ne vend qe ta gjunjezonin i dhane forca me te medha organizative, pasi gjeti nje mjedis, sidomos duke punuar per te ndergjegjesuar dhe shtuar organizaten e rinise duke punuar si propagandist dhe revolucionar per grupin e simpatizanteve, ne mbledhjet e te cileve shtroheshin e diskutoheshin problemet e kohes per clirimin e vendit. Guximi i tij ishte i atille sa qe ai shprehej hapur edhe para autoriteteve qe te kthenin rruge sa nuk ishte vone, pasi ndryshe do te vinte dita qe te jepnin llogari perpara popullit. Sigurisht nje menyre e tille solli si pasoje qe te arrestohej, komunisti rebel e guximtar, por nuk ia arriten dot pasi i ruajtur u lajmerua dhe u arratis ne formacinet luftarake te malit fillimisht ne batalionin partizan te Dibres si zevendes komisar i cetes se Slloves dhe me pas morri detyren e Komisarit te kesaj njesie. Intensiteti i luftes partizane sa vjen e rritet, jemi ne muajt e fundit te pushtimit, por me kapitullimin e Italise fashiste nje force me e eger marshoi ne trojet tona forcat ushtarake naziste gjermane, te cilet nje nga drejtimet e levizjes e spastrimit ishte edhe rruga Tirane – Diber, ku partizanet bene nje lufte heroike kunder mercenareve dhe forcave gjermane qe pati epilogun me 8 Korrik 1944 ne luften e Fushe-Alijes ku pati shume bij shqiptare te vrare, nder ta permenden edhe Stefan Luarasi me shoket e tij qe bene emer si Demir Gashi, Riza Doda, Hasan Luma, Meriman Jakupi. Vdekja e tij ndodhi ne momentin kur Stefani pa perpara vehtes nje nga shoket partizane te goditur dhe sic ishte versulet dhe e merr ne shpine per ta shpetuar, nderkohe qe plumbi e goditi, djalin 31 vjecar, birin e Kolonjes lule, i cili ne kembe mori plumbin qe i mori jeten.

Populli i Dibres e kujton gjate ketyre viteve komisarin e cetes se Slloves, sy patrembur, jo vetem ne bisedat me veteranet por edhe me perjetesimin e tij me bustin e ngritur ne Spitalin e Peshkopise ne shenje respekti dhe nderimi per djalin e Kolonjes qe sakrifikoi jo me fjale por me vepra lulen e jetes se tij, duke lene jetime prinderit e tij, mbyllur shtepine e xha Llukait, vdekjen e parakoheshme te nenes se tij Marise e cila bente , c'bente dhe ne varrezat e Korces ku ai prehet sot, i conte nje tufe me lule. Por krahas nderimit per deshmorin Stefan Ll. Luarasi i dekoruar gjate viteve 1946 -1952 me gjashte Medalje, si e Trimerise tre here, e Kujtimit 1942 – 43 dy here Urdherin e Flamurit akorduar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor u la ne harese familja e tij, te ciles nuk iu njoh sakrifica ne shkallen e duhur te bere nga deshmori Stefan Luarasi, i cili sot prehet ne varrezat e deshmoreve te Korces., qe per deshmoret, invalidet e luftes Na-Cl. dhe Patrioteve te Rilindjes Kombetare i u dha mbeshtetja minimale financiare, duke e klasifikuar si partizan i thjeshte, pa mare parasysh detyren e tij ne lufte dhe kontributin gjate viteve 1942 - 1944, kjo pasi i jati ishte invalid i sakatosur ne pune dhe nena e semure., ketyre njerezve zemer thyer te urte qe nuk i kerkuan kurkujt asgje, sic e thekson edhe Haki Stermilli ne kujtimet e tija. Ne nderim te tij Populli i Korces e perjetesoi me emertimin e nje rruge me emerin e tij, e cila ndodhej afer Mitropolise por meqenese per aresye konjukturale duhej te mbante emerin e nje autoriteti te larte kishetar, e zhvendosi me tej, por nuk e harroi. Gjate viteve nder aktivitetet sportive emeri i tij u perjetesua edhe ne organizimin e nje manifestimi sportiv sic ka qene „Kupa Stefan Luarasi" ne futboll. Sigurisht, sot ne kete 70 vjetor te Clirimit te Shqiperise nga okupatoret e jashtem dhe armiqte e brendeshem, eshte detyre e Komitetit te veteraneve te marin inicuiativen ne Qarkun e Korces dhe ne Kolonje qe per keta bij deshmore te kujtojne jo vetem me fjale por edhe me kujtese te ndonje emertimi rruge ne Erseke, apo te ndonje objekti social –sportiv vepren e pavdekeshme te bijve te tyre, ndryshe vepra e jeta e tyre aq me teper qe rane jashte vendlindjes se tyre do te harohet nga mosmirenjohja.

Një dekadë pa Musa Piperkun

Nga **ARSIM KOLARI**

Ubënë 10 vjetë prej se u nda nga mesi ynë kompozitori i madh, Musa Piperku. Ashtu siç qe, i ndershëm, i përkushtuar, i pastër, i qetë, i matur, i hijshëm, punëtor e doreartë, i tillë ngelet edhe sot, në syrin e vëllezërve dibranë, por edhe të mbarë shqiptarisë. Jo më kot u dallua shumë shpejt, si kompozitori më i përkryer në tre zhanre muzikore. Musai u lind në Dibër të Madhe, trevën e diturisë dhe burrërisë, ku dhe kreu shkollimin fillor, për ta vazhduar atë të mesëm në Prizren dhe në Akademinë muzikore të Beogradit. Dashuria dhe obligimi moral për vendlindjen, e shtyu që pas mbarimit të fakultetit të kthehet e të kontribuuon në ngritjen e kulturës muzikore në qytetin e lindjes, Dibër. Po në këtë periudhë, merr iniciativë dhe e krijon orkestrin e parë dibran.

Kultura dibrane kulmin dhe avancimin e arrin me kontributin e të madhit Musa Piperku, pikërisht me Shoqërinë Kulturore e Artistike "Liman Kaba". Me këtë shoqëri pat komponuar mjaft hite, siç kemi: "Bukuri në Shqipëri", "Trim o Skënderbe", "Se Shqipëria nuk do tjetër", etj., nën interpretimin brilant të Sulejman Borovës, Violeta Turkeshit, Haxhi Maqellarës, Bashkim Paçukut, e mjaft të tjerë. Sukseset për Musain morën përpjetën në momentin që nisi punën në Radio Shkupin, e më vonë edhe në Radio Prishtinën, ku si bashkëpunëtor pat edhe bashkëqytetarin e tij, kompozitorin e dalluar, Nazim Kaba. Bashkë me Nazimin krijoi mjaft melodi të reja, libra shkollorë për artin muzikor, ndërkohë që organizonin manifestime të ndryshme, me çrast i prezantonin veprat e tyre. Musai mori pjesë në shumë edicione të "Akordeve të Kosovës", ishte pjesëmarrës nëpër festivale të ndryshme, duke radhitur në sirtarin e tij mjaft çmime e mirënjohje. Janë rreth 600 këngë të krijuara nga ai vetë, siecila më e suksesshme se tjetra, e po t'i gjurmosh nga afër, ato për mbrenda përmbajnë melodi freskuese me elemente përtej së bukurës, andaj e gjithë kjo arrihet atëherë kur artisti di të zgjedhë dhe të punojë me vullnet e shije.

Dashuria dhe respekti që pat Musai për botën fëmijërore nuk ka laps që e përshkruan, ai fëmijët i cilësonte si lule që duhen kultivuar, fundja, lule të shëmtuar në botë nuk ka, ato janë gjithëçfarëshe e shumëngjyrëshe dhe deshi apo nuk deshi fëmija, këngën e ofruar nga Musai duhej ta performonte në mënyrën më profesionale, e për nxitje, Musai punoi këngën "O ju moj lule":



"Ju moj lu-le moj bur-buqe
Qof-shi t'bar-dha qof-shi t'ku-qe
O ju moj, lu-le lu-le të ma-lit,
A-ro-më i dha-shi gjith fes-ti-va-lit".

Për moshën rinore krijoi me qindra këngë, të cilat i sollën artistët më në zë, si: Nexhmije Pagarusha, Sabri Fejzullahu, Liliana Çavolli (e ndjerë), Shpresa Gashi, Besnik Krajku, e mjaft të tjerë. Këtu mund të përmendim këngën emblemë "Këngë moj", e cila autor kompozimi ka vetë Musa Piperkun, e kënduar nga artisti i njohur i muzikës së lehtë, Besnik Krajku, i cili për Musain thotë: "Me Musain jam njohur në vitin 1973-74 në fillet e mija si këngëtar i muzikës së lehtë. Në takimet që i organizonim në Radio Prishtinën, ai i evokonte kujtimet e tij nga Prizreni, prej nga unë vija. Bashkëpunimi ynë i parë u realizua në vitin 1980 me këngën "Këngë moj", e cila arriti sukses të madh dhe u bë këngë emblematike shqiptare. Pas këtij suksesi, vazhdoi bashkëpunimi me këngën "Roberto, dashnor I vërtetë", me të cilën mora pjesë në festivalin e Opatisë, dhe projekti tjetër ishte kënga qytetare "Prangat e kujtimit", që me të cilën konkurova në Zambakun e Prizrenit. Veprat kolosale të Musa Piperkut janë regjistruar dhe do mbesin trashëgimi e muzikës shqiptare, ndërsa mirësia, bujaria e dashamirësia kanë ngelur në kujtesën time dhe të atyre që e njohën. Jam krenar që e njoha dhe punova me të!".

Si kjo vepër e përjetshme, Musai ka edhe shumë të tjera, është kënga "Floriana", dedikuar vajzës së tij Florianës, e kënduar në vitin 1973 nga simboli i kulturës shqiptare (siç e quajti ai), Liliana Çavolli.

"Flo-ra Flo-ra thirr-je ti
Flo-ra Flo-ra da-shu-ri
Flo-ra Flori-ana i-me
O sa for-t të du"

Vetë Liliana pat theksuar se, njëri ndër faktorët që ka ndikuar në ngritjen e saj, qe Musai dhe se shkaku i këngës së Musait "Floriana" i ka adhuruar të gjitha vajzat me emrin Flora dhe Floriana. Gjithashtu, Musai komponoi edhe këngën duet mes Lilanës dhe Nexhmije Pagarushës "Perëndeshë e bukur je".

Me të madhen Nexhmije Pagarusha punoi mjaft, e si krijime më të veçanta mund të përmendim këngët "Kosovarja e bukur" dhe "Për ditëlindje". Po këtë periudhë, Musai komponoi këngë për Bashkim Bicurrin, Mentor Vokshin, Sabri Fejzullahun, etj. Me këtë të fundit pat një bashkëpunim të përkryer, e sapo e përmendim emrin e Musait, na asocon menjëherë hitin e Sabri Fejzullahut "Pranvera në Prishtinë", punuar në vitin 1978. Sabriu, pyetur mbi bashkëpunimin e tij me Musain, në bisedën telefonike fillimisht qesh dhe thotë: "Akoma s'e keni të qartë se unë me Musain kemi qenë më shumë se bashkëpunëtorë?! Këngët që m'I ka komponuar ai, me të gjitha jam shpërblyer me çmim të parë, dhe mund të kujtoj se me këto këngë kemi marrë shtatë Okaina të arta. Musai më ka dhuruar shumë hite të paharruara, ai është kolosi i muzikës mbarëshqiptare, një Musa vdiq ,e një i dytë nuk ka për të lindur!". Kur bëhet fjalë për këngëtaren e pakrahasueshme pejane, Shpresa Gashi, asaj Musai i pat komponuar shumicën e këngëve të repertuarit të saj. Mund të kujtojmë këngët rrufe "O bilbil flatrat me vesë", "Kënga shpirtin ma rëmben", me tekst të Eqerem Bashës, tekstshkruesit dibran. Ndër shumë kujtime të arta, Shpresa na veçon: "Pikë së pari, Musai ishte një njeri i ndershëm, një zotëri i pashoq, mbi të gjitha ishte me kulturë qytetare e kombëtare. Musai si kompozitor la gjurmë të thella me veprat e tij që e identifikonin vetë atë dhe muzikën shqiptare. Komponimet e tij identifikohen me timbrikën e këngës kosovare, e cila asokohe dallohej nga trevat e tjera. Këngët që m'i komponoi Musai, ishin më të dashurat për mua dhe më të dëgjuarat e publikut".

Ndër krijimtaritë më të reja të Musait, kemi librin muzikor për shkollat fillore "Tingujt muzikor", por ai deri në fund të jetës punoi e krijoi në tri sfera muzikore: atë zbavitëse, popullore dhe muzikën për fëmijë.

Puna e tij, veprimtaria e tij, vlerat e tij, bukuria e tij, pastërtia e tij, vendosshmëria e tij, morali i tij, edukata e tij, civilizimi i tij, sot e kësaj dite nderohen dhe kujtohen me mall nga familjarët, bashkëqytetarët, bashkëpunëtorët, nxënësit dhe gjithë ata që e njohën dhe ndjekin rrugën e tij. I përjetshëm do jetë kujtimi për të!...

Profesor Mois Cami, mësuesi dhe edukatori ynë i dashur

(Vijon nga faqja 20)

Nëse do të ulesha edhe një herë në bankën e shkollës pedagogjike të Peshkopisë, do të doja me admirim e nostalgji klasifikimet e përkufizimet biologjike të profesor Moisit (në parantezë: shkenca është përkufizime) dhe çlirtësinë e klasës në mjediset jashtë mësimit me profesor Moisin; kënaqësinë që ndienim ne me ato shpjegime aq tërheqëse e aq formuese të profesor Zenel Sulës; sqimën e piktorit dhe të profesorit tonë të vizatimit e të punëdores, Andon Lakuriqi; zhdërvjelltësinë e shkathtësinë që nxiste e krijonte te ne mësuesi i kulturës fizike, profesor Bexhet Shehu e për pak kohë, para tij, profesor Dan Doçi; fizikën e profesor Hasan Kadukut; përdorimin aq sistematik të dërrasës së zezë nga profesor Ismail Erebara në aritmetikë racionale, stereometri etj. (në parantezë, po ta fotografoje dërrasën e zezë pas mbarimit të orës së mësimit, tërë shpjegimin do ta gjeje aty e më mirë se në faqen e librit); stilistikën letrare të profesoreshë Julia Levanit, që na e zgjeroi shumë kuptimin për fjalën dhe përdorimin e saj; rregullsinë e profesor Jorgji Sinjarit në kontrollin e dijes në lëndën e historisë; shpjegimet e holla të profesor Masar Kasharit për "Tartufin"; solfezhin e violinën e profesor Munir Shehut; elegancën e profesoreshë Nevrez Manjanit, intonacionin e saj melodioz e kumbues dhe shpjegimin e saj aq të rrjedhshëm në gjeografi; qetësinë e përqendrimin e profesor Osman Uliut në lëndën e gjuhës; citatet nga pedagogë të mëdhenj botërorë, të shkruara me një kaligrafi të veçantë nga profesor Sotir Temo në skeda të vogla e të mëdha (sipas madhësisë së citatit), të prera artistikisht, të cilat na i lexonte në lëndën e historisë së pedagogjisë; mësimet aq frytdhënëse të profesor Sabri Vraniçit në lëndën e higjienës; komentet letrare të profesor Shefki Hafizit në letërsi të huaj; përmbledhjen e shpjegimit me pika, mu si pikat e planit në një hartim letrar në lëndën e pedagogjisë, rusishten tek teksti "Zoja Kasmademjanskaja" dhe bisedat për futbollin të profesor Shemsi Manjanit; analizat e rrepta morfologjike të profesor Veiz Karagjozit në lëndën e gjuhës.

Të tillë ishin pedagogët e shkollës pedagogjike të Peshkopisë. Ata kishin në mendje dhe në zemër misionin për të na profesionalizuar për mësuesí ne të gjithëve, të gjithë nxënësit e pedagogjikes. Dhe sollën te ne tërë formimin e tyre universitar. Nxënësi i pedagogjikes dinte matematikë e biologji; letërsi e vargje të tëra përmendsh; gramatikë e sintaksë të shqipes; psikologji e parime pedagogjike; histori e gjeografi botërore; punë bujqësore e punëdore; e, edhe vizatim e violinë. Por ai duhej të dinte edhe të tjera e të tjera; për shembull, edhe të vallëzonte, edhe të këndonte këngë të muzikës së lehtë e të muzikës popullore. Sepse do të bëhej mësues. Mbase, është rasti të thuhet që në klasën tonë (atëherë, III A), të gjithë nxënësit kishin blloqe xhepi me tekste këngësh. Si qe zanafilla? Fare e thjeshtë, por shumë e vlershme. Një shoku ynë, nga Mati e kishte bllokun plot me këngë të muzikës së lehtë, që jepeshin në radio ose që këndoheshin në estradën e Peshkopisë.

Duket, e kishte pasur hobi. Në një bisedë të lirshme, si gjë të zakonshme, ia tha mësuesit kujdestar, profesor Moisit. Profesori e kapi fillin menjëherë. "Shumë mirë ke ba, - tha. Do të të duhen kur të shkosh mësues në fshat, bile t'ua mësosh edhe të tjerëve atje." Kaq u desh. Fjala e profesorit ishte flori për ne. U mbushën blloqet. Meloditë nuk i kishim problem. I kishim ngulitur aq shumë në mendje, sa mund t'i merrnim edhe me fishkëllimë.

Nuk duhet harruar, ishin fundvitet '50 të shekullit të kaluar. Ende s'kishte radio në fshat; por, ndoshta, as në të gjitha familjet qytetare. Ne do të bëheshim mësues e mësuesi duhej t'i dinte e t'i bënte të gjitha. Mësuesi duhej të çonte në fshat edhe dijen, edhe këngën. Ishte porosi e mësuesit kujdestar, e profesorit të kimisë dhe të biologjisë, e profesor Mois Camit.

Pas disa vjetësh, profesor Moisi u bë drejtor i shkollës së mesme bujqësore "Nazmi Rushiti" të qytetit të Peshkopisë (një shkollë e madhe, për të gjitha rrethet e Veriut), shef i seksionit të arsimit të rrethit të Dibrës, deputet i Kuvendit Popullor. Por ai mbeti mësuesi ynë. Sepse qe mësuesi ynë.

- **Mendoni për arsimimin e fëmijëve tuaj ?**
- **Kurseni pak që fëmijët tuaj të bëhen të aftë e të ditur për të ardhmen e tyre.**
- **Gjeni shkollën e akreditуar me mjedise të bollshme e bash-këkohore.**
- **Me staf akademik të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit.**
- **Me çmime më të lira në treg.**
- **Me transport të garantuar**

Këto ua siguron vetëm Institucioni i Arsimit të Lartë:

Kolegji - College

IP INTERNACIONAL PRIZEREN

Programe studimi BACHELOR në:

1- EKONOMIK

Banka, Financa dhe Kontabilitet

2 - JURIDIK.

Regjistrimet për vitin akademik 2015-2016 kanë filluar.

Bëhuni pjesë e eksperiencës së studimit, kërkimit shkencor, praktikave profesionale dhe projekteve.

Ne ofrojmë teori, praktikë, profesionalizëm!

Kolegji - College

IP INTERNACIONAL PRIZEREN

- **Tarifa për studentët shqiptarë 1000 euro për një vit akademik. Kjo e ndarë me këste, ku 300 euro ditën e regjistrimit, kurse për çdo muaj nga 70 euro.**
- **Transport i garantuar.**
- **Bursa të plota studimi për studentët e mirë**
- **Bursa për studentët në nevojë**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Republikën e Kosovës, duke parë e vëzhguar nga afër mjediset e universitetit ka arritur në konkluzionet se Universiteti i zbaton të gjitha kriteret e licencimit:

- **Ka infrastrukturë fizike dhe pajisje teknologjike që afrojnë kushte të mira për zhvillimin e procesit mësimor,**
- **Ka kuadër të kualifikuar për mësimdhënie në arsimin e lartë,**
- **Ka dokumentacionin e kompletuar sipas kushteve të vëna në udhëzimin përkatës administrative të MASHT,**
- **Ka plane mësimore dhe programe të studimit që i plotësojnë kërkesat themelore për punë cilësore të këtij niveli**

Pas këtyre konstatimeve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Republikën e Kosovës vendosi Të akreditojë Kolegji Collegre IP INTERNACIONAL PRIZEREN në programe studimi BACHELOR për:

1- EKONOMIK, Banka, Financa dhe Kontabilitet

2 - JURIDIK.

Regjistrimet për vitin akademik 2015-2016 kanë filluar. Bëhuni pjesë e eksperiencës së studimit, kërkimit shkencor, praktikave profesionale dhe projekteve.

Ne ofrojmë teori, praktikë, profesionalizëm!





Kontaktoni

Në Kosovë: **Tel +377(0) 45 94 55 94. +377(0) 45 94 66 94.**

Kolegji IP

Kolegji.internacionalprizren@live.com.
www.iprizren.org
Adresa: Rr.Besim Shala, p.n. 20000 Prizren

Në Tiranë: **Bar-kafe Sohodolli, rruga e Durrësit, Blloku "Gintash", Laprakë**
Tel: 066 32 38 067, 067 20 200 08.

cyan magenta yelloë black